



UNIVERSITI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË (2023)



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY
Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-548 644 URL: fn.uni-pr.edu e-mail: fn@uni-pr.edu

Dean
Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci

Ref. nr. _____

Prishtinë _____ 2023

RAPORT I VETËVLERËSIMIT AKREDITIMI I PROGRAMIT STUDIMOR

Përgjegjësit për njësinë Akadematike

Prof. ass.Dr. **Florim Grajçevci**, Dekan

Prof. ass. Dr. **Hajdar Sadiku**, Prodekan

Prof. ass. Dr. **Ymer Kuka**, Prodekan

Ass. MSc. **Enes Krasniqi**, Koordinator për zhvillim akademik

Hartuesit:

Prof. Dr. Laura Kusari

Prof. Ass.Dr. Lavdim Osmanaj

Prof. Dr. Ferdije Zhushi Etemi

Prof. Asoc.Dr. Mimoza Hyseni Spahiu

Ass. MSc. Hana Shehu Agani

Ass. MSc. Venera Hajdari

Bartësit e programit të studimeve MSc MIRU:

Prof. Dr. Laura Kusari,

Prof.ass.Dr. Lavdim Osmanaj.

Për hartimin e raporteve të vetëvlerësimit ndihmuan i tërë stafi akademik i FN-së.

Prishtinë, Janar 2023

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË
MENAXHIMI I INTEGRUAR I RESURSEVE UJORE
(MSc)

AKREDITIM

RAPORT VETËVLERËSIMI

Prishtinë, Janar 2023

1. HYRJE	
1.1. Një vështrim i shkurtër i Institucionit	6
1.2. Një pasqyrë e shkurtër e programit në vlerësim.....	9
2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi i programit MSc MIRU	10
2.2 Menaxhimi i cilësisë.....	21
2.3 Stafi akademik.....	26
2.4 Përmbajtja e procesit arsimor.....	31
2.5 Studentët	64
2.6 Hulumtimi	69

1. HYRJE

1.1. Një vështrim i shkurtër i Institucionit

Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN) është institucion publik i arsimit të lartë, njësi akademike e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Universiteti i Prishtinës zhvillon dhe organizon programe të studimeve universitare si dhe punë të lartë shkencore dhe profesionale. Roli kryesor i një njësie akademike moderne për një shoqëri demokratike është që të sigurojë ngritje shkencore dhe arsimore profesionale, duke i përcjellë zhvillimet bashkëkohore shkencore në fushat përkatëse të studimeve.

• Misioni dhe objektivat e Fakultetit të Ndërtimtarisë

Misioni i FN-së është i bazuar në misionin e Universitetit të Prishtinës që të zhvilloj veprime akademike, hulumtuese, punës shkencore dhe të krijimit të kuadrove profesionale të arsimit të lartë për tregun e punës në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, në pajtim me interesat strategjike dhe zhvillimore të vendit.

Veprimtarinë e një njësie akademike e karakterizon bashkëveprimi ndërmjet veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore. Mësimdhënia dhe kërkimet shkencore, paraqesin veprimtarinë kryesore të kësaj njësie akademike. Për arritjen e rezultateve të dëshiruara në studime, mësimdhënia duhet të jetë e pa ndarë nga puna kërkimore shkencore.

Aktivitetet kryesore të FN-së fokusohen në:

- mësimdhënie - mësimnxënie,
- kërkime të vazhdueshme shkencore në shërbim të shoqërisë dhe vendit,
- zhvillim i kuadrove profesionalisht kompatible me kërkesat e tregut,
- aktivitete në fusha të nevojshme për kërkesat e tregut,
- ofrime të shërbimeve dhe ekspertizave për palët e treta,
- hulumtime në zhvillimin e patentëve nga ana e personelit akademik.

Qëllimi i FN-së është që të ketë rol udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë dhe gjithashtu të krijojë dhe të mbështes standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. FN-ja kërkon t'u përshtatet Standardeve Evropiane dhe të integrohet plotësisht në zonën Evropiane të arsimit të lartë sipas Deklaratës së Bolonjës.

Misioni i FN-së është të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore dhe po ashtu të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës për të përfitur nga ky arsim tërë jetësor pa kufizime.

Në këtë mënyrë, niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë organizohen programe të studimeve të niveleve BSc dhe MSc, ndërsa aktualisht nuk organizohen programe të Doktoratës. Programet e studimeve të klasifikuara të FN-së në Departamente dhe nivele janë:

- Konstruktiv (BSc), dhe (MSc)
- Hidroteknikë (BSc), (MSc)
- Gjeodezi (BSc), (MSc), dhe
- Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Programet studimore Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit përbëhen nga lëndë të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale,

plotësuese dhe temës Master e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

Tabela 1 Numri i studentëve aktual në Programet Studimore

	Bachelor			Master			Total		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
Konstruktiv	635	121	514	108	19	89	743	140	603
Hidroteknikë	186	41	145	50	18	32	236	59	177
Gjeodezi	208	44	164	48	18	30	256	62	194
Inxhinieri e Ambientit	101	68	33				101	68	33
Infrastruktura Rrugore				3	2	1	3	2	1
TOTAL	1130	274	856	209	57	152	1339	331	1008

Tërësia e kredive të parapara për përfundimin e Programeve Baçelor në Departamentet: Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit është 180 ECTS kredi, përfshirë edhe punimin e diplomës, në kohëzgjatje minimale prej 3 vitesh (6 semestra).

Pos studimeve të nivelit Bachelor, Fakulteti i Ndërtimtarisë ofron edhe studimet e nivelit Master në Departamentin e Konstruksioneve, Hidroteknikës dhe Gjeodezisë. Tërësia e kredive të parapara të Masterit në këto programe studimore është 120 ECTS kredi, përfshirë edhe punimin e temës së Masterit. Keto studime kanë kohëzgjatje prej 2 viteve (4 semestra).

- **Udhëheqja, strukturat e menaxhimit, personeli akademik dhe administrata**

Universiteti i Prishtinës funksionon duke u bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës [A1] (shiko 05-Annex-Lista e Referencave) ose [S1] (shih vegzën në tabelën me titujt dhe përshkrimin e rregulloreve/politikave, në Standardin 1.4.) ku përfshihen njësitë akademike si pjesë përbërëse dhe dokumentet relevante ndihmëse për njësitë akademike. Universiteti i Prishtinës ka organet kolegjiale duke filluar nga Këshilli Drejtues, Senati, komisionet tjera funksionale, stafi menaxhues dhe administrata qendrore. Të gjitha këto, FN-ja i shfrytëzon për të organizuar dhe zhvilluar veprimtaritë akademike, hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimeve, mësimdhënien dhe mësimnxënien gjithnjë duke pasur në qendër të vëmendjes studentin.

Dekani i Fakulteti i Ndërtimtarisë, sipas statutit të UP-së është udhëheqës i cili krijon një mjedis kolegjial, bashkëpunues dhe studimi që u shërben interesave të përbashkëta të studentëve, profesorëve, stafit menaxherial dhe administrativ. Detyrat e dekanit të IAL janë të përshkruara edhe në dokumentet relevante të nivelit qendror të UP-së, (<https://uni-pr.edu/desk/inc/media/126A0EED-0A53-48A7-8E56-5875EE868FAC.pdf>) [A6] (shiko 05-Annex –Lista e Referencave). IAL-ja, përkatësisht FN-ja ka një strukturë të ndërtuar dhe të qëndrueshme të menaxhimit. Dy anëtarë nga stafi akademik me kontratë të rregullt pune janë të zgjedhur në cilësinë e prodekanit. Prodekanët kanë detyrat e ndara dhe të përcaktuara mirë. Njëri nga prodekanët është përgjegjës për mësimdhënien dhe mësimnxënien, çështjet organizative me studentë dhe çështjet organizative të njësisë akademike ndërsa prodekanit tjetër është përgjegjës për çështjet financiare dhe infrastrukturën e institucionit. Mbështetur në Statutin e UP-së, Dekani organizon departamentet sipas dokumenteve relevante të UP-së dhe të FN-së.

Në kuadër të FN-së ekzistojnë Departamentet të cilat korrespondojnë me fushat e studimeve përkatëse me programe studimore të veçanta të nivelit Baçelor dhe Master shkencor. Departament e FN-së (<https://fna.uni-pr.edu/Departamentet.aspx>) janë:

- Departamenti i Konstruksioneve,

- Departamenti i Hidroteknikës,
- Departamenti i Gjeodezisë, dhe
- Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit

Funksionimi i departamenteve, në vijën vertikale nënkupton pjesëmarrjen e stafit akademik në vendimmarrje deri te Këshilli i njësisë akademike përkatësisht Dekani i fakultetit. Për kompetencat e FN nga UP-ja, vendimet merren në Këshillin e Fakultetit përkatësisht nga Dekani i Fakultetit.

Administrata e UP-së është e centralizuar dhe u ofron shërbim të gjitha njësisve akademike lidhur me shumë çështje, siç janë: financat, studentët, kontratat e personelit akademik dhe administrativ. Administrata e Fakultetit është me kompetenca të kufizuara ekzekutive. Në Fakultetin e Ndërtimtarisë ajo përbëhet nga Sekretari, si funksioni më i lartë dhe përgjegjës për administratën në nivel të njësisë akademike, shërbimi për studentët, personeli i TI, ekonomisti – financieri, shërbimi i protokollit, menaxheri i aseteve dhe laborantët.

- **Studentët, fushat përkatëse të veprimtarisë së institucionit**

Fakulteti i Ndërtimtarisë ofron programe të studimeve baçelor BSc për fusha të ndryshme të studimeve (Konstruksione, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit), mbështetur në Statutin e UP-së dhe sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (në tekstin e mëtejme KKK) (https://akkks.rks.gov.net/uploads/korniza_kombetare_e_kualifikimeve_2020.pdf), që iu dedikohen kandidatëve nga Republika e Kosovës të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm sipas kornizës nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për arsimin e mesëm, dhe kandidatëve nga vendet tjera sipas kuotave të aprovuara, (<https://uni-pr.edu/desk/inc/media/AEE5CABB-5CD7-4418-9489-03949385902A.pdf>). Për regjistrimin e studentëve të rinjë në programet e studimeve themelore në FN, shpallet konkursi nga UP-ja (<https://uni-pr.edu/desk/inc/media/308524D5-4D04-418C-B904-A574F890E195.pdf>) duke specifikuar të gjitha kriteret dhe kuotat. Pas shpalljes së konkursit, FN-ja administron provimet pranuese. Gjithashtu i merr parasysh suksesin nga shkolla e mesme, provimin e maturës dhe bën rangimin e tyre, duke i shpallur rezultatet në faqe të fakultetit si dhe në hapësirat adekuate.

IAL organizon programe të studimeve edhe të niveleve Master shkencorë (MSc) nga fushat e njëjta të programeve të studimeve nga BSc (Konstruktiv, Hidroteknikë dhe Gjeodezi). Programet e studimeve iu dedikohen studentëve të cilët kanë përfunduar studimet themelore dhe që kanë 180 ECTS nga studimet BSc të fushave përkatëse. Për regjistrimin e studentëve të rinjë në programet e studimeve Master, gjithashtu shpallet konkursi publik nga Universiteti i Prishtinës ku specifikohen të gjitha kriteret dhe kuotat. Pas shpalljes së konkursit, FN-ja organizon , i vlerëson ato sipas kriterëve, merr parasysh suksesin nga niveli i studimeve themelore, dhe bënë rangimin e tyre duke i shpallur rezultatet në faqen elektronike të fakultetit si dhe në hapësirat adekuate.

Fakulteti i Ndërtimtarisë është i dedikuar për mësimdhënien dhe mësimnxënien, ku gjatë gjithë kohës ka në qendër të vëmendjes studentin. Përsosja e mësimdhënies arrihet përmes punës kërkimore hulumtuese që realizohet nga personeli akademik i IAL-së. Angazhimi i personelit akademik në fushat e hulumtimeve është prezent jo vetëm në vend, mirëpo edhe jashtë vendit duke dhënë kontribut shkencorë në konferenca shkencore, me punime shkencore të publikuara edhe në revistat më prestigjioze në botë. Bashkëpunimet e FN-së me institucionet arsimore në vend dhe jashtë vendit, janë inspirim për menaxhmentin dhe personelin akademik. Poashtu, janë evidente kontributet institucionale dhe të personelit akademik për nevojat e tregut të punës dhe këto numërohen si ngjarje e rëndomtë e Institucionit. Personeli akademik i FN jep kontribut të çmuar për shërbime të ndryshme të Fakultetit sipas kërkesave. Disa nga këto punë, si sikur është hartimi i raporteve dhe analizave të ndryshme për nevojat e fakultetit siç është edhe Raporti i vetëvlerësimit të programeve të studimeve. Prandaj,

menaxhmenti i FN-së së bashku me stafin akademik dhe administratën, janë të angazhuar jo vetëm në mësim, mirëpo edhe në ngritjen e performancave të mësimdhënies, mësimnxënies, hulumtimeve shkencore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për Institucionin.

- **Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula**

UP siguron studime baçelor, master dhe të doktoratës, sipas sistemit të Bolonjës. Edhe pse Republika e Kosovës ende nuk është formalisht pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës, UP është një nga institucionet e para të arsimit të lartë në regjion që ka filluar reformat sipas këtij Procesi. Implementimi i reformave filloi në vitin akademik 2002/2003 dhe vazhdon ende. UP është i përkushtuar të arrijë objektivat e dala nga Deklarata e Bolonjës dhe deklaratat e komunikatave të Pragës, Bergenit, Berlinit dhe Londrës. UP ka për qëllim të integrohet në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Universiteti ka rëndësi kryesore si ofruer publik i arsimit të lartë në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonominë e Kosovës.

Qëllimi i UP-së “për zhvillim të arsimit akademik, hulumtimit shkencor, kreativitetit artistik, këshillimit profesional” është i shoqëruar nga një grup prej 8 objektivave të detajuara, që ndikojnë qartazi ambicien e UP-së që të bëhet Universiteti Lider në Kosovë, të jetë aktiv në shoqëri, të krijoj dhe mbaj standardet më të larta në mësimdhënie, mësim dhe hulumtim, dhe të jetë plotësisht i integruar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë si një universitet i njohur ndërkombëtarisht. Fakulteti i Ndërtimtarisë duke qenë pjesë e UP-së vepron qartazi, duke pas të përcaktuar synimet e saj primare për arritshmërinë maksimale në mësimdhënie.

Mësimdhënia përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Institucioni aplikon metoda bashkëkohore të mësimdhënies të cilat reflektojnë në pedagogët e moshës së re të cilët impresionojnë me përvojë profesionale dhe arrije akademike.

Në kuadër të metodave dhe teknikave të mësimdhënies është edhe "mësimdhënia një- drejtimore" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies, pedagogun e vëjnë në rolin primar jo vetëm të profesorit mirëpo edhe të moderatorit. Për të ruajtur njohuritë për metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, fakulteti merr pjesë nëpër trajnime të ndryshme permanente të organizuara në nivel të Universitetit (<https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,78>).

Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën mësimore, ku përfshihen ligjeratat, ushtrimet e ndryshme dhe ushtrimet laboratorike. Rëndësi të veçantë u jepet lëndëve të cilat ushtrojnë vizitat praktike në terren si dhe ushtrimeve laboratorike, duke demonstruar shembuj praktik nga realiteti.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjell vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit, të vlerësuar nga studentët. Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies.

Secila lëndë mësimore ka literaturën e saj themelore dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar sipas syllabusit të cilin studenti mund ta gjejë në web faqen e fakultetit ose mësimdhënësi ua siguron paraprakisht.

Kurrikulat e programeve të studimeve, si atyre themelore ashtu edhe studimeve master kanë koncept përmbajtësor duke pas për bazë parimet themelore të formimit të programit të studimit. Këto fillojnë nga formimi i grupit të lëndëve të përgjithshme informuese, pastaj grupi i lëndëve teorike shkencore si

dhe grupi i lëndëve përmbajtësore të profesioneve të ngushta, nga të cilat dalin edhe kompetencat e veçanta të studentëve pas përfundimit të studimeve.

1.2. Një pasqyrë e shkurtër e programit në vlerësim

Tabela 2 Pasqyrë e shkurtër e programit në vlerësim

Emri i Institucionit:	Universiteti i Prishtinës
Fakulteti/Departamenti:	Fakulteti i Ndërtimtarisë
Kampusi Kryesor dhe/apo dega:	Kampusi Kryesor
Nëse aplikohet për Degë, ju lutem specifikoni degën:	NA
Emërtimi i Programit të Studimit:	MSc Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore
Personi përgjegjës për Programin e Studimit:	Prof.Dr. Laura Kusari
Akreditimi/Riakreditimi:	Akreditim
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Niveli 7
Grada akademike apo emërtimi i gradës akademike në diplomë:	Master i Shkencave për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore
ECTS:	120
Profili i programit të studimit (specializimet):	Hidroteknikë
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	06.4
Forma e studimeve:	Studime të rregullta
Kohëzgjatja minimale e studimeve:	2 vite
Numri i vendëve për studim:	20
Shëno Stafin e përhershëm shkencor për Programin e studimit (së paku 3 PhD):	Prof.Dr. Laura Kusari Prof.Ass.Dr. Lavdim Osmanaj Prof.Asoc. Dr. Figene Ahmedi

Programi i studimit MSc Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (në tekstin e mëtejshëm MSc MIRU) është pjesë e Departamentit të Hidroteknikës i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Ndërtimtarisë. Veprimtaria e këtij departamenti kombinon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, për të arritur rezultate të larta në akademike. Ky aktivitet do të krijojë staf të trajnuar profesionalisht dhe të përputhshëm me kërkesat e tregut. Për të siguruar këtë synim të arritjes, programi i studimit të MSc MIRU, stafi mësimdhënës i angazhuar ka kualifikimet dhe përvojën e duhur si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkim shkencor.

Duke qenë pjesë e FN, Departamenti i Hidroteknikës për programin e studimeve MSc MIRU zbaton të gjitha standardet, kriteret, politikat dhe rregulloret e Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universitetit të Prishtinës.

Departamenti i Hidroteknikës ofron program studimi në nivel Bachelor dhe Master, sipas sistemit të Bolonjës. Programet e studimeve master i Hidroteknikës iu dedikohen studentëve që kanë fituar 180 ECTS nga studimet Bachelor. Studimet Master në FN ofrohen që nga viti 2001. Në fakt, studimet e para në nivelin master në Departamentin Hidroteknikës janë zhvilluar dhe implementuar me ndihmën e Qeverisë së Finlandës, duke filluar nga viti akademik 2001/2002. Për këtë program të studimeve Master në Menaxhimin e Ujërave dhe Mjedisit u angazhuan ligjërues kryesisht nga Universitetet e Finlandës, me ndihmën e profesorëve nga Departamenti i Hidroteknikës, Fakulteti i Ndërtimtarisë. Që nga viti akademik 2001/2002, në Departamentin Hidroteknikës në vazhdimësi janë ofruar studime master.

Programi i studimeve Master i shkencave Hidroteknikë vazhdon që nga viti 2001 dhe akreditimi i fundit është deri më 30 shtator 2024. Diploma Master në Hidroteknikë synon të ofrojë avancim arsimor profesional në përputhje me zhvillimet shkencore në fushat e studimeve teknike të Inxhinierisë së Ujit.

Programi i studimeve MSc MIRU, studentëve u ofron kompetenca për vlerësimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, në lidhje me transformimin e regjionit drejt ripërrirjes dhe sigurisë së ujërave. Programi MSc MIRU ka në fokus zbutjen e klimës dhe përshtatjen ndaj saj si dhe sfidat e tashme shoqërore, pra thelbi i këtij programi është siguria e ujit në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Duke qenë se trendi i zhvillimit të vazhdueshëm të vendit tonë po shënon rritje, atëherë si rezultat i zhvillimit të degëve të caktuara të ekonomisë dhe industrisë ka edhe urbanizim të përshpejtuar. Në të njëjtën kohë kërkesat për burime natyrore dhe veçanërisht për ujë janë rritur. Përveç rritjes së kërkesave për furnizim me ujë, situata përkeqësohet nga rritja e kërkesës së popullsisë bazuar në rritjen e cilësisë së jetës, rritjen e kërkesës për ujitje, përdorimin e ujit për energji, urbanizimin e intensifikuar dhe ndryshimet klimatike. Për më tepër, krahas kërkesës në rritje për ujë, duhet të merret parasysh edhe ndotja e vazhdueshme dhe degradimi i cilësisë së ujit. Kërkesa në rritje për ujë dhe degradimi i cilësisë së ujit përbën një barrë të vazhdueshme për burimet ekzistuese ujore. Prandaj, është më se e nevojshme që këto burime të përdoren në mënyrë optimale dhe ne jemi të përkushtuar për mbrojtjen e tyre.

Të gjitha këto janë tregues të qartë se fusha e MIRU ka nevojë për personel të kualifikuar që do të jetë përgjegjës për planifikimin, projektimin dhe funksionimin optimal të sistemeve të burimeve ujore. Staf i arsimuar në këtë fushë do të mundësojë zgjedhjet më të mira të mundshme për burimet tona ujore dhe në të njëjtën kohë do të angazhohet për respektimin dhe përmbushjen e kriterëve mjedisore.

Për të adresuar këto sfida, programi i studimit MSc MIRU është hartuar me një qasje ndërdisiplinare dhe të integruar për të ofruar ngritje të qëndrueshme të kapaciteteve njerëzore. Programi i studimit MSc në MIRU përgatit staf me njohuri bazë në fushat shkencore dhe profesionale, ndryshime thelbësore në fusha të ngushta profesionale si dhe inovacione teknologjike duke i vendosur ato në tregun e punës si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar.

2. VLERËSIMI I PROGRAMIT

2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi i programit MSc MIRU

Standardi 1.1. Misioni kryesor i Programit të Studimit Master Shkencor të Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore (në tekst do të shënohet si MSc MIRU ose Programi) është të ndërtojë kapacitete afatgjatë të menaxhimit të resurseve ujore në nivelet kombëtare dhe të pellgjeve lumore, në përputhje me prioritetet socio-ekonomike dhe politike të Kosovës dhe të Ballkanit, si dhe nevojat e zhvillimit të qëndrueshëm në të ardhmen. Kjo, bazuar në prioritetet sociale, ekonomike dhe politike të regjionit të Ballkanit. Ky Program synon të ndihmojë në zëvendësimin e qasjes aktuale të fragmentuar me një qasje më gjithëpërfshirëse dhe shumë pjesëmarrëse të menaxhimit të burimeve ujore, në përputhje me parimet e Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore (MIRU) dhe Direktivës Kornizë të Ujit të BE-së (EU WFD).

Programi i studimit Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU) është një program ndërdisiplinor, i cili përfshin Departamentin e Hidroteknikës në Fakultetin e Ndërtimitarisë në Universitetin e Prishtinës si bartës kryesor të programit, Departamentin e Biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore - UP dhe Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelarisë dhe Mjedisit në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë. Të gjithë partnerët kanë marrë pjesë në hartimin e programit, prandaj definimi i misionit dhe rezultateve të pritura të programit është rezultat i këtij bashkëpunimi dhe konsultimit mes tyre. Për këtë qëllim janë mbajtur takime të vazhdueshme.

Gjithashtu duhet theksuar se punëdhënësit (shumica e kompanive të ujit dhe autoriteteve rregullatorë të ujit) janë takuar dhe konsultuar, për të marrë informacion se çfarë përgatitje (kompetencash) duhet të ketë një student i diplomuar, pas përfundimit të këtij programi master. Janë konsultuar gjithashtu programe të ngjashme në vende të ndryshme si dhe partneri ndërkombëtar në zbatim i programit,

Instituti për teknologji dhe menaxhim të resurseve në vendet tropike dhe sub-tropike: Universiteti Teknik i Kolnit/Instituti për Menaxhimin e Teknologjisë dhe Burimeve tropike dhe sub-tropike.

Nga nëntori i vitit 2021 e deri më sot kemi pasur katër takime me përfaqësuesit e TH Koln, dhe koordinime të vazhdueshme me TH Koln dhe zyrën SKAT në Kosovë. Si dëshmi për këto kontakte kemi shumë korrespondenca elektronike me TH Koln dhe me zyrën e SKAT-it në Kosovë, me të cilët jemi koordinuar në lidhje me zhvillimin e programit Master MIRU.

Misioni i programit të studimit të MIRU është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit të Ndërtimtarisë (FN). Programi është i orientuar drejt mësimdhënies, të nxënit, hulumtimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të një programi të krijuar për të përmbushur qëllimet kryesore të programit (shih Standardin 1.3). Programi i studimit Master në MIRU ka një koncept didaktik dhe kërkimor të mirë përcaktuar. Strategjia e Fakultetit të Ndërtimtarisë në vazhdimësi ndjek objektivat e inicuaras përmes Planit Strategjik të Universitetit të Prishtinës, duke mbështetur çdo program studimi në përmbushjen e këtyre iniciativave [S2 & S3]. Me fokus në cilësinë e mësimdhënies, të nxënit dhe kërkimit shkencor, ky program do të përkufizohet si një program i qëndrueshëm, dhe atë, duke rishikuar vazhdimisht programin e studimit MSc në MIRU, avancimin me kërkimin shkencor (mbështetur përmes granteve-programeve dhe projekteve ndërkombëtare, të mbështetur nëpërmjet rritjes së financimit institucional dhe shpenzimeve të hulumtimit me 1% të buxhetit vjetor të UP (2020) [R4], zhvillimit të trajnimeve për përdorimin efektiv të platformës ScienceDirect, si një mundësi për të gjetur material kërkimor përkatës në fusha të caktuara (2021), bashkëpunimit me trupin këshillues [T5] të formuar në kuadër të FN, laboratorët e rinj për fusha të caktuara në program dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për studentët.

Zhvillimi i një Programi Master ndërdisiplinar në MIRU (MSc në MIRU) është identifikuar me prioritet si pjesë e një procesi vlerësimi të mëhershëm të mbështetur nga Programi. Krijimi i programit MSc në MIRU do të mbështesë një përmirësim të konsiderueshëm të ofertës arsimore në fushat që lidhen me menaxhimin e resurseve ujore për vendin, dhe në rajonin më të gjerë. Ai duhet të hartohet që grupe të ndryshme profesionistësh të ujit që merren me aspekte specifike të menaxhimit të ujit të pajisen me njohuri të fundit mbi parimet, proceset dhe praktikatat e MIRU. Përhapja e kësaj njohurie të re mes profesionistëve të vendit pritet të nxisë transformimin e menaxhimit aktual të ujit në një sistem modern të qeverisjes së ujit, i aftë për të sjellë përpara agjendën e qëndrueshmërisë së vendit.

Programi ka një qasje ndërdisiplinore me përmbajtje që i takon pjesës inxhinierike (si inxhinieria e ndërtimit, hidroteknika, inxhinieria e ambientit etj.) shkencat natyrore (shkencat e tokës, ekologjia, kimia etj), shkencat sociale (ekonomia, sociologjia, shkencat politike) dhe shkencat humane (antropologjia).

Programi zbatohet nga Konsorciumi i Skat Consulting Ltd. Zvicër dhe Agjencia e Mjedisit Austri (EAA), falë financimit bujar të ofruar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Në zbatimin e aktiviteteve arsimore, MIRU përfiton nga njohuritë e specializuara dhe përvojën afatgjatë të Shërbimeve Universitare Botërore (WUS/SHUB) Austria.

Sa u përket objektivave të master programit në MIRU, ato janë të bazuara në arsimimin e ekspertëve që janë të angazhuar dhe mendojnë të kontribuojnë në fushën e ujërave. Duke qenë se kërkohet një njohuri gjithëpërfshirëse e ekspertëve të ardhshëm, atëherë objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Krijimi i një lidhje në mes të njohurive teorike dhe atyre praktike në fushën e MIRU;
- Arsimimi i ekspertëve me njohuri të reja dhe gjithëpërfshirëse në fushën e MIRU;
- Krijimi i mundësive për aplikimin e hulumtimeve në fushën e MIRU në resurset tona ujore në të ardhmen;
- Krijimi i urave të bashkëpunimit në mes të fushave të ndryshme të lidhura me resurset ujore;

- Kombinimi i njohurive teknike të fushës së inxhinierisë me kompetencat menaxhuese, ekonomike dhe sociale.

Standard 1.2. Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve [K1], programi MSc në MIRU i përket nivelit të shtatë (7), i cili përfshin programe akademike dhe profesionale, përfundimi i së cilave çon në një kualifikim Master. Studentët, titullin Master e sigurojnë përmes demonstrimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave për secilën lëndë në veçanti dhe për të tërë programin në përgjithësi, brenda periudhës së studimit. Duke përdorur metodologji të reja, duke siguruar zhvillim të stafit akademik me pjesëmarrje në trajtime të mësimdhënies, dhe trajnime për aplikime në projekte shkencore dhe profesionale, pjesëmarrje në konferenca, publikime kërkimore shkencore, përditësim të programeve studimore në përshtatje të kërkesave të tregut të punës, këshillime me trupin këshillëdhënës [T5,] për kërkesat e tregut, diskutime midis pjesëmarrësve brenda FN-së dhe bashkëpunime të FN-së me palë jashtë saj (Institucione, kompani e organizata publike e private, vendore e ndërkombëtare), edhe programi MIRU synon arritjen e rezultateve të mësimin në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Standardi 1.3. Gjatë viteve të ardhshme, MSc në MIRU do të ndihmojë në krijimin e mjedisit të favorshëm për transformimin e parashikuar të menaxhimit të resurseve ujore të Kosovës përmes:

- a) Mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve institucionale për MIRU;
- b) Përgatitjes së bazës koherente të planifikimit dhe dokumentacionit teknik për të informuar masat e ardhshme dhe vendimet e menaxhimit të resurseve ujore (p.sh., planet e menaxhimit të pellgjeve lumore, politika, strategji dhe plane të tjera në nivel vendi);
- c) Mbështetjes për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të profesionistëve (të rinj) të ujit duke lehtësuar krijimin e vendeve të punës; dhe
- d) Rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për çështjet mjedisore dhe krijimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së palëve të interesuara në menaxhimin e burimeve ujore.

Në përputhje me këto drejtime strategjike, MIRU është krijuar për të lehtësuar miratimin e një sistemi gjithëpërfshirës të MIRU në nivel vendi duke kombinuar arritjet e zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike të përfshira në një grup masash të ndërlidhura. Një pjesë e konsiderueshme e ndërhyrjeve të mbështetura nga Programi lidhet me përpjekje të tilla për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë zhvillimin e njohurive dhe aftësive të profesionistëve të ujit. Konkretisht, Programi synon të mbështesë administratën shtetërore (të ujit), profesionistët e rinj (të ujit), akademikët dhe studiuesit, OSHC-të/OJQ-të dhe palët e tjera të interesuara.

MSc në MIRU është para-konceptuar në një mënyrë për të ndihmuar Kosovën të përmirësojë menaxhimin e përgjithshëm të burimeve ujore duke kaluar nga qasjet tradicionale në konceptet bashkëkohore gjithëpërfshirëse të cilat marrin parasysh aspekte të shumta dhe mbështeten në integrimin e arritjeve të disiplinave të ndryshme shkencore. MIRU gjithashtu duhet të ndihmojë transformimin e vendit duke marrë parasysh procesin e vazhdueshëm të anëtarësimit në BE, prandaj konceptet, qasjet dhe legjislacioni me bazë në BE në lidhje me ujin duhet të jenë të theksuara në planprogram.

Mësimdhënia në programin MSc në MIRU në një kontekst të përgjithshëm zhvillohet përmes ligjëratave, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, si dhe përmes bashkëpunimit të arsyeshëm mësimdhënës/student gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Një trajnim skematik mbi MIRU që përmbledh aspekte të shumë anshme relevante për menaxhimin bashkëkohor të ujit - shkenca e ujit, ekonomia e ujit, politika e ujit, ekosistemet e ujit, menaxhimi ndërkufitar dhe financimi për menaxhimin e ujit mbeten të rëndësishme për ndërtimin e kapaciteteve të MIRU në Kosovë. Për këtë arsye, MSc në MIRU do të ketë një qasje të nuancuar duke shikuar sfidat specifike të ujit të ligjit kombëtar të ujërave, negociatave dhe menaxhimit të alokimeve të ujit;

dimensionit gjeografik dhe biofizik; dhe mekanizmat financues për sigurimin afatgjatë të sigurisë ujore në vend. Bazuar në bazën konceptuale aktuale, MSc në MIRU ka për qëllim:

- Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të rinj dhe praktikuesve të ujit duke përfshirë pjesëmarrësit nga sektorët e lidhur me ujin. Qasja e adoptuar për ndërtimin e përmbytjes mësimore dhe zhvillimin e përgjithshëm të këtij programi MSc në MIRU të përfshijë angazhimin, përfaqësimin dhe krijimin e një atmosfere për proceset e bashkë-mësimit.
- Të përfitojë nga forumi i diskutimit dhe studimet e rasteve përkatëse, përveç ligjëratave në klasë, duke krijuar një mekanizëm për mësimin e përbashkët/të mësuarit nga kolegët.
- Të ndërtohet mbi bashkëpunim me shumë partnerë, ekspertë dhe agjenci që kanë një gamë të gjerë ekspertize dhe njohurish në sektorin e ujit nga perspektiva rajonale (BE) dhe kombëtare (Kosovë).
- Të shikojë përtej modeleve standarde konvencionale të programit master duke investuar në anëtarë të shumtë të fakultetit me autoritet mbi temat që lidhen me MSc në MIRU.
- Një platformë mësimore bashkëpunuese do të inkurajojë shkëmbimin intelektual, inovacionin pedagogjik dhe solidaritetin profesional brenda komunitetit akademik dhe hulumtues të Kosovës.
- Të mobilizojë një “komunitet të praktikës” dhe një “task forcë” (grup pune) kombëtare për ujë nëpërmjet aplikimit të diversitetit profesional, duke përfshirë secilin që zotëron njohuri të veçanta disiplinore, teorike dhe tematike.

Bazuar në kërkesat aktuale për punë, në tregun nacional dhe regional të punës, tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të pozitave tipike dhe aftësive të kërkuara.

Tabela 3 Pasqyrë e pozitive dhe aftësitë tipike që kërkohen në sektorë të ndryshëm

Sektori	Punëdhënësit	Pozitat/Aftësitë
Hulumtim dhe zhvillim	Universitetet, Institucionet hulumtuese, Sektori Privat, Sektori i fokusuar në hulumtime	Hulumtuesit, Studentët e PhD, Koordinatorët; Aftësi hulumtuese, njohuri teorike, aftësi metodologjike
Planifikim strategjik	Institucionet publike lokale, regjionale, nacionale, sektori privat në fushën e planifikimit dhe menaxhimit ambiental, OJQ-të	Koordinator i programeve, Menaxherët e resurseve ujore, Ekspertët ambiental, Menaxherët e projektit; Aftësitë menaxheriale në planifikimin strategjik dhe menaxhim
Planifikim operacional dhe Implementim	Sektori publik lokal dhe nacional, sektori privat me fokus në planifikimin ambiental dhe menaxhim, OJQ-të	Menaxher i projekteve, Menaxher i resurseve ujore, Ekspert i menaxhimit ambiental

Standardi 1.4. Në Raportin e vlerësimit të programit MSc në MIRU, është përfshirë një listë me tituj dhe përshkrim të shkurtër të politikave, udhëzimeve dhe rregulloreve. Një listë e tillë me tituj dhe përmbajtje të shkurtër si dhe vegëza përkatëse për disa rregullore, njoftime dhe vendime ekzistuese që kanë të bëjnë me misionin, objektivat e administrimit të programit si dhe me çështjet e tjera të përfshira në RVV (menaxhim të cilësisë, staf akademik, proces mësimor, studentë, hulumtim dhe infrastrukturë) është ofruar në tabelën në vijim. Në tekstin e kësaj RVV-je, këto politika, udhëzime, rregullore e të tjera janë referuar nga po kjo tabelë (p.sh. për Statutin e UP-së si: [S1]). Të tjera rregullore, udhëzime e politika që nuk janë të përfshira në këtë tabelë, por që kanë të bëjnë me çështje procedurale, akademike dhe të tjera janë të bashkëngjitura në “Listën e Referencave” në këtë RVV.

Tabela 4 Tabela me tituj dhe përshkrim të shkurtër të rregulloreve/politikave dhe vegëzat përkatëse

Statuti dhe Plane Strategjike			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtër	Vegza
S1	Statuti i UP	Bazë statusore për rregullimin, funksionimin, financimin dhe sigurimin e cilësisë, përfshirë stafin dhe studentët në Universitetin e Prishtinës në përputhje me standardet evropiane.	https://uni-pr.edu/desk/inc/media/9E4445D9-FE24-47C5-9B1E-8059828B4D7E.pdf
S2	Plani strategjik i UP	Përmban iniciativa strategjike përfshirë periudhën kohore, pjesëmarrësit përgjegjës dhe koston e iniciativave për implementim.	https://uni-pr.edu/desk/inc/media/D7EAE629-A39D-4D4C-A598-93B7B5227EDB.pdf
S3	Strategjia e FN	Përfshin ambiciet, iniciativat e parapara nga Alumni, mbështetësit dhe bashkëpunëtorët tonë.	https://fn.uni-pr.edu/desk/inc/media/2194CD62-DE91-48D5-9EFA-70C9297A4D67.pdf
Korniza			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtër	Vegza
K1	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve	Promovon ngritjen e cilësisë në arsim dhe aftësim. Synon që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat për punësim, por edhe përmbushjen e kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë në vend.	https://akkks.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?file-Name=Korniza%20Komb%20C3%ABtare%20e%20Kualifiki-meve36064736.8453.pdf&original=Korniza%20kombetare%20e%20kualifikimeve%202020.pdf
K2	Korniza e Zonës Evropiane për Kualifikim të Arsimit të Lartë.	Elaboron kornizë të kualifikimeve, rekomandime dhe propozime për një kornizë gjithëpërfshirëse për kualifikime të arsimit të lartë.	http://www.ehea.info/Upload/document/ministerial_declarations/EHEAParis2018_Communique_AppendixIII_952778.pdf
Rregulloret			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtër	Vegza
R1	Rregullore për procedurat e përgatitjes së ri-akreditimit në UP	Përcakton formën, proceset dhe procedurat për përgatitjen e akreditimit dhe ri akreditimit institucional dhe të programeve studimore në UP.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5C53e6391d-e725-4849-a09e-6045788c0dcd31.3.2021.pdf&rrId=1170
R2	Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP	Vlerësim i stafit nga personeli akademik si komision vlerësues për aktivitetet: mësimore, hulumtuese, shkencore dhe shërbyese.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5Ce859c93c-d0c8-4e35-b16c-0ea5147dbde927.4.2022.pdf&rrId=4569
R3	Rregullore e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP	Përcakton procedurat vlerësuese për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm, përfshirë edhe të pensionuarit.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5Cebd6c945-dbf0-4ade-8b7d-89c6b64818ea25.6.2021.pdf&rrId=3419
R4	Rregullore për financimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore, artistike dhe sportive në UP	Përcakton mënyrat e financimit dhe ndarjes së mjeteve financiare për publikimeve shkencore e hulumtuese nga personeli akademik dhe studentët e PhD të UP-ës.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5Ce8217096-5fdc-434d-aa77-e1e8cdafb83b27.5.2021.pdf&rrId=3406

R5	Rregullore për studimet – Master	Përcakton kriteret themelore dhe të përgjithshme për studimet Master.	https://studenti.uni-pr.edu/RregullorePublic/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5Ca17aef3b-1261-444c-bb1e-5417263be17615.3.2021.pdf
R6	Rregullore e punës së sistemit elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) në UP	Përcakton standardet e përdorimit të SEMS.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5Cbe9d4ec5-55f9-4e61-b075-613c7195564312.5.2021.pdf&rrId=2390
R7	Rregullore për mobilitetet akademik të studentëve	Definon procedurat për mobilitet të studentëve.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5Ce6b0b3ed-e996-42de-9806-d12a653632c226.3.2021.pdf&rrId=64
R8	Rregullore për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP	Përcakton procedurat disiplinore dhe masat e zbatueshme në rastet e përgjegjësive disiplinore të personelit akademik të UP-ës.	https://ekonomiku.uni-pr.edu/desk/inc/media/BAF4228A-69BC-4345-8BB7-F71FF34C26F3.pdf
R9	Rregullore për procedurën dhe masat disiplinore për studentët e UP	Përcakton procedura të përgjegjësive disiplinore, organet shqyrtuese të shkeljes disiplinore dhe masat e ndëshkimit disiplinore ndaj studentëve	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5C4e2a301d-9a21-4d98-85cc-598eef42d18931.3.2021.pdf&rrId=145
R10	Rregullore për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e parlamentit studentor (PS) dhe këshillave të studentëve (KS) të UP	Përcakton procedurat për zgjedhje të PS dhe KS si dhe çështjet me të cilat merren PS dhe KS.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5C52c409f7-1629-49c4-a4a4-dab873ec097b13.5.2022.pdf&rrId=4598
R11	Rregullore mbi strukturën dhe parimet e punës të qendrës për përsosmëri në mësimdhënie në UP	Ndihmon në avancimin e kapaciteteve akademike dhe zhvillimin e sistemeve mësimore duke promovuar mësimdhënie efektive dhe cilësore konkurruese në Universitetet më të mira në Rajon dhe Botë.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5Cb4d8fe85-2619-44e5-85ef-79085c4db13129.3.2021.pdf&rrId=87
R12	Rregullore për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në UP	Rregullon çështjet e të ardhurave personale dhe kompensimit të punës për staf akademik në UP (të rregullt e të angazhuar) dhe ndër të tjera edhe krijimin e grupeve të studentëve.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregulloren?dok=Rregulloret%5C86c0e3a8-8067-4b01-91fc-5166b1874eff24.10.2021.pdf&rrId=3455
R13	Rregullore e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të cilësisë në UP Nr. 4/132 Dt. 30/12/2016	Rregullon të gjitha proceset dhe mekanizmat për vlerësimin e cilësisë në UP	https://fn.uni-pr.edu/desk/inc/media/569B371A-9033-407D-B063-C285966A98A5.pdf

R14	Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 2-543, datë 22.10.2021, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtines	Rregullon çështjet e të ardhurave personale dhe kompensimit të punës për staf akademik në UP	https://studenti.uni-pr.edu/RregullorePublic/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5C52c409f7-1629-49c4-a4a4-dab873ec097b13.5.2022.pdf
Vendimet			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
V1	Vendim i Senatit të UP-së, për zyrtarizimin e të gjitha udhëzimeve për zhvillimin e aktiviteteve akademike gjatë pandemisë COVID-19	Zyrtarizimin të udhëzimeve për aktivitete akademike gjatë pandemisë COVID-19 (ekzistojnë edhe njoftime për shërbimet e platformave virtuale në pdf. format, të dorëzuar me e-mail nga Zyra e IT në Rektorat).	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5C15c8961b-7bdc-4fcc-b519-166fe39eb36e2.4.2021.pdf&rrId=2182
V2	Bartësit e Programit MSc – MIRU	Në këtë vendim theksohen dy bartësit e Programit Master MIRU në FN, si dhe detyrimet e tyre si bartës të programit.	Shiko Listën e Referencave – V2
V3	Koordinator i Programit MSc – MIRU	Në këtë vendim caktohet koordinatori i Programit Master MIRU në FN.	Shiko Listën e Referencave – V3
V4	Përfundimi i RVV-së – vendimi për procedurat e mëtutjeshme në Zyrën Akademike për Zhvillim	Në këtë vendim theksohen procedurat e mëtutjeshme pranë Zyrës Akademike për Zhvillim.	Shiko Listën e Referencave – V4
Udhëzime			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtër	Vegza
U1	Udhëzim Administrativ nga MASHTI për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë	Proces i vlerësimit jashtë UP-së i zhvilluar nga AKA mbi akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=17952
U2	Udhëzues për shqyrtimin dhe rishikimin e Syllabusit	Mbështetje e stafit akademik/mësimdhënësit që t'i shkruajnë/shqyrtojnë/rishikojnë plan-programet e tyre në mënyrë adekuate që ta reflektojnë më mirë përmbajtjen e lëndës dhe metodologjitë e aplikuara.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRregullore?dok=Rregullore%5C4433d342-8016-4826-9374-e9a086f48d7b12.5.2021.pdf&rrId=2392

U3	Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e rezultateve të tyre	Vlerësimet nga studentët për lëndët, mësimdhënësit dhe administratën. Shtynë në vetë përmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënësit në veçanti dhe programit studimor e FN-së në përgjithësi. Përfshinë pyetësorin për mësimdhënësit, lëndët, shërbimin dhe infrastrukturën si dhe personelin administrativ dhe personelin mbështetës të UP.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRegulloren?dok=Rregulloret%5Ca55463ce-d0ce-4e7b-bfc6-3b3d4216192b29.3.2021.pdf&rrId=96
Tjera			
Ref.	Titulli	Përshkrimi i shkurtë	Vegza
T1	Sigurimi i cilësisë në UP	Vlerësimet të stafit dhe mësimdhënies, të studentëve dhe mësimnxënies, të aktiviteteve hulumtuese dhe publikimeve në revista shkencore.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRegulloren?dok=Rregulloret%5C653eda16-1d3f-4111-bd6f-277ff6829bdc12.5.2021.pdf&rrId=2391
T2	Bashkëpunim ndërkombëtar	Marrëveshje Erasmus+ ICM (KA107).	https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,61
T3	Marrëveshje bashkëpunimi në FN-a	Marrëveshje bashkëpunimi midis FN-ës dhe Institucioneve, kompanive e organizatave vendore dhe ndërkombëtare.	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,56
T4	Kodi i Etikës i stafit akademik 1/751 dt. 2013	Për të krijuar një ambient të favorshëm për shpërndarjen, zgjerimin dhe ekzaminimin kritik të njohurive si dhe për të çuar më tej kërkimin e së vërtetës dhe dijes.	https://dokumente.uni-pr.edu/Dokumentet/ShkarkoRegulloren?dok=Rregulloret%5C18c680a7-7854-41fe-8533-3524dc70087a21.3.2021.pdf&rrId=51
T5	Trupi këshillëdhënës (TK) i FN-ës	Themelimi i TK me anëtarë të tij.	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,45 https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,82
T6	Komuniteti Alumni	Rrjet i profesionistëve të FN-ës, si ambasadorë në rolin e tyre për implementimin dhe shpërndarjen e njohurive të cilat i kanë fituar gjatë studimeve BSc, MSc dhe PhD.	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,49
T7	Këshilli studentor	Përfaqësues të këshillit të studentëve nga FN	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,23
T8	Qendra për Zhvillim të Karrierës	Ndihmon studentët dhe të diplomuarit për zhvillim të njohurive dhe shkathtësive që do t'i ndihmojnë gjatë punësimit, si dhe ofrojnë informata për maturantët rreth studimeve në UP.	https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,78
T9	e-Karriera	Platformë njoftuese për aktivitete të ndryshme në shërbim të studentëve (në nivel të FN-ës dhe nivel të UP-ës).	https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,41 https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,84
T10	Infrastruktura për kërkime shkencore në UP	Përbërja e laboratorëve në njësitë akademike të UP-ës.	https://uni-pr.edu/desk/inc/media/041DEACC-F20C-41F2-801E-B19DAE1F431C.pdf
T11	Thirrje për shprehje interesi për prezantimin e një Programi Master në MIRU	Thirrje për shprehje interesi për prezantimin e një Programi Master në MIRU	Shiko Listën e Referencave – T11

T12	Aplikimi për programin Master – MIRU	Ky dokument përfshin aplikimin e FN për Programin Master në MIRU	Shiko Listën e Referencave – T12
T13	Letër Marrëveshje MIRU/UP	Letër Marrëveshje mes MIRU dhe UP	Shiko Listën e Referencave – T13
T14	Prezantimi publik i programit MIRU	Prezantimi Publik u prezantua në Fakultetin e Ndërtimtarisë, para një auditori publik duke përfshirë stafin e FN-së, studentët dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme.	Shiko Listën e Referencave – T14
T15	LETËR MARRËVESHJE ndërmjet Programit të Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë dhe Technische Hochschule Köln/Instituti për Teknologjinë dhe Menaxhimin e Resurseve në Tropikët dhe Nën-tropikët	LETËR MARRËVESHJE ndërmjet Programit të Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë dhe Technische Hochschule Köln/Instituti për Teknologjinë dhe Menaxhimin e Resurseve në Tropikët dhe Nën-tropikët për mbështetjen e Partneritetit Akademik të organizuar nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina' në zbatimin e Programit Master në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore	Shiko Listën e Referencave – T15
T16	Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Technische Hochschule Koln, Fakultetit të Zhvillimit Hapësinor dhe Sistemeve të Infrastrukturës dhe Universitetit të Prishtinës	Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Technische Hochschule Koln, Fakultetit të Zhvillimit Hapësinor dhe Sistemeve të Infrastrukturës dhe Universitetit të Prishtinës për të bashkëpunuar në çdo fushë të zhvillimit akademik, shkencor dhe institucional.	Shiko Listën e Referencave – T16
T17	Memorandum mirëkuptimi në mes-Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit dhe Mekanik, Universiteti i Shkencave të Jetës në Poznan, Poloni, 22.03.2022	Memorandum mirëkuptimi në mes-Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit dhe Mekanik, Universiteti i Shkencave të Jetës në Poznan, Poloni për të krijuar shkëmbim akademik ndërkombëtar dhe bashkëpunim.	Shiko Listën e Referencave – T17
T18	Erasmus+, Mobilitet për studentët dhe stafin, mobiliteti i studentëve dhe stafit të arsimit të lartë. Marrëveshja ndërinstitucionale 2020-23, ndërmjet institucioneve të programit	Mobiliteti për Studentë dhe Stafin akademik – Universiteti i Trentos dhe Universiteti i Prishtinës	Shiko Listën e Referencave – T18

	dhe vendeve partnere, Universita degli Studi di Trento/Italia dhe Universitetit të Prishtinës. Nënshkruar në datën 02 Mars 2021.		
T19	Erasmus+, Mobiliteti për studentët dhe stafin, mobiliteti i studentëve dhe stafit të arsimit të lartë. Marrëveshja ndërinstitucionale 2022-24, ndërmjet institucioneve të programit dhe vendeve partnere, Universitetit të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës, Vjenë dhe Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë.	Mobiliteti për Studentë dhe Stafin akademik – Universiteti i Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës, Vjenë dhe Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë.	Shiko Listën e Referencave – T19

Standardi 1.5. I tërë stafi dhe studentët e programit të studimit MSc në MIRU janë në përputhje me rregulloret e brendshme që kanë të bëjnë me sjelljen etike [T4] në mësimdhënie, hulumtim dhe vlerësim në të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative.

Standard 1.6. Krijimi i programit të studimit MSc në MIRU nuk shihet si kulm i arritjes së procesit të zhvillimit të kurrikulës. Programi MSc në MIRU gjithmonë shihet si një hap fillimi, por i vazhdueshëm dhe sistematikisht i përditësuar. Për të bërë të qëndrueshëm programin, të gjithë pjesëmarrësit brenda FN-së: Menaxhmenti i FN-së, koordinatori për zhvillim akademik në FN, koordinatori me anëtarë të programit, mësimdhënësit, studentët, komuniteti i trupit këshillëdhënës [T5], këshilli i fakultetit dhe komisioni i studimeve i FN-së që në përbërje kanë staf të FN-së dhe përfaqësues të studentëve si dhe komuniteti Alumni i FN-së [T6], kontribuojnë në rishikim, vlerësim dhe përmirësim të programit. Si i tillë, programi përcillet për vlerësim në strukturat dhe mekanizmat relevante të UP-së, dhe atë: Prorektori për cilësi, zyra për zhvillim akademik (ZZHA), komisioni për cilësi, dhe në fund tek Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA). Kjo e fundit ofron rekomandime përmes ekspertëve të jashtëm, me të cilat programi plotësohet, përmirësohet dhe zhvillohet deri në rishikimin e radhës. Rrugëtimi i rishikimit të programit MSc MIRU definohet me: Dispozita statusore, Rregullore për procedura të përgatitjes së riakreditimit, Udhëzues për shqyrtim dhe rishikim të syllabuseve [S1; R1; U2].

Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:

A. Përparësitë:

- MSc në MIRU do të mbështesë një përmirësim të konsiderueshëm të ofertës arsimore në fushat që lidhen me menaxhimin e resurseve ujore për vendin dhe rajonin më të gjerë;
- Njohuri ndërdisiplinore midis audiencës së larmishme të synuar për sa i përket formimit të mëparshëm arsimor dhe përvojës profesionale (p.sh., inxhinieri, ekonomi, ekologji, shkenca mjedisore, shkenca sociale etj.);
- Pajisë profesionistët e ardhshëm (të ujit) me njohuri dhe aftësi bashkëkohore për të menaxhuar sfidat dhe pasiguritë e menaxhimit të resurseve ujore në jetën reale;
- Synon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore që do të kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore në vend dhe rajon;
- Kurrikula e përpiluar që mundëson bashkëpunim shumë disiplinor;
- Një qasje shumë disiplinore – ekspozimi, edukimi dhe përvoja;
- Prezantimi i shembujve më praktik për të kuptuar pjesën teorike të fokusimit në qasjen e studimit të rastit;
- Sjellja e përvojave të avancuara të ligjërimit nga jashtë.

B. Dobësitë:

- Do të identifikohen gjatë implementimit të programit.

C. Mundësitë:

- Programi është interdisciplinor, ku janë përfshirë disa njësi akademike të UP, UPHZ dhe TH Koln Universiteti;
- Një program i ri që zbatohet në FN është një mundësi e mirë për avancim profesional të të gjithë pjesëmarrësve në fushën e ujërave;
- Shfrytëzimi i përvojës së partnerëve ndërkombëtarë në përgatitje akademike dhe profesionale;
- Shfrytëzimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për angazhim të stafit dhe studentëve në projekte të ndryshme të financuara nga komuniteti ndërkombëtar.

D. Kërcënimet:

- Mungesa e fondeve për mbulimin e shpenzimeve për profesorët e ftuar dhe profesorët tjerë nga EU dhe më gjerë, si ligjërues vizitorë;
- Mos informimi i mirë dhe me kohë i studentëve nga jashtë;
- Për arsye të pandemisë mund të ketë vonesa në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, në hulumtime të përbashkëta dhe shkëmbim akademik.

2.2 Menaxhimi i cilësisë

Standardi 2.1. Fakulteti i Ndërtimtarisë synon vazhdimisht të ruaj qëndrueshmërinë përmes sigurimit të cilësisë në favor të komunitetit brenda dhe jashtë vendit. Sigurimi i cilësisë në FN mbështetet në instrumentet e sigurimit të cilësisë së UP [T1].

Sistemi i sigurimit të cilësisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina“ përfshinë shumë nga trupat vendimmarrëse dhe implementuese që asistojnë njësitë administrative dhe akademike për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë në përputhje me Statutin e UP-së (S1), udhëzimet administrative mbi vlerësimin e Institucioneve të Arsimit të lartë të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) dhe standardet dhe udhëzimet e ENQA-s. Autoriteti më i lartë në strukturat raportuese të UP-së për menaxhimin e cilësisë është Senati i UP-së, kurse në nivelin qendror të Universitetit është Këshilli për Menaxhimin e cilësisë. Ky Këshill raporton direkt te Senati i Universitetit përmes Zëvendës rektorit për zhvillim të cilësisë (Figura 1).




Figura 1 Struktura e menaxhimit të cilësisë në UP

Procedurat për vlerësimin institucional përfshijnë një varg hapash dhe procedurash që janë pjesë të këtij procesi i cili udhëhiqet nga Rektori i UP-së. Rektori më tej delegon përgjegjësitë te grupi punues i përbërë prej:

- Pro Rektorit për cilësi,
- Drejtorit të ZZHA,
- Një përfaqësuesi nga Këshilli i cilësisë,
- Një koordinatori të zhvillimit akademik (prej NjA),
- Dy anëtarëve të stafit,
- Një përfaqësuesi të studentëve.

Organizimi dhe procesi i vlerësimit për akreditimin/reakreditimin institucional është i paraqitur në figurën 2.




Figura 2 Procesi për përgatitjen e akreditimit/riakreditimit institucional (Përgjegjës: Rektori, Pro Rektori për Cilësi, Komisioni për Cilësi, ZZHA, Dekanët)

Në kuadër të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë zhvillohen vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm. Mekanizmat dhe instrumentet bazë të sigurimit të cilësisë në nivel institucional janë: komisioni i sigurimit të cilësisë, komisioni i studimeve, zyra e zhvillimit akademik në nivel universitar. Grupi punues për rishikimin e programit të studimit kontribuon në përmirësimin dhe përshtatjen e kurrikulës së programit, përkatësisht: menaxhmenti i njësisë akademike FN, koordinatori për zhvillim akademik, koordinatori me bartësit dhe anëtarët përkatës të programit, komuniteti i të diplomuarve, profesorët, studentët aktualë dhe alumni. Përfaqësuesit e organit këshillimor, në fakt, janë komuniteti i FN-së, i cili u mundëson mësimdhënësve të rrisin cilësinë e kurrikulës në kuadrin e nevojave të tregut të punës nga njëra anë dhe nga ana tjetër kontribuon në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e programit bazuar në kërkesat e tregut. Vlerësimi i jashtëm, pavarësisht nëse programi i ka përbushur apo jo standardet e cilësisë të pranuar ndërkombëtarisht, kryhet nga Agjencia Kosovare e Akreditimit e themeluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Vlerësimi i stafit akademik është proces i rregullt i cili bëhet nga studentët përmes SEMS-it në kushte anonimiteti. Një formë e formularit të vlerësimit të stafit akademik mund të gjeni të bashkëngjitur në aneks (Lisat e referencave, A 32,3 në gjuhën shqipe). Ky vlerësim bëhet për secilin profesor, për secilën lëndë në veçanti dhe me këtë arrihet vlerësimi përfundimtar i stafit akademik dhe programit si tërësi. Rezultatet e këtyre pyetësorëve analizohen dhe u dërgohen në mënyrë elektronike mësimdhënësve, për çdo semestër (<https://dokumente.uni-pr.edu/>), Rregullore e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të cilësisë në UP, R13, Nr. 4/132 date 30/12/2016). Dekani i njësisë akademike siguron qasje për të dhënat për

vlerësimet që bëhen në kuadër të kësaj rregulloreje dhe në bazë të tyre harton planin e përmirësimit dhe reflekton masat që duhet ndërmarrë.

Standardi 2.2. Procesi i vlerësimit dhe planifikimit për përmirësim shqyrtohet vazhdimisht dhe integrohet në planifikimin e programit. Gjetjet si arritje shtyhen më tej, ndërsa mangësitë përmirësohen dhe si të tilla përfshihen për t'u zbatuar në program.

Standardi 2.3. Nëpërmjet mësimdhënies dhe mësimnxënies, profesorët, stafi dhe studentët tërhiqen të gjenerojnë njohuri dhe të zhvillojnë politika, teknika dhe aftësi për të ndihmuar praktikuesit të menaxhojnë burimet e ndërtimit dhe mjedisit. Profesorët organizojnë mësimdhënie, provime dhe vlerësime të studentëve. Vetëvlerësimi i personelit akademik (arritjet shkencore dhe profesionale) dhe lënda; vlerësimi i performancës së personelit akademik; monitorimi i ecurisë së procesit mësimor dhe zbatimi i kurrikulës (leksione, ushtrime, provime) nga drejtuesit dhe diskutimet ndërmjet drejtuesit të departamentit dhe studentëve shtojnë vazhdimisht përmirësimin e cilësisë në FN. Së fundi, (në nëntor 2021) në UP u mbajt një punëtori dyditore ndërmjet menaxhmentit të UP-së dhe HERAS + (ekspertë ndërkombëtarë) për mundësinë e përpilimit dhe zbatimit të një udhëzuesi për matjen e performancës së stafit akademik të UP-së. Kartela e vlerësimit fokusohet në katër fusha kyçe të rëndësishme për UP: mësimdhënie, kërkime shkencore, zhvillim institucional dhe shërbim në komunitet. Gjithashtu vlerësimi i stafit administrativ në shërbim të stafit, studentëve, burimet financiare dhe infrastruktura janë tregues të zhvillimit cilësor në FN-së. Të gjitha këto procese janë të përfshira në planifikimin dhe zbatimin e programit të studimit dhe janë të mbështetura nga niveli qendror i UP-së, në përputhje me rregulloret që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në Universitetin e Prishtinës (file:///C:/Users/Admin/Downloads/Rregullore%20e%20Vlerësimit%20të%20cilësisë%20në%20UP.pdf, Rregullore e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të cilësisë në UP, R13, Nr. 4/132 date 30/12/2016).

Standardi 2.4. Një pasqyrë e çështjeve të cilësisë për programin në veçanti dhe për fakultetin në lidhje me rezultatet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si mënyra të vlerësimit të njohurive, jepet duke aplikuar: provimet, kolokiumet, punimet seminarike, duke përfshirë interpretimin dhe prezantimin e tyre, praktikë profesionale dhe teste praktike gjatë ushtrimeve [R6]. Këto mjete përdoren për të vlerësuar se sa secili student ka arritur rezultatet e pritura të të nxënit në secilën lëndë. Vlerësimi përfundimtar i studentëve publikohet në faqen "Transkript/Aplikime" në SEMS, në të cilën faqe, çdo mësimdhënies ka qasje nëpërmjet një llogarie të vetme dhe të veçantë. Standardet e përdorimit të SEMS përcaktohen në rregullore të veçanta. Në nivelin themelor, vlerësimi i studentëve në lëndën individuale i referohet nivelit të transferimit të suksesshëm të njohurive të dëshiruara. Në një nivel më të përgjithshëm, matjet, p.sh. përqindja e pjesëmarrjes dhe përqindja e studentëve që kalojnë provimet pasqyrojnë edhe nivelin e arritjes së objektivave të programit. Arritja e objektivave për kursin në veçanti vlerësohet përmes raportit statistikor i cili është nxjerrë edhe nga faqja "Transkript/Aplikime" në SEMS. Raporti statistikor i mundësive studentore njëvjeçare për të gjitha programet e FN-së u jepet profesorëve nga menaxhmenti i FN-së. Menaxhmenti i FN-së njofton arritjet dhe mangësitë në zbatimin e programit dhe gjithashtu me grupin e punës reflekton dhe sugjeron aktivitete për planifikimin e përmirësimit të cilësisë në nivel fakulteti.

Standardi 2.5. Fakulteti i Ndërtimtarisë angazhohet në vazhdimësi që vlerësimi i cilësisë në program të jetë në nivel të kënaqshëm dhe të garantojë përmbushjen e standardeve të kërkuara. Një tjetër përparësi mund të numërohet fakti se studentët nga niveli BSc menjëherë pas studimeve në këtë nivel mund të vazhdojnë studimet në ciklin e ardhshëm, studimet master edhe në nivel ndërkombëtar.

Standardi 2.6. Të dhënat e ofruara nga anketa e vlerësimit të studentëve për lëndët, mësimdhënësit dhe administratën e gjetur në Udhëzuesin për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e rezultateve të tyre [U3], çojnë në vetë përmirësim të vazhdueshëm të mësimdhënësve në veçanti dhe të programit të studimit. Komentet e studentëve konsiderohen si një instrument i rëndësishëm në

përformancën e programit. Të dhënat për arritjet e profesorëve publikohen në faqen zyrtare të FN-së. Gjithashtu, një tregues i cilësisë është numri i të diplomuarve në kohë dhe ky numër gjenerohet nga administrata e FN-së. Në nivelin e UP-së dhe në nivelin e vetë FN-së, komuniteti Alumni [T6] është themeluar si një ambasador kyç në rolin e tyre të zbatimit dhe shpërndarjes së njohurive që kanë marrë gjatë studimeve të tyre bachelor, master apo doktoraturë.

Standardi 2.7. Rezultatet e të gjitha proceseve të vlerësimit që përbëjnë sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë në lidhje me studentët merren parasysh për të siguruar cilësi të qëndrueshme. Këto rezultate të lëndës marrin parasysh në veçanti: vijueshmërinë e studentëve, vlerësimin e studentëve përmes testeve, kolokfiumet, punën laboratorike, punën në terren, detyrat e shtëpisë dhe provimin përfundimtar. Ndërsa, për rezultatet e arritjes së aftësive profesionale të fituara gjatë studimeve, studentët vlerësohen përmes punimit të diplomës. Në nivelin BSc shpesh aplikohet integrimi i zhvillimit të punës praktike nga studenti gjatë studimeve (si lëndë më vete në kurrikulën e programit) në temën e diplomës. Zhvillimi i punës praktike ka rezultuar në kontakte ndërmjet studentit dhe institucionit, organizatës apo ndërmarrjes publike apo private (shpesh të mbështetur nga përfaqësues të kompanive brenda trupit këshillues të FN), duke mundësuar punësimin e studentëve të diplomuar në këto institucione. Bashkëpunimi me bordin industrial përbën një element kyç që mundëson përgatitjen e studentëve për tregun e punës si dhe punësimin e tyre.

Standardi 2.8. Përmirësimi i vazhdueshëm në nivel programi ndodh bazuar në rekomandimet e ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e programit. I gjithë sistemi për sigurimin e jashtëm të cilësisë është i rregulluar me një Udhëzim Administrativ të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës [U2]. Raporti i vlerësimit për cilësinë e përgjithshme të programit përgatitet në mënyrë periodike për shqyrtim në kuadër të FN-së, duke theksuar si arritjet ashtu edhe mangësitë e programit.

Standardi 2.9. Në çdo kohë kur është e nevojshme, cilësia e programit përmirësohet rregullisht: pasi të merren parasysh të gjitha vlerësimet për proceset specifike të sistemit të cilësisë, duke përfshirë rekomandimet nga ekspertët e jashtëm, pas aplikimit të të gjitha rregulloreve dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në nivelin e UP-së për vetëvlerësim, pas aplikimit të të gjitha rregulloreve dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë. Periodikisht (për periudhën e vlefshmërisë së programit të akredituar), FN përgatit raporte vetëvlerësimi duke marrë parasysh të gjitha proceset, instrumentet dhe mekanizmat me ndikim në performancën dhe zbatimin më të qëndrueshëm të secilit program brenda FN.

Treguesi i performancës 2.1

Të gjitha raportet, me rezultatet e vlerësimeve iu ofrohen bartësve të programeve për ofrimin e çdo lënde. Këto raporte përfshijnë të dhëna të detajuara për secilin kurs e të cilat ndihmojnë bartësit e programeve dhe Dekanin e Njesisë akademike që të ndërmarrin strategji të planifikuara për avancimin e vazhdueshëm të programit. Poashtu, bashkëpunimi me punëdhënësit ndihmon për të parë se sa janë realizuar objektivat e programit.

Treguesi i performancës 2.2

Pas përfundimit të çdo lënde, studentët bëjnë vlerësimin në mënyrë anonime përmes Programit për Menaxhimin e Studentëve, SEMS. Ky vlerësim, përveç vlerësimit të mësimdhënësve përshinë edhe vlerësimin e lëndës. Këto vlerësime pastaj ndihmojnë në gjenerimin e raporteve të cilat tregojnë për arritjet apo të metat e secilës lëndë. Raportet u dorëzohen bartësve të programit të cilët mund të planifikojnë strategji për të tejkaluar mangësitë eventuale. Në këto raporte të zyrës së cilësisë vazhdimisht vlerësohen dhe rivlerësohen kurrikulat e secilit kurs dhe nxjerrën rekomandimet e nevojshme për rritjen e cilësisë së programit dhe performancës.

Treguesi i performancës 2.4

Zyra e cilësisë në kuadër të Fakulteti të Ndërtimtarisë bën vlerësimin dhe raportimin mbi gjendjen e programit në baza vjetore. Në vlerësim përfshihen të gjitha palët e interesit duke përfshirë stafin akademik dhe administrativ të Fakultetit, sipas nevojës edhe ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të komunitetit të Bizneseve përmes Bordit Industrial i cili është shumë aktiv në FN. Kjo edhe shërben si një bazë për rishikim të programit, me ndihmën e profesionistëve të të gjitha fushave.

Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:

A. Përparësitë

- Monitorimi i procesit mësimor përmes SEMS-it (sistemi elektronik i monitorimit të studentëve);
- Monitorimi i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të studentëve përmes raportimit dhe komunikimit me studentët;
- Shërbime të shpejta dhe siguri i cilësisë së garantuar për mësimdhënësit dhe studentët;
- Menaxhimi dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes raportimit dhe vlerësimit periodik;
- Shërbime administrimi të kënaqshme për nevojat e njësisë akademike duke përdorur SEMS.

B. Dobësitë:

- Mungesë eventuale e interesimit të studentëve për të marr pjesë në proceset për Sigurimin e cilësisë;

C. Mundësitë:

- Ngritja e kapaciteteve administrative dhe trajnimi i tyre për praktikant ndërkombëtare të punës administrative;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies, ndjekja e leksioneve, ushtrimet e monitorimit të studentëve përmes SEMS-it.

D. Kërcënimet:

- Procedurat e gjata për avansimin e stafit ekzistues akademik dhe rekrutimin e stafit të ri;
- Shkurtime eventuale të buxhetit për stafin e ri mund të ndikojnë në menaxhimin e cilësisë.

2.3 Staf i akademik

Stafi akademik dhe udhëheqësit akademik në programin MSc MIRU janë të angazhuar të kontribuojnë në mësimdhënie, kërkime, zhvillim dhe sigurim të cilësisë në Departamentin e Hidroteknikës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe njësitë akademike që janë pjesë e partnershit tonë akademik për këtë program. Në të njëjtën kohë, ata ofrojnë edhe konsultime, mbështetje për studentët dhe shërbime administrative.

Standardi 3.1. Staf i akademik i angazhuar në programin MSc MIRU e realizon veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me dispozitat statusore të UP-së. Staf i akademik përbëhet nga grupet e mëposhtme:

- Staf i akademik me kontratë të rregullt, nga UP
- Staf i akademik jo i rregullt, i angazhuar prej Universiteteve tjera.

Të dhënat mbi angazhimin e stafit akademik në programin Master të MIRU, emrat e tyre, njësitë akademike, shkalla e edukimit, titulli akademik, kontrata, orët e mësimin, ECTS, CV-të (CV-të e stafit akademik mund të shihen në pjesën shpesh të RVV-së) dhe aktiviteti hulumtues janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme. Këto të dhëna si dhe aktiviteti i detajuar hulumtues për stafin akademik, poashtu mund të gjenden në linkun si në vijim: <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14>.

Tabela 5. Staf i akademik i angazhuar në programin Master MIRU

Nr.	Stafi Akademik Emri dhe Mbiemri	Njësia Akademike - Fakulteti Universiteti	Grada shkencore	Titulli akademik	Kohëzgjatja e kontratës ²	Shuma-ECTS	Orët mësimore		Hulumtimi ³
							O	Z	
Stafi akademik i rregullt									
1	Naser Kabashi	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Dr.	Pa limit	3		2	CV
2	Laura Kusari	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Dr.	Pa limit	9	2	2	CV
3	Perparim Ameti	FN-UP	Dr. Sc.	Prof. Asoc. Dr.	2022	6	2		CV
4	Figene Ahmedi	FN -UP	Dr. Sc.	Prof. Asoc. Dr.	2022	9	2	2	CV
5	Lavdim Osmanaj	FN -UP	Dr. Sc.	Prof. Ass. Dr.	2025	15	4	2	CV
6	Milot Muhaxheri	FN -UP	Dr. Sc.	Prof. Ass. Dr.	2025	3		2	CV
7	Ferdije Zhushi Etemi	FSHMN-UP	Dr. Sc.	Prof. Dr.	Pa limit	6	2		CV
8	Halil Ibrahim	FSHMN -UP	Dr. Sc.	Prof.Asoc.Dr.	Pa limit	6	2		CV
9	Mimoza Hyseni Spahiu	FMTHE-UHZ	Dr.Sc.	Prof. Asoc. Dr.	2024	3	2		CV
10	Arben Mehmeti	FBV-UP	Dr. sc.	Prof. Dr.	Pa limit	3	2		CV
11	Visar Morina	FJ-UP	Dr. Sc.	Prof.Dr.	Pa limit	3	2		CV
12	Naim Jerliu	FM-UP	Dr.Sc.	Prof. Asoc. Dr.	2022	3		2	CV
13	Linda Gusia	FF- UP	Dr.Sc.	Ass.	2023	6	2		CV
14	Mjellma Carabregu Vokshi	FE-UP	Dr.Sc.	Prof.ass. Dr.	2025	3		2	CV
15	Zijadin Guri	FN	Dr.SC.	Prof.Ass.Dr.	2026	3		2	CV
16	Arban Berisha	FN-UP	Dr.Sc	Ass.	2024	6	2		CV
17	Hana Shehu	FN-UP	MSc	Ass.	2023	9	2	2	CV
18	Premton Thaqi	FN-UP	MSc	Ass.	2024	9	2	2	CV
19	Venera Hajdari	FN-UP	MSc	Ass.	2024	15	4	2	CV
Profesor vizitor/Assistant									
1	Lars Ribbe	ITT-TH Köln	Dr. rer.nat	Prof. Dr		6	2		CV
2	Sudeh Denhavi	ITT-TH Köln	Dr.	Research Associate		6	2		CV

- FN - Fakulteti i Ndërtimtarisë; FSHMN - Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore; FE- Fakulteti i Ekonomisë, FBV - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë; FJ- Fakulteti Juridik;

FMTHM - UHZ - Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, FM - Fakulteti i Mjekësisë; FF- Fakulteti Filozofik; UP- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; UHZ - Universiteti Haxhi Zeka, Pejë.

- TH-Koln-Fakulteti Teknik i Kolnit, Gjermani (Universiteti Teknik i Kolnit/Instituti për Menaxhimin e Teknologjisë dhe Burimeve tropike dhe sub-tropike).
- KR - Kontratë e rregullt; PV - Profesor vizitor
- CV - biografia e stafit akademik (linku: <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,14> për CV-të e stafit akademik)

Standardi 3.2. Në kuadër të procedurës së kontratës së punës, çdo anëtar i stafit akademik ndjek një procedurë e cila rregullohet nga statusi i UP-së [S1] si dhe rregulloret në nivel institucional [R2, R3]. Njësia akademike, përkatësisht fakulteti, para fillimit të vitit akademik e paraqet kërkesën në Senatit e UP-së për nevojat e stafit akademik dhe administrativ. Me miratimin e kërkesës nga Senati, procedurat e punësimit përcaktohen në përputhje me Statusin e UP-së [S1] dhe rregulloret [R2, R3] deri në finalizimin e kontratës [A14, A15, A16]. Konkursët për staf akademik me orar të plotë, përkatësisht konkursët për avancim akademik organizohen deri në nivel të UP-së, përkatësisht të Senatit. Procedurat përshkruhen në Rregulloren lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik UP 2019 [R2, R3]. Sipas rregullores, njësia akademike i kryen raportet e vlerësimit në bazë të meritokracisë dhe standardeve të përcaktuara sipas statutit të UP-së [S1], të njëjtat miratohen nga këshilli i njësive akademike dhe procedohen deri në miratimin përfundimtar nga Senati - UP. Pas miratimit, nënshkruhet kontrata e punës [A14, A15, A16]. Universiteti i Prishtinës lëshon: kontratë të rregullt (KR) (4 vjet për profesorë dhe 3 vjet për asistentë) për personelin akademik me normë të plotë dhe kontratë me gjysmë normë (PC) (në varësi të kërkesave të fakultetit, e cila ka kohëzgjatje prej 1 viti) për personelin akademik të angazhuar.

I gjithë personeli, pavarësisht nga lloji i kontratës, plotëson kriteret ligjore për pozicionet përkatëse dhe është në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë nga MASHT, neni 26, pika 5.3 [U1].

Standardi 3.3. Stafit akademik i angazhuar në programin MSc në MIRU është personel me kohë të plotë, që punon vetëm në një institucion të arsimit të lartë. Kjo do të thotë se FN në programin MSc në MIRU ka angazhuar staf akademik të përzgjedhur në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të vitit 2018, neni 26, pika 5.3.14 dhe 5.3.15 [U1].

Standardi 3.4. Programi MSc në MIRU ka gjithsej 21 mësimdhënës. Nga ky numër, 18 mësimdhënës (13 profesorë dhe 5 asistentë) janë nga UP, 1 profesor nga UHZ dhe 3 profesorë vizitorë nga universitetet ndërkombëtare. Sipas titujve akademikë, programi numëron gjashtë profesorë të rregullt (Dr.Sc. Prof.); tre profesorë të asocuar (Dr. Sc. Prof. Asoc.); katër profesorë asistent (Dr. Sc. Prof. Ass.); dhe gjashtë Asistentë Mësimdhënës (Ass.), nga të cilët dy asistente doktorantë (së shpejti do të promovohen në Prof. asistentë). Numrit të përgjithshëm të profesorëve u shtohet edhe 1 profesor vizitor nga Technische Hochschule Koln/Instituti për Teknologjinë dhe Menaxhimin e Burimeve në Universitetin e Tropikëve dhe Subtropikëve të Kolnit dhe një hulumtues po nga ky Universitet. Këta profesorë kanë gradat e tyre akademike prof. dr. dhe asoc researcher, dhe statistikën e tyre nuk janë përfshirë më lartë.

Nga 21 mësimdhënës, 19 janë me staf të plotë (nga UP dhe UHZ) që përbëjnë rreth 90,5 % të profesorëve me kohë të plotë (nga numri i përgjithshëm). Për sa i përket gjithsej 23 klasave të këtij MSc, të 20 klasat (reth 86% e tërë klasave) ligjërohen nga punonjës me kohë të plotë.

Standardi 3.5. Fakulteti i Ndërtimtarisë, në kuadër të së cilit zbatohet programi i studimit MSc në MIRU, ka siguruar staf të mjaftueshëm me kohë të plotë me titullin akademik të doktoratës (PhD). Programi MSc MIRU ka dy profesorë me gradë shkencore PhD (Një profesor i asocuar dhe një profesor asistent) që janë bartës të programit MSc në MIRU. Rekrutimi i stafit të ri akademik bëhet në bazë të kërkesave të fakultetit dhe natyrisht në kohën kur UP-ja shpall thirrje për staf të ri akademik.

Standardi 3.6. Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit MSc MIRU është trajnuar për metodat e mësimdhënies si dhe praktikat e vlerësimit të studentëve në kuadër të të nxënies. Trajnimi i personelit akademik kryhet në baza individuale për certifikim. Disa mësimdhënës të angazhuar në programin MSc MIRU janë të certifikuar nga Programi "Zhvillimi i të menduarit kritik gjatë leximit dhe mësimdhënies" të Shoqatës Ndërkombëtare të Leximit në Washington DC. Ky Trajnim është organizuar në vitin 2001-2002, nga Qendra për Arsim në Kosovë (QAK) me temën kryesore të trajnimit "Strategjia kryesore e mësimdhënies". Përveç kësaj, janë organizuar edhe trajnime të tjera nga Qendra për Ekselencë në Mësimdhënie të UP-së [R11], si: trajnimet e nivelit bazë "Mësimdhënia në arsimin e lartë", dhe trajnimet e nivelit të avancuar "Planifikimi dhe zbatimi i mësimdhënies në arsimin e lartë". Ftesa për këto trajnime është bërë për tërë personelin akademik me normë të plotë dhe me të drejtë aplikimi. Avancimi i personelit akademik kërkon edhe plotësimin e kriterit të formimit në mësimdhënie (shih "Formularët e Komisionit Vlerësues për Emërimin e Personelit Akademik, për Marrëdhëniet e Punës në Institucionin e Arsimit të Lartë") [R2, R3]. Poashtu, stafi është i inkurajuar të marrë pjesë në projekte shkencore, të garojë për bursa për mobilitet të stafit në universitet ndërkombëtar. Përdorimi i fondeve të SKAT (në kuadër të programit MIRU) dhe Erasmus+ për bashkëpunim ndërkombëtar, në kuadër të të cilit organizohen jo vetëm leksione, por edhe konferenca, punëtori dhe trajnime lidhur me qëllimin e projekteve, ofrojnë përfitime nga përvoja dhe modele të praktikave të mira me ndikim në zhvillimin profesional dhe akademik.

Standardi 3.7. Sipas përcaktimeve të kontratës së punës dhe në përputhje me politikat e FN-së, stafi akademik, ligjëruesit dhe asistentët janë në dispozicion për konsultimet me studentët. Mësimdhënësi u siguron studentëve literaturën bazë mësimore, udhëzimet për punimet seminarike, si dhe format e tjera që përdoren për mësimdhënie dhe mësimnxënie brenda lëndës që zhvillon. Literatura tjetër ofrohet si literaturë shtesë nga mësimdhënësit për studentët që shprehin interes për studim më të detajuar gjatë studimeve në fushën përkatëse. Gjithashtu, çdo mësimdhënës është i gatshëm vazhdimisht për të ofruar këshilla dhe ekspertizë nga fusha e tij për nevojat e komunitetit.

Standardi 3.8. Staf i akademik i programit MSc MIRU, si dhe i gjithë stafi i FN-së, u nënshtrohen vetëvlerësimit dhe pyetësorëve për stafin akademik (siç kërkohet të përcaktohet në Formularët e Komisionit të Vlerësimit për Emërimin e Stafit Akademik, për punësim në Institucionin e Arsimit të Lartë) [R2]. Këtu përfshihet vlerësimi i personelit për aktivitete edukative (mësimdhënie, organizim vizitash studimore, ftesë të mësimdhënësve të huaj, literaturë dhe mekanizma për vlerësimin e duhur të studentëve), për veprimtari kërkimore, shkencore dhe profesionale (publikime në revista shkencore me recensione ndërkombëtare, pjesëmarrja në konferenca shkencore, pjesëmarrja në projekte kërkimore, shkencore dhe profesionale, recensione në revista akademike dhe profesionale) si dhe për aktivitete shërbyese për UP, FN dhe për komunitetin (detyra të caktuara nga niveli i UP, FN, ose në mënyrë vullnetare).

Vlerësimi i stafit akademik është proces i rregullt i cili bëhet nga studentët përmes SEMS-it në kushte anonimiteti. Ky vlerësim bëhet për secilin profesor në veçanti dhe me këtë arrihet vlerësimi përfundimtar i stafit akademik si tërësi. Një formë e pyetësorëve gjendet e bashkëngjitur në aneks (A.32.1). Rezultatet e këtyre pyetësorëve analizohen dhe u dërgohen në mënyrë elektronike mësimdhënësve, për çdo semestër (Rregullorja e sigurimit të cilësisë, R13, Nr. 4/132 date 30/12/2016). Pyetësori, i formuluar nga zyra e UP-së për cilësi, plotësohet në mënyrë anonime nga studentët.

Përdoret për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndës së dhënë, në të njëjtën kohë. Është vlerësuar edhe stafi administrativ i UP-së [U3]. Në këta pyetësorë studenti ka mundësinë të japë vlerësimin e tij/saj për secilën lëndë në veçanti, duke përfshirë vlerësimin për mësimdhënësin e angazhuar në atë lëndë. Një pasqyrë e performancës së stafit akademik është edhe monitorimi i ecurisë së procesit mësimor (ligjërata, ushtrime, provime) dhe rezultateve të të nxëniet (krahasuar me planprogramin e lëndës) i zhvilluar nga menaxhmenti i FN-së dhe drejtuesi i departamentit. Ecuria e mësimit, kalueshmëria dhe pjesëmarrja e studentëve në klasë vlerësohen edhe nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të studentëve (SEMS).

Standardi 3.9. Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i cilësisë së programit MSc MIRU do të arrihet me vlerësimin e rregullt të stafit akademik, siç shpjegohet në standardet 2.3, 2.6 dhe 3.8. Sigurimi i materialeve të përshtatshme mësimore, si literatura bazë dhe literatura shtesë për të fituar njohuri për studentët dhe përditësimi i përmbajtjes së lëndës ndihmon në sigurimin e cilësisë së këtij programi. Syllabuset do të publikohen në faqen e elektronike të FN-së dhe do të përditësohen rregullisht me modulet dhe literaturën e re. Një strategji tjetër e sigurimit të cilësisë përmes materialeve mësimore është mundësia e mobilitetit për stafin akademik të FN-së, që do të ofrohet përmes bashkëpunimit të programit SKAT – MIRU-K me Universitete të tjera, përmes programeve të BE-së "Erasmus +" duke kontribuar në reformën e mësimdhënies (mësimdhënie, kurrikulë dhe literaturë). Në këtë drejtim, ndihma e Universitetit të Kolnit është e një rëndësie të madhe, veçanërisht në përgatitjen e planprogrameve të lëndëve.

Standardi 3.10. Statusi i punës së mësimdhënësve të pensionuar (si dhe statusi i personelit të rregullt dhe personelit të angazhuar) rregullohet me Statutin e UP-së, konkretisht nenet 169 dhe 170 për punonjësit e universitetit - Personeli akademik dhe joakademik [S1], Rregullorja për procedurat e përzgjedhjes së personelit akademik në UP [R2] dhe Rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP [R3]. Sipas dispozitave të UP-së, personel i rregullt konsiderohet mësimdhënësi i cili nuk ka kontratë tjetër të punës me orar të plotë në ndonjë universitet tjetër [R3]. Stafit akademik në pension konsiderohet ligjërues mbi 65 vjeç dhe mund të angazhohet deri në 70 vjeç, me kontratë me gjysmë normë.

Për këtë kategori mësimdhënësish, këshilli i fakultetit [R2] nxjerr vendimin për angazhimin për vitin e ardhshëm akademik.

Analiza SWOT për stafin akademik:

A. Përparësitë:

- Mësimdhënës të kualifikuar për fusha të ndryshme të shkencave;
- Profesorë me përvojë të gjatë akademike;
- Profesorë me formim të ndryshëm arsimor dhe përvojë të gjatë pune;
- Përfshirja e stafit akademik nga Universiteti i Kolnit;
- Përfshirja e stafit akademik nga Njësi të ndryshme Akademike;
- Mësimdhënës të trajnuar për metodat e mësimdhënies si dhe praktikatat e vlerësimit të studentëve në kontekstin e të nxënës;

B. Dobësitë:

- Mbingarkesa e një pjese të stafit akademik me orë mësimi;
- Mungesa e mbështetjes financiare nga universiteti për blerjen e literaturës (teksteve mësimore).

C. Mundësitë:

- Përfitimi nga bashkëpunimi dhe përvoja e kolegëve me formim të ndryshëm profesional dhe arsimor;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe shkencor përmes bashkëpunimit me industrinë;
- Rritja e performancës për fusha specifike të menaxhimit të burimeve ujore, sipas kërkesës së tregut të brendshëm dhe të jashtëm;
- Një sistem i mirë i kuadrit të krijuar profesional për shkak të zgjerimit të tregut të punës, fleksibilitetit dhe hapjes së kufijve.

D. Kërcënimet:

- Sigurimi i mbështetjes institucionale - financiare për zhvillimin akademik dhe veprimtarinë kërkimore të stafit mësimdhënës;
- Kriteret për avancimin e stafit akademik konsiderohen rigoroz dhe të vështira për tu arritur.

2.4 Përmbajtja e procesit arsimor

Standardi 4.1 Programi MSc MIRU synon edukimin dhe zhvillimin e personelit të kualifikuar të nevojshëm që do të jetë përgjegjës për planifikimin, projektimin, funksionimin dhe menaxhimin e sistemeve të burimeve ujore. Personeli i trajnuar në këtë fushë do të jetë përgjegjës për zgjidhjen më të mirë të mundshme për problemet e burimeve ujore, duke marrë parasysh kriteret mjedisore. Për të adresuar të gjitha këto sfida dhe për të ofruar zgjidhje, Programi Master në MIRU është hartuar me një qasje ndërdisiplinore dhe të integruar, për të ofruar ngritjen e kapaciteteve të nevojshme në këtë fushë. Programi MSc MIRU është krijuar për të pajisur grupe të ndryshme profesionistësh të lidhur me ujin, me aspekte specifike të menaxhimit të ujit, me njohuri mbi parimet, proceset dhe praktikat e MIRU. Përhapja e kësaj njohurie të re mes profesionistëve të rinj pritet të nxisë transformimin e menaxhimit aktual të ujit në një sistem modern të qeverisjes së ujit. Në këtë mënyrë, profesionistët e ardhshëm të ujit do të pajisen shumë më mirë me njohuri dhe aftësi bashkëkohore për të menaxhuar sfidat dhe pasiguritë reale të menaxhimit të burimeve ujore. Ky program do të ndihmojë Kosovën të përmirësojë menaxhimin e përgjithshëm të burimeve ujore duke kaluar nga qasjet tradicionale në konceptet bashkëkohore, të cilat mbështeten në integrimin e arritjeve të disiplinave të ndryshme shkencore.

Standardi 4.2. Programi i studimit MSc MIRU përputhet me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve [K1] dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë [K2]. Kjo do të thotë se programi MSc MIRU i përket nivelit të shtatë (7) të kualifikimeve me dy vite studim me kohë të plotë. Gjatë hartimit të kurrikulave për programin Master MIRU ne kemi analizuar disa kurrikula nga përvojat ndërkombëtare. Mund të emërtojmë një program Master Shkencor njëvjeçar në Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore të ofruar nga Departamenti i Bioresurseve Inxhinierike, Universiteti McGill, Kanada. Përmbajtja e këtij programi ofron aspekte fizike, mjedisore, ligjore, institucionale dhe socio-ekonomike të përdorimit dhe menaxhimit të ujit në një kontekst të integruar, si dhe dimensione teknike, të cilat janë të përfshira në zgjidhjet e përshkruara për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve ujore.


Një tjetër program Master i analizuar në MIRU është në Shkencën, Politikat dhe Menaxhimin e Ujit i ofruar në Universitetin e Oksfordit, i cili synon të pajisë gjeneratën e ardhshme të profesionistëve të ujit me aftësitë e nevojshme për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në rrugët e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit, përgjatë prioriteteve konkurruese të ujit për ekosistemet, ushqimin, energjinë, rritjen ekonomike dhe konsumin njerëzor.

Programi i studimit MSc në MIRU në Kosovë është i krahasueshëm me Programin Master për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore të Universitetit Teknik të Shkencave të Aplikuara të Kolnit (TH Koln) (<http://curriculum.itt.th-koeln.de/wordpress/itt-curriculum/integrated-water-resources-management-iwrm/>) dhe me Masterin e Shkencave mbi Burimet Ujore dhe Menaxhimin e Mjedisit në Universitetin Leibniz, Hanover, Gjermani (<https://www.uni-hannover.de/en/studium/studienangebot/info/studiengang/detail/water-resources-and-environmental-management/>).

Me hartimin e këtij programi, kemi marrë parasysh sfidat në sektorin e ujit dhe nevojat specifike në Menaxhimin e Burimeve Ujore në Kosovë.

Qëllimi kryesor i programit Master në MIRU është të krijojë një komunitet të eksperteve të ujit të cilët do të jenë të aftë të adresojnë sfidat e ndërlidhura në sektorin e ujërave dhe të fuqizojnë menaxhimin e resurseve ujore. Objektivat kryesore të master programit në MIRU janë paraqitur edhe në figurën e mëposhtme.

Figura 3. Objektivat kryesore të programit MSc MIRU



Standardi 4.3. MSc MIRU është fokusuar në reformat arsimore në vend pasi shumica e programeve aktuale për edukimin mbi ujin janë të prirur drejt perspektivës inxhinierike, biofizike, ekologjike dhe hidrologjike. Prandaj, ky program është krijuar bazuar në 3 pika kryesore:

- Agjenda e sinergjisë që krijon fuqi punëtore me aftësi që përputhen me tregjet e punës në sektorin publik dhe privat të ujit, ndërkohë që krijon profesionistë të vetëdijshëm për objektivat që lidhen me qëndrueshmërinë;
- Qasje e personalizuar duke aplikuar program edukativ të përshtatur bazuar në kërcënimet dhe sfidat specifike në sektorin e ujit të Kosovës si dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të ujit;
- Qasje ndërdisiplinore duke adresuar sfida të shumta teknike përmes integritit të kurseve të ndryshme që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore si hidrologjia, inxhinieria e ujit, ligji i ujit, ekonomia e ujit, shkencat sociale etj.

Programi Master dhe kurrikula e MIRU kombinon një sërë modulesh bazë për burimet ujore si "Hyrje: MIRU dhe Siguria e Ujit", "Hidrologji dhe Hidrometri", "Ruajtja e Ujit dhe Efikasiteti i Ujit", "Menaxhim i Përmbajtjeve dhe thatësirave", "Strukturat Hidraulike", "Monitorimi mjedisor dhe Analiza e të Dhënave". Ky program ofron kurse nga shkencat natyrore si "Karakterizimi biofizik i ujit", "Menaxhimi i bazuar ne Ekosisteme". Për të ofruar një pasqyrë mbi ekonominë e ujit dhe legjislacionin janë hartuar modulet e mëposhtme, të tilla si: "Ekonomia e Ujit dhe instrumentet financiare për implementimin e MIRU", "Legjislacioni ujor dhe qeverisja". Kurset në fushën e informatikës lënda "Mjetet gjeohapësinore për zbatimin e MSc MIRU" është një rëndësie të vecante kur kemi të bëjmë me të dhëna të shumta, përpunimin dhe analizimin e tyre si dhe në modelimin hidraulik. Përveç kësaj, pjesëmarrësit mund të zgjedhin midis 9 lëndëve zgjedhore që lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore si: "Metodat hulumtuese shkencore dhe studimi", "Menaxhimi i projekteve", "Shëndeti publik", "Ndërmarrësi" etj. Puna praktike dhe kërkimore do të fokusohet në përgatitjen e tezës së masterit, nëse është e mundur, me institucionin ose kompaninë vendore ose rajonale. Kjo do të garantojë orientimin praktik të hulumtimit të punimit të diplomës - master.

Tabela 6. Organizimi i lëndëve sipas kategorive

Disiplina / Fusha	Aktiviteti formues	ECTS		
		ECTS	Gjithsej ECTS	%
Lëndët Fundamentale në Menaxhimin e Resurseve Ujore	Hyrje: MIRU dhe Siguria e Ujerave	6	33	27.5%
	Hidrologji dhe Hidrometri	6		
	Ruajtja e ujit dhe efikasiteti i ujit	6		
	Menaxhimi i përmblytjeve dhe thatësirave	3		
	Strukturat Hidraulike	6		
	Monitorimi Mjedisor dhe Analiza e të Dhënave	6		
Lëndet e lidhura me Shkencat Natyrore	Karakterizimi biofizik i ujerave	6	9	10%
	Menaxhimi i bazuar ne Ekosisteme	6		
Ekonomia dhe Legjislacioni	Ekonomia e Ujit dhe instrumentet financiare për implementimin e MIRU	6	6	7.5%
	Legjislacioni uJOR dhe qeverisja	3		
Informatika	Mjetet gjeohapësinore për zbatimin në MIRU	6	6	5%
Sociale dhe tjera	Ndryshimet klimatike: Risku dhe aftësia ripërtëritëse	6	12	10 %
	Uji dhe Konfliktet - Pushteti dhe politika ne Sektorin e ujit	6		
Lëndë Zgjedhore	Metodat hulumtuese shkencore dhe studimi	3	Minimum lëndë Zgjedhore 18	15%
	Menaxhimi i Projekteve	3		
	Meteorologjia	3		
	Uji dhe Agrikultura	3		
	Shëndeti Publik	3		
	Objektivat e Zhvillimit te Qëndrueshëm	3		
	Hidroinformatikë/Modelimet Hidraulike	3		
	Ndërmarrësi	3		
	Menaxhimi i Pellgut Ujëmbledhës	3		
Diploma	Puna Praktike	10	30	25%
	Punimi i Diplomës	20		

Programi u dedikohet grupit të kandidatëve të përzgjedhur që kanë të paktën një diplomë baçelor dhe mund të vijnë nga një sërë formimesh akademike që lidhen me sektorin e ujit, si inxhinieria, shkencat natyrore, ekonomia, shkencat sociale etj. Mundësisht të kenë disa eksperiencia pune në një institucion apo kompani në sektorin e ujit, të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të flasin rrjedhshëm gjuhën angleze. Kandidatët duhet të jenë shumë të motivuar për të kontribuar në zgjidhjen e krizës së ujit dhe duhet të aspirojnë të bëjnë karrierë në sektorin ndërkombëtar të ujit. MSc MIRU është krijuar si një program masteri i orientuar si një program mësimi empirik, për t'u ofruar studentëve njohuritë e nevojshme mbi sektorin e ujit në rajonin e BE-së dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre shkencore dhe teknike në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.

Kjo do të arrihet përmes studimeve me kohë të plotë, të shpërndara në 2 vite (d.m.th. 4 semestra). Gjatë studimeve master studentët fitojnë gjithsej 120 ECTS, çdo semestër ka 30 ECTS. Gjatë tre semestrave të parë studentët do të fitojnë 90 ECT ndërsa semestri i katërt i dedikohet praktikës dhe punimit të diplomës. Praktika u mundëson studentëve të zgjerojnë dhe rrisin njohuritë mbi sfidat aktuale të ujit, të

zgjerojnë njohuritë e tyre teorike dhe t'i zbatojnë ato njohuri mbi problemet në sektorin e ujit. Gjithashtu, ai ndihmon në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe përmirësimin e komunikimit midis grupeve të ndryshme të palëve të interesuara për çështjet që lidhen me ujin. Përmes kësaj praktike studentët fitojnë 10 ECTS shtesë. Disa nga institucionet dhe kompanitë që janë në dispozicion për bashkëpunim dhe praktikë studentore janë:

- Universiteti i Kolnit, Instituti për teknologji dhe menaxhim të resurseve në viset tropikale dhe sub-tropikale,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)- Autoriteti i Qarkut të Pellgjeve Lumore,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMM),
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) - Departamenti i Mjedisit (DM),
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK),
- Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina”, Prishtinë,
- Ujësjiellësi Rajonal “HidroDrini”, Pejë,
- Kompanitë Ofruese të Ujitjes, etj.

Krahas praktikës, semestri i katërt i këtyre studimeve Master është i dedikuar për kërkimin dhe zhvillimin e tezës së magjistraturës, kur studentët fitojnë 20 ECTS shtesë. Përfundimi i tezave të Masterit u jep studentëve titullin Master i Shkencave në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore.

Për mbështetjen e Programit Master, përmes vizitave në terren, praktikës, hulumtimit për tezat e magjistraturës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Universiteti i Prishtinës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi që do të ofrojnë përfitime reciproke, për institucionet, kompanitë dhe studentët. Disa nga këto marrëveshje janë:

- Memorandum bashkëpunimi në mes të Technische Hochschule Koln, Faculty of Spatial, Development and Infrastructure Systems dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
- Memorandum bashkëpunimi në mes të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Faculty of Environmental and Mechanical Engineering, Poznan University of Life Sciences, Poland,
- Erasmus + Programme, Marrëveshje ndërinstucionale 2022-2024 në mes Universitat fur Bodenkultur Wien (University of Natural Resources and Life Sciences, Vienna dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
- Erasmus + Programme, Marrëveshje ndërinstucionale 2020-2023 në mes të University of Trento, Italy dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”,
- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Ndërtimtarisë lidhur me vlerësimin e gjendjes fizike të objekteve të dëmtuara në kuadër të kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz. 28 qershor 2021.
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Prishtinës, përkatësisht Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit (KRU) “Prishtina”.
- Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës, dhe Institutit “INKOS” Sh.A., 8 janar 2019, etj.

Këto marrëveshje, krahas shumë tjerave mund të gjenden në pjesën e Marrëveshjeve të bashkëpunimit në FN [T3].

Për sa i përket praktikës dhe diplomës së studentëve të MSc në MIRU, programi MIRU ka nënshkruar një marrëveshje me TH Köln [T15] për të mbështetur Partneritetin tonë Akademik në hartimin e një Programi për praktikë për studentët, si dhe për bashkëmentorimin/mbikëqyrjen e studentëve për përfundimin e punës së tyre kërkimore (punim diplome).

Kurrikula e programit për Programin MSc MIRU, me lëndë të shpërndara në semestra është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7. Pasqyrë e tabelës së programit Master në MIRU

Viti I						
Semestri I			Orët/ Javët			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U	ECTS	Profesor
1	O	Hyrje: MIRU dhe Siguria e Ujit	2	1	6	Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj
2	O	Hidrologji dhe Hidrometri	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj
3	O	Ekonomia e ujit dhe instrumentet financiare për implementimin e MIRU	2	2	6	Prof. Dr. Lars Ribbe/ Dr. Sudeh Dehnavi
4	O	Karakterizimi biofizik i ujërave	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Halil Ibrahim
5	Z	Metodat hulumtuese shkencore dhe studimi	2	0	3	Prof. Dr. Naser Kabashi
6	Z	Menaxhimi i Projekteve	2	0	3	Prof.ass.Dr. Sc. Zijadin Guri
7	Z	Meteorologjia	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Milot Muhaxheri
<i>Në semestrin e parë studenti arrin 24 ECTS nga lëndët obligative dhe duhet të zgjedhë 6 ECTS nga lëndët zgjedhore (zgjedh 2 nga 3 lëndët zgjedhore).</i>						
Semestri II			Orët/ Javët			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U	ECTS	Profesor
1	O	Ruajtja e ujit dhe dhe efikasiteti i ujit	2	2	6	Prof. Assoc.Dr.Figene Ahmedi
2	O	Monitorimi Mjedisor dhe Analiza e të dhënave	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Mimoza Hyseni Spahiu
3	O	Legjislacioni ujqor dhe qeverisja	2	0	3	Prof. Dr. Visar Morina
4	O	Menaxhimi i përmbytjeve dhe thatësirave	2	0	3	Prof. Assoc. Dr. Laura Kusari
5	O	Ndryshimet klimatike: Risku dhe aftësia ripërtëritëse	2	1	6	Prof. Dr. Lars Ribbe/ Dr. Sudeh Dehnavi
6	Z	Uji dhe Bujqësia	2	0	3	Prof. Dr. Arben Mehmeti
7	Z	Shëndeti Publik	2	0	3	Prof.Ass. Dr. Naim Jerliu
8	Z	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm	2	0	3	Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj
<i>Në semestrin e dytë studenti arrin 24 ECTS nga lëndët obligative dhe duhet të zgjedhë 6 ECTS nga lëndët zgjedhore (zgjedh 2 nga 3 lëndët zgjedhore).</i>						
Viti II						
Semestri III			Orët/ Javët			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U	ECTS	Profesor
1	O	Mjetet gjeohapësinore për zbatimin në MIRU	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Përparim Ameti
2	O	Uji dhe Konfliktet-Pushteti dhe Politika në Sektorin e Ujit	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Linda Gusia
3	O	Menaxhimi i bazuar në ekosisteme	2	2	6	Prof. Dr. Ferdije Zhushi Etemi
4	O	Strukturat Hidraulike	2	2	6	Prof. Assoc. Dr. Laura Kusari
5	Z	Hidroinformatikë/Modelimet Hidraulike	1	2	3	Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj
6	Z	Ndërmarrësia	2	0	3	Prof. Ass. Dr.Mjellma Carabregu
7	Z	Menaxhimi i pellgut ujëmbledhës	2	0	3	Prof. Assoc.Dr.Figene Ahmedi
<i>Në semestrin e tretë studenti arrin 24 ECTS nga lëndët obligative dhe duhet të zgjedhë 6 ECTS nga lëndët zgjedhore (zgjedh 2 nga 3 lëndët zgjedhore).</i>						

Semestri IV			Orēt/ Javēt			
Nr.	O/Z	Lēnda	L	U	ECTS	Profesor
1	O	Praktika			10	
2	O	Tema e Diplomēs			20	

Përshkrimi i lëndëve

Semestri i parë

Lënda: Hyrje MIRU dhe Siguria e Ujit

Mësimdhënës: Prof.Ass.Dr. Lavdim Osmanaj

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë prezanton të gjitha aspektet e menaxhimit dhe planifikimit të integruar të burimeve ujore. Kjo përfshin të kuptuarit e kornizave të ndryshme të aplikuara në menaxhimin e burimeve ujore me fokus në procesin e planifikimit si analiza e gjendjes, objektivat dhe kriteret, zhvillimi i strategjisë, pjesëmarrja dhe analiza e palëve të interesuara, roli i modelimit në menaxhimin dhe planifikimin e burimeve ujore.

Qëllimi i lëndës: Qëllimi i lëndës është të shpjegoj konceptet bazë në menaxhimin dhe planifikimin e burimeve ujore dhe të përshkruaj hapat në një proces planifikimi me pjesëmarrje; Të shpjegoj se si sistemet e mbështetjes së vendimeve dhe modelet e ndryshme mund të përdoren si mjete në planet e menaxhimit të ujit; Të shpjegoj se si zhvillohen dhe vlerësohen strategjitë e menaxhimit të ujit duke përdorur kriteret e ndryshme

Rezultatet e pritura të nxënimit: Pas përfundimit të këtij kursi, Përshkrimi i koncepteve dhe hapave kryesorë në menaxhimin dhe planifikimin e burimeve ujore; Identifikimi, analiza në mënyrë kritike dhe aplikimi në mjete dhe modele pjesëmarrëse siç janë sistemet e mbështetjes së vendimeve; Zhvillimi, krahasimi dhe vlerësimi i strategjive të menaxhimit të burimeve ujore duke përdorur analiza dhe kriteret e ndryshme.

Mjetet e konkretizimit: Shkumësi, tabela, projektori, kompjuteri, fletore pune, markerë, pajisje hidrologjike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime gjatë orës mësimore duke përdorur materiale të ndryshme, një punë projekti në grup prej 2-3 studentësh (punë e pavarur), detyra shtëpie individuale.

Metodologjia e vlerësimit të studentëve: Vlerësimi në detyra individuale të përfunduara në klasë 30%; Vlerësimi në detyra individuale të përfunduara në shtëpi 30% si dhe Vlerësimi në provimit 40%, gjithsej 100%.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: Literatura primare: Water Resource Systems Planning and Management-An Introduction to Methods, Models, and Applications. Daniel P. Loucks, EelcovanBeek. 2017. Literatura shtesë: A handbook for Integrated Water Resources Management in Basins. GWP (2009) IWRM-Training manual and operational guide. GWP (2005).

Lënda: Hidrologji dhe Hidrometri

Mësimdhënës: Prof.Ass.Dr. Lavdim Osmanaj

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë ofron një kuptim të përgjithshëm të proceseve në ciklin hidrologjik dhe faktorëve që rregullojnë këto procese, duke përfshirë rëndësinë, lidhjen dhe vlerësimin e këtyre faktorëve. Për më tepër, kjo lëndë ofron aftësi të dobishme për përdorimin e metodave statistikore dhe modeleve hidrologjike për të monitoruar, vlerësuar dhe analizuar ndryshueshmërinë hapësinore dhe kohore të disponueshmërisë së ujit.

Qëllimi i lëndës: Qëllimi i lëndë është të shpjegoj bazat e ciklit hidrologjik, bilancin e ujit dhe komponentët e tij; Të shpjegoj metoda dhe qasje të ndryshme për të analizuar dhe vlerësuar faktorët e bilancit të ujit; Të shpjegoj metoda dhe qasje të ndryshme për të kryer analiza në shkallën hapësinore dhe kohore të burimeve ujore të një pellgu; Të shpjegoj lloje të ndryshme të të dhënave të burimeve ujore dhe elemente të rëndësishme të një rrjeti monitorimi të të dhënave hidrologjike; Të shpjegoj modelet hidrologjike dhe përdorimin e tyre në vlerësimin hidrologjik.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të ketë këto njohuri, aftësi dhe kompetenca: Proceset kryesore hidrologjike, bilancit ujqor dhe komponentëve tij; Të kryej llogaritjet hidrologjike të bilancit ujqor, analiza statistikore të reshjeve, vlerësimi i evapotranspirationit; Të kryej një analizë hapësinore-kohore të burimeve ujore duke përdorur një sërë qasjesh statistikore; Vlerësimi dhe përmirësimi i dizajnit të monitorimit si për sasinë ashtu edhe për cilësinë e ujit për një pellg;

Mjetet e konkretizimit: Shkumësi, tabela, projektori, kompjuteri, fletore pune, markerë, pajisje hidrologjike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime gjatë orës mësimore duke përdorur materiale të ndryshme, një punë projekti në grup prej 2-3 studentësh, detyra shtëpie individuale.

Metodologjia e vlerësimit të studentëve: Vlerësimi në detyra individuale 30%; Vlerësimi në detyra individuale të përfunduara në shtëpi 30% si dhe Vlerësimi i provimit 40%, gjithsej 100%.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: Literatura primare: CHOW, 1964, Handbook of Applied Hydrology, Mc Graw-Hill Book Company, 1964. Dahmen, E. R., & Hall, M. J. (1990). World Meteorological Organization (1994). World Meteorological Organization. Literatura shtesë: Ward, R.C. and M. Robinson, 1990. Principles of Hydrology, Mc Graw- Hill, 365 pp, Maidment, D.R., ed., Handbook of Hydrology, Mc Graw-Hill, 1993.

Lënda: Ekonomia e Ujit dhe Instrumentet Financiare për Zbatimin e Manaxhimit e Integruar të Burimeve Ujore

Mësimdhënës: Prof. Lars Ribbe, Dr. Sudeh Dehnavi

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Pse ekonomia është e rëndësishme dhe e rëndësishme për menaxhimin e ujit? Ky kurs do të analizojë në mënyrë kritike disponueshmërinë dhe menaxhimin e ujit nga një perspektivë ekonomike. Ekonomia e burimeve ujore ofron mjete analitike për vendimmarrje në nivele të ndryshme dhe për sektorë të ndryshëm. Mjetet analitike do të përdoren për vlerësimin e politikave dhe projekteve dhe do të japin informacion kyç për menaxhimin e qëndrueshëm dhe të integruar të burimeve ujore.

Qëllimi i lëndës: *Ky kurs synon të aftësojë studentët me njohuri në ekonominë e ujit dhe të nxisë përdorimin e mjeteve analitike dhe financiare në vendimmarrje për menaxhim të qëndrueshëm dhe të integruar të burimeve ujore.*

Rezultatet e pritura të të nxënit: *Deri në fund të kursit, studentët do të:*

- *Të kuptojë dhe mund të përshkruajë terminologjinë dhe konceptet e përdorura për të studiuar ekonominë e çështjeve të ujit*
- *të kritikojë menaxhimin aktual të integruar të burimeve ujore, shpërndarjen dhe prioritizimin e ujit dhe sistemet e vendimmarrjes në dritën e ekonomisë së burimeve ujore*
- *vlerësimi i efikasitetit ekonomik dhe ndikimeve sociale të mjeteve të ndryshme analitike si metodat e çmimit të ujit, mjetet për optimizimin e shpërndarjes së ujit dhe mbulimin e kostos*
- *aplikimi i mjeteve të ndryshme analitike dhe financiare për vendimmarrje në nivele të ndryshme duke marrë parasysh menaxhimin e qëndrueshëm dhe të integruar të burimeve ujore*

Mjetet e konkretizimit: Shkumësi, tabela, projektori, kompjuteri, fletore pune, markerë, pajisje hidrologjike.

Metodologjia e mësimdhënies: *Ligjërata, ushtrime gjatë orës mësimore duke përdorur materiale të ndryshme, një punë projekti në grup prej 2-3 studentësh (punë e pavarur), detyra shtëpie individuale*

Metodologjia e vlerësimit të studentëve: *Detyra individuale të kryera në klasë 30%;*

Detyra individuale të kryera në shtëpi 30%;

Provimi 40%.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: W. M. Hanemann, CHAPTER 4

The economic conception of water, University of California. Berkeley, USA

In-Koo Cho, Sean P. Meyn, Efficiency and marginal cost pricing in dynamic competitive markets with friction, Theoretical Economics 5 (2010), 215–239 1555-7561/20100215

Sjödín, J., Zaeske, A., Joyce, J. 2016, Pricing instruments for sustainable water management.

Working paper Nr. 28. SIWI, Stockholm.

Jianjun Tang, Henk Folmer, Jianhong Xue, Technical and allocative efficiency of irrigation water use in the Guanzhong Plain, China, Food Policy, Volume 50, 2015, Pages 43-52, ISSN 0306-9192, <https://doi.org/10.1016/j.foodpol.2014.10.008>.

Lënda: Karakterizimi biofizik i ujërave**Mësimdhënës: Prof. Asoc. Dr. Halil Ibrahim****Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6**

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë do të ofrojë një hyrje në karakterizimin biologjik dhe fizik të ekosistemeve ujore. Ai do të ofrojë njohuri në lidhje me analizat e teknikave dhe mjeteve biofizike për karakterizimin biofizik të ujit, qasje të ndryshme për zbatimin e MIRU- menaxhimin e ujëmbledhësve, menaxhimin e pellgut si dhe analizat e karakterizimit biofizik nëpërmjet studimeve të rastit.

Qëllimi i lëndës: Qëllimi i lëndës është të kuptuarit e modeleve të karakteristikave fizike dhe biologjike të ekosistemeve ujore, përpunimi i njohurive mbi parashikimin dhe menaxhimin e dendësisë dhe diversitetit, biogeografisë, ndërveprimeve në rrjetat ushqimore .

Rezultatet e pritura të nxënësit: Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: Përcaktojnë vetitë fizike të ekosistemeve ujore dhe rolin e tyre në funksionimin e përgjithshëm të ekosistemit; Përcaktojnë vetitë biologjike të ekosistemeve ujore dhe rolin e tyre në funksionimin e përgjithshëm të ekosistemit; Të analizojnë karakterizimin biofizik të ujit në funksion të qasjeve të MIRU dhe menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse; Zbatojnë karakterizimin bazë biofizik të ekosistemeve të caktuara ujore.

Mjetet e konkretizimit: gjatë ligjëratave do të përdoren këto mjete: tabela, kompjuteri, projektori; në laborator do të përdoren mikroskopët, alkooli si konservues, pincetat, gilpera kurse në terren rrjeta për marrjen e mostrave, pllaka plastike, kavanoza qelqi, pinceta etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime gjatë orës mësimore duke përdorur materiale të ndryshme, një punë projekti në grup prej 2-3 studentësh, detyra shtëpie individuale.

Metodologjia e vlerësimit të studentëve: Të gjitha aktivitetet e studentëve do të vlerësohen vazhdimisht. Vlerësimi do të përfshijë vlerësimin e ndërmjetëm dhe përfundimtar; Vlerësimi i ndërmjetësve 50%; detyrat e shtëpisë dhe angazhimet e tjera 10%; frekuentimi 10%; Provimi përfundimtar 30%, gjithsej 100%.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: Literatura primare: Handbook of Inland Aquatic Ecosystem Management, Sven Jorgansen, Jose Galizia Tundisi, Takako Matsumura Tundisi 2009, CRC Press, 427 pp. Literatura shtesë: The Body Size: The Structure and Function of Aquatic Ecosystems, Editeb by: Alan Hildrew, Dave, Raffaelli, Ronni Edmonds Brown.

Lënda: Menaxhimi i Projekteve

Mësimdhënës: Dr. Sc Zijadin Guri

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Njohja me principet kryesore të Menaxhimit të Projekteve në Inxhinierinë e Ndërtimit dhe, fizibilitetet e projekteve inxhinierike formimet e grupeve dhe inicimet e projekteve të ndërtimit. Planifikimet në projekte të ndërtimit, kontrolli e cilësisë si dhe shkathtësitë e nevojshme që duhet të ketë një Inxhinier për të qenë Menaxher i Projektit të Ndërtimit.

Qëllimi i lëndës: Njohja dhe kuptimi i përdorimit të drejt të nocioneve themelore të menaxhimit të projektit në inxhinieri të ndërtimit në përgjithësi, si dhe principet kryesore të organizimit dhe menaxhimit të punës në projekte në veçanti.

Rezultatet e pritura të nxënësit: Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje të njoh, të kuptojë dhe të përdorë drejt nocionet themelore të menaxhimit në përgjithësi, si dhe principet kryesore të organizimit dhe menaxhimit të punës në projekte në veçanti , me qëllim që sa më lehtë të përballojë vështirësitë që e presin gjatë dhe pas këtyre studimeve.

Mjetet e konkretizimit: Gjatë ligjeratave do të përdoren: Tabela, porjektori, kompjuteri.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjerata, ushtrime, dhe punë seminarike.

Metodologjia e vlerësimit: Seminaret individuale dhe Vlerësimi i provimit final për detyrat e zgjidhura dhe përgjigjeve teorike.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: Literatura primare: Civil Engineering Project Management, A. C Twort and Gordon Rees. Literatura shtesë: Total Construction Project Management, George J. Ritz, 2013.

Lënda: Meteorologjia

Mësimdhënës: Prof. Ass. Milot Muhaxheri

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Historik i shkurtër i Meteorologjisë, Bazat e meteorologjisë, Shtresat e atmosferës dhe gazrat. Termodinamika e atmosferës. Rrezatimi i diellit dhe tokës, Të reshurat. Mënyrat e vëzhgimeve dhe parashikimeve meteorologjike. Ndotja e ajrit. Ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale. Instrumentet meteorologjike.

Qëllimi i lëndës: Qëllimi i lëndës është që të pajisë studentin me njohuritë bazike në fushën e meteorologjisë, si dhe të kuptojë parametrat që ndikojnë në ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale si dhe informatat bazike për instrumentet meteorologjike.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: Të përshkruan strukturën e atmosferës dhe si ndryshojnë parametrat meteorologjikë (temperatura, presioni i ajrit, lagështia) në kohë dhe hapësirë; të përshkruajë qarkullimin global të atmosferës, sistemet frontale dhe lëvizjet atmosferike; të përshkruajë klimën e Tokës dhe faktorët që ndikojnë në të; të përshkruajë se si kryhen vëzhgimet meteorologjike dhe si përdoren në punën e parashikimit; të kuptojë rëndësinë e ndryshime klimatike dhe procesin e ngrohjes globale; të dallon instrumentet që përdoren në fushën e meteorologjisë.

Mjetet e konkretizimit: Gjatë ligjëratave do të përdoren: Tabela, porjektori, kompjuteri si dhe instrumentet meteorologjike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat me prezantime, Seminar semestral me detyra konkrete, Diskutime gjatë ligjëratave; Ushtrime në grupe.

Metodologjia e vlerësimit: provim me shkrim 50%; provim me gojë 50%. Pjesa me gojë përfshinë edhe prezantimet.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: Literatura primare: Meteorology Today,

Donald Ahrens, 2009 Meteorologjia, Milosavljevic, M 1980 Prishtinë (përkthim në gjuhëshqipe).

Literatura shtesë: Practical Meteorology, Roland Stull 2015; State of Global Climate, WMO Instructor's Handbook on Meteorological Instrumentation, Fred Brock 1984.

Lënda: Metodatat hulumtuese shkencore dhe studimi

Mësimdhënës: Prof. Dr. Naser Kabashi

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Orientimet kryesore për metodatat hulumtuese shkencore; Analiza e të dhënave; Aplikacionet dhe raporti i të dhënave të orientojë studentet në metodatat aktuale në rritjen e hulumtimeve; Projekti, teknikat dhe prezentimet e analizave; zhvillimi i mundësisë së studenteve në efektivitetin e përdorimit të njohurive të fituara.

Qëllimi i lëndës: Metodatat hulumtuese në: Sasinë e ujërave; Kualitetin e ujërave; Mbrojtja e burimeve të ujit; Përmirësimi i kuptimit të burimeve; Përgjigjet në krizat e ujit,

Rezultatet e pritura të nxënësit: Kursi do të mundësojë njohuritë për studentët në këto pika: Veprimi në të dhënat që shfrytëzohen; Përgaditja e një hulumtimi preliminar për fushën përkatëse; Saktësia e grumbullimit të të dhënave dhe raportimi i të dhënave; Kontrollimi dhe analiza e të dhënave të gjetura dhe ndikimi i tyre në rezultatet dalëse.

Mjetet e konkretizimit: Gjatë ligjëratave do të përdoren këto mjete: tabela, kompjuteri, projektori.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt, detyrë shtëpie individuale).

Metodologjia e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është X%; Vijueshmëria e studentit X%; Detyrat individuale të kryera në klasë X%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi X%;

Vlerësimi nga testet X%; Provimi final X%.

Literatura bazë dhe shtesë për lëndën: Literatura primare: N.Kabashi; Metodologjia Hulumtuese në Inxhinieri, USHT, 2006 Research Methodology – C.R.Kothari.

Literatura shtesë: Geoffrey D.Gooch (Editor), Alistair Rieu-Clarke (Editor), Per Stalnacke (Editor); Integrating Water Resources Management: Interdisciplinary Methodologies and Strategies in Practice (European Commission Community Research).

Semestri i dytë

Lënda: Legjislacioni ujon dhe qeverisja

Mësimdhënës: Prof. Dr. Visar Morina

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Bazat e politikës dhe legjislacionit të ujit, vështrim historik dhe terma kyç, ndërhyrjet e shtetit dhe uji si një e drejtë ekonomike dhe njerëzore. Kurrikula e legjislacionit ujon përfshin një kurs të specializuar që ka të bëjë me parimet ligjore të përfshira në sigurimin, ndarjen, transferimin dhe menaxhimin e të drejtave të ujit për përdorime publike dhe private. Theksi parësor vihet në çështjet aktuale ligjore dhe të politikave, por lënda gjithashtu trajton aspekte të rëndësishme të zhvillimit historik të politikës së ujit dhe ligjit të ujit në Kosovë.

Qëllimi i lëndës: Të drejtat publike në burimet ujore; alokimi dhe mbrojtja e burimeve ujore nëntokësore; të drejtat publike në burimet ujore.

Rezultatet e pritura të nxëniet: Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të

Shpjegojnë konceptet/kornizat e ligjit dhe politikës ndërkombëtare të ujit dhe mjedisit; Të vlerësojnë se si ndikojnë ato në vendimmarrjen ndërkombëtare dhe lokale dhe anasjelltas në lidhje me konfliktet në lidhje me përdorimin, shpërndarjen dhe qeverisjen e burimeve natyrore

Të analizojnë problemet ndërkombëtare (kombëtare), rajonale dhe lokale të ujit dhe mjedisit dhe se si ligji, politikat, rregullimet institucionale, parimet dhe instrumentet mund të përdoren për të adresuar këto probleme të drejtësisë dhe qëndrueshmërisë së ujit dhe mjedisit. Të zbatojnë aftësitë akademike analitike të fituara për të analizuar ndërlidhjet midis çështjeve të ndryshme të ujit dhe mjedisit.

Mjetet e konkretizimit: Kompjuteri, tabela, fletore pune etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimi duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt, detyrë shtëpie individuale.

Metodologjia e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është X%, Vijueshmëria e studentit X%; Detyrat individuale të kryera në klasë X%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi X%; Vlerësimi nga testet X%; Provimi final X%.

Literatura bazë dhe shtesë: Literatura primare: Veselaj, Zeqir. "Principles of Sustainable Development as Norms of the Current Legislative Framework in Kosovo." European Journal of Sustainable Development Research 3.4 (2019): Goldfarb, William. Waterlaw. CRC Press, 2020.

Lënda: Ndryshimet klimatike: Risku dhe aftësia ripërtëritëse

Mësimdhënës: Prof. Dr. Lars Ribbe (dhe profesori vizitor)

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Ndryshimet klimatike dhe ndryshueshmëria e parametrave klimatikë nga njëra anë kanë ndikime të thella në sigurinë ujore ndërsa nga ana tjetër një pjesë e madhe e masave të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike lidhen me menaxhimin e burimeve ujore. Ky kurs do të ofrojë një diskutim modern mbi ndryshimet klimatike të shkaktuara nga njeriu dhe ndikimet e rëndësishme në mjedisin natyror, të ndërtuar dhe njerëzor, metodat e vlerësimit, monitorimit dhe parashikimit të rrezikut si dhe përshtatjen përmes zgjidhjeve adekuate duke përfshirë menaxhimin e informacionit dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë. Studentët do të mësojnë rreth përgatitjes së planeve adekuate për të arritur sigurinë e ujit dhe për të ndërtuar elasticitet ndaj ndryshimeve klimatike..

Qëllimi i lëndës: Kursi do të sigurojë një pasqyrë të gjendjes së teknologjisë mbi ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tij në menaxhimin e ujit, si dhe konceptet e lidhura me vlerësimin e rrezikut, përshtatjen dhe elasticitetin.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Pas përfundimit, studentët duhet të jetë në gjendje të:

- Përshkruajnë funksionimin bazë të sistemit global të klimës dhe ndërveprimin e tij me sistemet e tjera kryesore (biosferë, atmosferë, hidrosferë)
- Identifikimi i variablave kyç të ciklit të ujit që ndikohen nga klima dhe ndryshimet e tjera mjedisore.
- Specifikimi dhe përcaktimi i ndryshueshmërinë hapësinore, sezonale dhe ndërvjetore të variablave të rëndësishëm.
- Zbatimi i metodave të vlerësimit të rrezikut klimatik
- Përshkrimi i metodave dhe produkteve të rëndësishme të parashikimit në terma afat-shkurtër dhe afat-mesëm
- Identifikimi i masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe elasticitetit në lidhje me rreziqet e ndryshimeve klimatike që lidhen me ujin.
- Njohja me të dhënat të hapura dhe mjete për të mbështetur vlerësimin e rrezikut dhe planifikimin e përshtatjes.

Mjetet e konkretizimit: Kompjuteri, tabela, fletore pune etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Klasat: leksionet e regjistruara dhe materialet mësimore ofrohen në internet; dialogu, diskursi dhe komentet e ofruara në sesionin interaktiv në klasë; ushtrimet e ofruara online dhe rezultatet e diskutuara në klasë;

Metodologjia e vlerësimit: Vlerësimi në mes të semstrit (provim i shkurtër me gojë I kombinuar me prezantim 40%) Raport final me shkrim (60%)

Literatura bazë dhe shtesë: Ribbe, L., (2022), Lecture notes; . IPCC [Intergovernmental Panel on Climate Change] (2012) Raporti Special në Menaxhimin e Riskut dhe Eventeve ekstreme të motit për të avancuar në Adaptimin e Ndryshimeve Klimatike (SREX); *IPCC 2021 Climate Change: Baza fizike. Kontributi nga Grupi I në Raportin e Vlerësimit* Numër 6 të IPCC; *IPCC 2022 Ndryshimet Klimatike: Ndikimet, përshtatja dhe cenueshmëria. Kontributi i Grupit të Punës II në Raportin e Gjashtë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike; Zgjidhje të bazuara në natyrë për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë: Zyra e OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, Angazhimi për elasticitet në mbështetje të Kornizës Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030; UNDP [Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim] (2010) Përfshirja e Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive në Zhvillim në Nivel Kombëtar. Një kornizë praktike. Byroja e UNDP-së për*

Parandalimin dhe Rimëkëmbjen e Krizave; Përfshirja e Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive në Zhvillim në Nivel Kombëtar. Një kornizë praktike. Byroja e UNDP-së për Parandalimin dhe Rimëkëmbjen e Krizave; UNDRR [Strategjia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Fatkeqësive (2019).

Lënda: Menaxhimi i përmytjeve dhe thatësirave

Mësimdhënës: Prof. Dr. Laura Kusari

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Lënda përmban hyrje në teorinë e menaxhimit të përmytjeve dhe thatësirave. Morfologjinë elementare të pellgut dhe ujërrjedhes. Llojet e përmytjeve. Sistemet për paralajmërimin dhe parashikimin e përmytjeve. Masat zbutëse ndaj përmytjeve, jo strukturore dhe strukturore. Përmytja në zonat urbane. Rrafshet vërshuese në mbrojtjen nga përmytjet. Hyrje në konceptet e riskut të thatësirave, klasifikimi i thatësirave dhe ndikimi i tyre. Vlerësimi dhe monitorimi i ndryshueshmërisë së thatësirave, Analiza dhe parashikimi i thatësirave. Monitorimi i thatësirave dhe paralajmërimi i hershëm. Strategjitë për menaxhimin e riskut, Masat jo strukturore dhe strukturore. Masat adaptuese ndaj thatësirave.

Qëllimi i lëndës: Të kuptuarit dhe aplikimi i metodave dhe konceptëve të menaxhimit të integruar të përmytjeve dhe thatësirave. Kuptimi dhe aplikimi i koncepteve bazike shkencore, të dhënat dhe mjetet e nevojshme për vlerësimin dhe menaxhimin e integruar të përmytjeve dhe thatësirave.

Rezultatet e pritura të të nxënimit: Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë i aftë të:

Kuptojë konceptet e përmytjeve dhe thatësirave, Identifikojë faktorët e riskut të përmytjeve dhe thatësirave dhe masat lehtësuese për to, Kuptojë dhe shpjegojë principet kryesore të parashikimit dhe paralajmërimin të përmytjeve dhe thatësirave, dhe qështjeve që kanë të bëjnë me parashikimin e tyre, Jetë në gjendje të zgjedhë masat lehtësuese për lokacionin e caktuar,

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, detyrat individuale, diskutime në grup, punim seminarik individual, prezantime në klasë.

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e vlerësimit: Vlerësimi i parë mes semestral, 40%, Vlerësimi i dytë, 40% Seminarët, detyrat individuale, prezantimet 20%.

Literatura bazë dhe shtesë: Environment Agency (2020), National Flood and Coastal Erosion Risk Management Strategy for England, APS Group; Watson, D., Adams, M., (2011), Design for Flooding, Architecture, Landscape and Urban Design for Resilience to Climate Change, John Wiley and Sons; Schanze, J., Zeman, E., Marsalek, J., (2004).

Lënda: Monitorimi Mjedisor dhe Analiza e të dhënave

Mësimdhënës: Prof. Asoc. Dr. Mimoza Hyseni Spahiu

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë përfshin hyrje në monitorimin e mjedisit, teknikat e marrjes së mostrave dhe metodat analitike dhe statistikore për të matur dhe dokumentuar ndotjen e mjedisit në ajër, tokë, sedimente dhe fokusin kryesor tek uji. Kjo lëndë nxjerr në pah burimet e ndotësve, llojet e ndotësve, bioshënuesit mjedisorë, teknikat e marrjes së mostrave, përzgjedhjen e instrumenteve, sistemet e monitorimit të sistemeve mjedisore në kohë reale dhe menaxhimin e mostrës. Lënda prezanton aplikime për atmosferën dhe rrezatimin, motin, cilësinë e ajrit, hidrologjinë, cilësinë e ujit, ekosistemet tokësore dhe ekosistemet ujore.

Qëllimi i lëndës: Monitorimi është kritik për vlerësimin e rreziqeve mjedisore. Teknikat standarde të marrjes së mostrave dhe analitike janë zhvilluar për të vlerësuar nivelet e ndotësve për një sërë sferash, duke përfshirë ujin, ajrin dhe sistemet e gjalla. Metodatat e reja analitike zhvillohen gjithashtu kur metodatat ekzistuese janë të pamjaftueshme për të përcaktuar sasinë e niveleve të ndotësve. Megjithatë, teknikat për marrjen e mostrave janë mjaft standarde. Qëllimet e kësaj lënde janë që të prezantoj teknikat e marrjes së mostrave dhe metodatat analitike për përcaktimin e niveleve të ndotësve. Studentët do të mësojnë dhe praktikojnë shumë metoda për të qenë në gjendje të mbledhin mostra në kërkimin e tyre dhe në profesionet e tyre.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Pas përfundimit të lëndës studenti do të jetë në gjendje të: Të kuptojnë terminologjinë bazë në lidhje me ndotjet mjedisore, monitorimin, ndotësit dhe ekosistemet; Zbatimi i teknikave mjedisore të marrjes së mostrave në praktikë për ujin; Të klasifikojë dhe kategorizojë burimet dhe llojet e ndotjes.

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimi duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt, detyrë shtëpie.

Metodologjia e vlerësimit: Vlerësimi i parë 30%; Vlerësimi i dytë 30%; Pjesëmarrja 10%; Provimi final 30%.

Literatura bazë dhe shtesë: Literatura primare: Environmental monitoring Hilary I. Inyang, John I. Daniels; Eolss publications, 2009. Literatura shtesë: Macrophytes as biological indicators of organic pollution in the Lepenci River Basin in Kosovo; Journal of Freshwater Ecology (2020).

Lëndës: Ruajtja e ujit dhe efikasiteti i ujit

Mësimdhënës: Prof.Asoc.Dr. Figene Ahmedi

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i kursit: Në përgjithësi, lënda trajton nevojën për menaxhim të qëndrueshëm të resurseve ujore. Lënda ofron një pasqyrë të koncepteve bazë të ruajtjes së ujit dhe efikasitetit të ujit. Temat e mbuluara: Hyrje në ruajtjen e ujit, analizat e problemeve të shkaktuara nga menaxhimi i dobët i ujit, teknologjitë alternative për ruajtjen e ujit, trajtimin, ripërdorimin dhe riciklimin e ujit, ripërdorimin e ujërave të zeza shtëpiake dhe të vogla komerciale, instrumentet, matja e rrjedhjes dhe shpenzimit.

Qëllimi i lëndës: Rritja e kërkesës për menaxhim të qëndrueshëm të ujit në përgjithësi në vendin tonë imponon nevojën për të siguruar disponueshmërinë e ujit për brezat e ardhshëm. Objektivat mësimore të kësaj lënde janë: Rëndësia e ruajtjes së ujit dhe efikasitetit të ujit ; Krijimi i një procesi për të informuar, përfshirë dhe edukuar publikun (aktorët/at) mbi çështjet që lidhen me ruajtjen e ujit.

Rezultatet e pritura të nxënësit: Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: Vlerësojnë dhe përdorin informacionin e mbledhur nga studimet dhe aplikimet e literaturës shkencore në lidhje me ruajtjen e ujit dhe efikasitetin e ujit. Analizojnë teknologjitë e ruajtjes dhe përcaktojnë hapat për kursimin e ujit. Identifikojnë matësin e duhur të rrjedhjes për efikasitetin e ujit .Identifikojnë problemet dhe mendojnë në mënyrë inovative për mënyrat për të kursyer ose ripërdorur ujin. Përgatisin një prezantim dhe raport në anglisht për ruajtjen e ujit.

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Lënda zhvillohet përmes ligjëratave të ofruara në formë skripte, ushtrimeve në klasë dhe në shtëpi.

Metodologjia e vlerësimit: Vlerësimi bëhet nga 0-100 % Vlerësimi i parë 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Punimi 30% Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare; Provimi final 70 %.

Literatura bazë dhe shtesë: Literatura primare: Ahmedi, F. Shenime të ofruara në gjuhën angleze. Literatura shtesë:Sturman, J et al., Water Auditing and Water Conservation, 2004, IWA, UK. Seneviratne, M. A Practical Approach to Water Conservation for Commercial and Industrial Facilities, 2007, ElsevierLtd.

Lëndës: Uji dhe Bujqësia

Mësimdhënës: Prof. Dr. Arben Mehmeti

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i kursit: Ky kurs është përgatitur për të ofruar shumë aspekte themelore dhe aplikative të praktikave të ujitjes së kulturave bujqësore dhe menaxhimit të resurseve ujore. Lënda shpjegon për biologjin e tokës dhe karakteristikat e lëndës organike në tokë. Klasifikimin e tokave, relacionin tokë-ujë dhe kapacitetin ujor të tokave. Gjithashtu edhe shkallën e avullimit, format dhe modulet e ujitjes të kulturave bujqësore, komponentët e shpërndarjes së sistemit të ujitjes, përfshirë edhe planifikimin për ujitje.

Qëllimi i lëndës: Të ofroj studentëve njohuri bazë për biologjin e tokave, lenden organike dhe klasifikimin e tokave. Njohuri për faktorët dhe proceset agrogjeologjike dhe pedologjike me qëllim të avancimit pozitiv të tyre. Menaxhimin e drejt të resurseve ujore për nevojat e prodhimit bimor. Të ofrojë njohuri për studentët për ujerat, shfrytëzimin e ujit në bujqësi, sistemet e ujitjes, ndotësit e ujerave në bujqësi dhe monitorimin e ujërave nga ndotësit në prodhimtarin bujqësore.

Rezultatet e pritura të nxënësit: Të aftësohen për të përshkruar karakteristikat/vetitë agrogjeologjike, pedologjike, por edhe vetitë biologjike të tokës; Të identifikojn nevojat e bimëve për ujitje dhe të vlerësojnë shkallën e avullimit; Të dijnë për format e ujitjes dhe cilësitë e ujit dhe të menaxhojnë drejt burimet e ujit në ujitjet e bimëve; Të dijnë të përshkruajn proceset themelore hidrologjike dhe rexhimin dhe bilancin ujor të tokës; Të identifikojn paraqitjen, rrjedhën dhe ruajtjen e ujërave nëntokësore; Të njohin dhe monitorojn ndotësit e ujerave.

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt.

Metodologjia e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%, Vijueshmëria e studentit 5%; Detyrat individuale të kryera në klasë 10%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 5%; Vlerësimi nga testet 30%; Provimi final 50%.

Literatura bazë dhe shtesë: Literatura primare: Srivastava, P., Gupta, M., Tsakiris, G., and Quinn, N. (2020). Agricultural Water Management Theories and Practices. Elsevier. Huang, P. M., Li, Y., Sumner, M. E. (2011). Organisation for Economic Co-Operation Development (OECD). (2012). Water Quality and Agriculture. IWA Publishing Laycock, A. (2010). Irrigation Systems: Design, Planning and Construction. CABI; Reprint edition.

Lënda: Shëndeti Publik

Mësimdhënës: Prof.ass. Dr, Naim Jerliu

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë trajton tema të rëndësishme dhe qasje metodologjike në fushën e shëndetit publik lidhur me menaxhimin e resurseve ujore. Në mënyrë të veçantë, lënda mbulon aplikimin dhe domenet e shëndetit publik: Shëndeti publik i lidhur me ujin (sasia e ujit, cilësia e ujit, sëmundjet e lidhura me ujin; sanitacioni, programet e monitorimit, studimet e rasteve) Menaxhimi i ciklit të ujit urban (dizajni sensitiv ndaj ujit; qyteti sfungjer; riciklim, ripërdorimi). Teknologjitë e trajtimit të ujërave (karakteristikat e ujërave të zeza; teknologjitë biologjike).

Qëllimi i lëndës: Lënda synon të ofrojë njohuri themelore mbi shëndetin publik, sanitacionin, menaxhimin e burimeve ujore urbane, si dhe opsionet teknologjike dhe menaxheriale për t'i adresuar ato, në një kontekst global dhe kosovar.

Rezultatet e pritura të nxënimit: Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të: Definojë shëndetin publik dhe çështjet e shëndetit publik që lidhen me ujin (sasia e ujit, cilësia e ujit, sëmundjet e lidhura me ujin; sanitacioni, higjiena dhe shëndeti; programet e monitorimit, studimet e rasteve); Të kuptojë menaxhimin e ciklit të ujit urban (dizajni sensitive ndaj ujit; qyteti sfungjer; riciklimi dhe ripërdorimi); Përshkruajë teknologjitë e trajtimit të ujit (karakteristikat e ujërave të zeza; teknologjitë biologjike dhe membranore); Diskutojë konceptet sanitare të integruara në kontekstin e tranzicioneve të qëndrueshmërisë (studim rasti); **Mjetet e konkretizimit:** projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Lënda zhvillohet nëpërmjet ligjëratave me inute të njohurive bazike, me shembuj/studime rasti, detyra PBL (mësim i bazuar në probleme), diskutime në grupe ndërvepruese në klasë, punë me projekte /seminare/workshope, detyra shtëpie individuale dhe prezantime në grup.

Metodologjia e vlerësimit: Pjesëmarrja e rregullt / Aktiviteti në klasë / Ndërveprimi: 10%; Seminare, prezantime të përgjigjeve për temën/aktivitetin: 10%; Projekt/detyra individuale me shkrim: 20%; Provimi përfundimtar/Provimi me shkrim: 60%.

Literatura bazë dhe shtesë: Literatura primare: Robert H. Friis. Essentials of environmental health. Third edition. Burlington, MA: Jones & Bartlett Learning. (2019) Howard Frumkin, Editor. Environmental Health: From Global to Local. Third Edition. John Wiley & Sons. (2016). WHO. Water, Sanitation and Hygiene strategy 2018-2025.

Lënda: Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Mësimdhënës: Prof.Ass.Dr. Lavdim Osmanaj

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Lënda është e dizajnuar që të ofroj një kuptim të përgjithshme për konceptin e OZZQ-ve. OZHQ-të janë interaksion në mes të mjedisit, shoqërisë dhe ekonomisë. Lënda eksploron konceptet e OZHQ-ve në shkallë të ndryshme gjeografike (lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare). Në shqyrtojmë aplikimet, treguesit, mjetet matëse të OZHQ-ve për analiza dhe vendimmarrje në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor me fokus në sektorin e ujin nga një perspektivë kombëtare.

Qëllimi i lëndës: Kuptimi i konceptit bazë të Objektivate të Zhvillimit të Qëndrueshëmve. Njohja e historisë së idesë, metodologjisë dhe perspektives së OZHQ-ve. Sqarimi i marrëdhënieve të SDG me shoqërinë, ekonominë, arsimin, ujin, ndryshimet klimatike, politikat dhe qeverisjen. Sqarimi i përfitimeve mjedisore, social, ekonomike nga OZHQ-ve dhe si ato janë të ndërlidhura me një komunitet të shëndetshëm.

Rezultatet e pritura të nxënësit: Njohja me kuptimin bazik të koncepteve të Objektivate të Zhvillimit të Qëndrueshëmve; Njohja me metodologjinë dhe instrumentet përdorim të OZGQ-ve në procesin e hartimit të Planeve Menaxhuese të Integruara. Vlerësimi dhe përmirësimi i politikave dhe qeverisjes bazuar në shfrytëzimin e OZHQ-ve. Stimulimi i të nxënësit dhe ofrimi i përvojave praktike në adresimin e çështjeve që ndërlidhen me OZHQ.

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt.

Metodologjia e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%, Vijueshmëria e studentit 5%; Detyrat individuale të kryera në klasë 30%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 50 %;

Literatura bazë dhe shtesë: Literatura primare: United Nations. Sustainable Development Goals. LealFilho, W.; Azeiteiro, U.; Alves, F.; Pace, P.; Mifsud, M.; Brandli, L.; Caeiro, S.; Disterheft, A. Reinvigorating the sustainable development research agenda: The role of the sustainable development goals (SDG). Literaturë shtesë: United Nations Conference on Sustainable Development Outcome Document: The future we want. A/CONF.216/L.1 of 19, Development cooperation in the light of sustainable development.

Semestri i tretë

Lënda: Menaxhimi i bazuar në ekosisteme

Mësimdhënës: Prof. Dr. Ferdije Zhushi Etemi

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë do të përfshijë temat që janë fundamentale për menagjerët e ardhshëm të resurseve ujore në vend. Në fillim studentët do të njihen me Kornizën Europiane të ujërave, e cila ka për objekt Menaxhimin e pellgjeve lumore. Kursi do të përfshijë keto ekosisteme: Liqenet, rezervoaret, pusët (kenetat), lumenjte, ligatinat, etj. Temat në vazhdim do të jenë objekt diskutimi: Pellgjet lumore të Kosovës, Biodiversiteti i ujërave të ëmbla, habitatet dhe shërbimet e ekosistemeve.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi të avancuara në lidhje me ekosistemet e ujërave të ëmbla dhe menaxhimin e tyre, me fokus kryesor menaxhimin e pellgjeve lumore. Lënda synon të zhvillojë te studentët njohuri për burimet e ujërave të ëmbla, biodiversitetin e tyre dhe përdorimin e parametrave biologjik të cilësisë në përcaktimin e statusit ekologjik të ekosistemeve ujore si dhe me ndikimin antropogjen në ekosistemet bregore dhe restaurimi i tyre.

Rezultatet e pritura të nxënësve: Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të ketë këto njohuri, aftësi dhe kompetenca: Posedon njohuri dhe kupton mirë konceptet e ekosistemeve të ujërave të ëmbla. Kupton dinamikën e ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe proceset biologjike, mjedisore dhe sociale që formësojnë funksionin dhe shërbimet e ekosistemit. Demonstron njohuri dhe aftësi për të identifikuar grupet kryesore të organizmave të ujërave të ëmbla dhe përdorimin e tyre në vlerësimin e statusit ekologjik të ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe monitorimin e tyre.

Mjetet e konkretizimit: tabela, kompjuteri, projektori; në laborator do të përdoren mikroskopët bionokular, alkooli si konservues, pincetat, gilperatr kurse në terren rrjeta për marrjen e mostrave, pllaka plastike, kavanoza qelqi, pinceta, etj.

Metodologjia e mësimdhënies: ligjërata, seminar, punë në terren, (mbledhja e organizmave ujorë, kafshëve dhe bimëve, në një ekosistem lumor, ndarja, klasifikimi dhe përdorimi i tij për vlerësimin e cilësisë së ujit).

Metodologjia e vlerësimit të studentëve: Pjesa teorike: seminar (Ese): 30% . Provimi përfundimtar: 40%. Pjesa praktike: punë në terren dhe dorëzimi i punimit 30%, gjithsej 100%.

Lënda: Mjetet gjeohapësinore për zbatimin në MIRU

Mësimdhënës: Prof.Assoc. Dr Perparim Ameti

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Sistemet e informacionit gjeografik dhe analiza hapësinore është një kurs me rëndësi të madhe në vëzhgimin dhe menaxhimin e ujërave. Gjatë këtij kursi studentët kanë mundësinë të fitojnë njohuri themelore teorike dhe praktike për GIS, zbatimin praktik të tij në zgjidhjen e problemeve në shoqëri, komponentët e tij (harduer, softuer, të dhëna dhe njerëz), përvetësimin dhe integrimin e të dhënave, analizat hapësinore, gjeostatistikën, vendimmarrjen, mbështetje, menaxhim i projekteve të GI, aplikacioneve dhe tendencave në GIS.

Qëllimi i lëndës: Ky kurs synon të mësojë nivele më të larta të shkencës së gjeoinformacionit dhe metodave për analizat dhe menaxhimin e ujit.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Njohja me konceptet dhe termat kryesore të GIS; Identifikimi i komponentëve kryesorë të GIS nga pikëpamja teknike dhe organizative; Aplikimi i operatorë hapësinorë, p.sh. përshkrimi i formave të veçorive si dhe i modeleve hapësinore, gjetja e një rruge më të shkurtër, dukshmëria e modelit; Njohja e problemeve në përdorimin e vëzhgimit të tokës në analizën e tokës dhe ujit; Përdorimi i teknika gjeostatistikore për zgjidhjen e problemeve praktike; Të jetë në gjendje të simulojë proceset hapësinore; Shpjegimi i përfitimet e integrimit të informacionit hapësinor në TIK.

Mjetet e konkretizimit: projektori, kompjuteri, tabela, fletore pune, marker.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, Diskutime gjatë ligjëratave, ushtrime, punë në grupe.

Metodologjia e vlerësimit: Kushtet për vlerësim: më shumë se 50% pjesëmarrje në ligjëratat dhe vlerësim pozitiv i punimit seminarik nga ligjëruesi. Vlerësimi i parë: 15%. Vlerësimi i dytë: 15%. Detyrat e shtëpisë: 30%. Vijimi i rregullt: 10%. Provimi final: 30% Total: 100%.

Literatura bazë dhe shtesë: K. T. Chang: Introduction to Geographic Information Systems, McGraw-Hill International Edition, 6th Edition, 2011. M. de Smith - P. Longley - M. Goodchild: Geospatial Analysis - A comprehensive guide, Winchester Press, 4th Edition, 2012. Campbell J.E., Shin M. Geographic Information System Basics. V.1. 2012. Literaturë shtesë: P. Longley et al.: Geographic Information Systems and Science, 2nd Edition, John Wiley & Sons Ltd., 2005. Kainz W. Geographic Information Science (GIS). 2004.

Lënda: Strukturat Hidraulike

Mësimdhënës: Prof. Dr Laura Kusari

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i kursit: Lenda Strukturat Hidraulike u ofron studenteve bazat e hidraulike që janë të nevojshme për të pasur një njohuri të duhur në projektimin dhe konceptet hidraulike të projektimit në strukturat në inxhinierinë e lumenjeve, pendat dhe struktura të tjera percjellese.

Qëllimi i lëndës: Ky kurs synon të mësojë nivele më të larta të shkencës së gjeoinformacionit dhe metodave për analizat dhe menaxhimin e ujit.

Rezultatet e pritura të nxënësit: Pas perfundimit të sukseshme të kësaj lende, studenti do të jetë i aftë që të: Kuptojë principet e Hidraulikës, rrjedhjes në kanale të hapura dhe rrjedhjes nëpër gypa, Kuptojë morfologjinë e lumenjeve dhe intervenimet në inxhinierinë e lumenjeve, Projektojë dhe vizatojë një profil të lumit dhe ndryshim të trases së tij, Të bëjë dallimin në mes të llojeve të ndryshme të pendëve, Zgjedhë, vizatijë dhe të konstruktojë një strukturë hidraulike për rregullim të lumenjeve, Të projektojë kanale dhe penda të ndryshme.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, detyrat individuale, diskutime në grup, punim seminarik individual, prezantime në klase).

Mjetet e konkretizimit: tabela, kompjuteri, projektori, marker.

Metodologjia e vlerësimit: Vlerësimi i parë mes semestral, 40% Vlerësimi i dytë, 40% Seminaret, detyrat individuale, prezantimet 20%.

Literatura bazë dhe shtesë: L. Kusari, (2021), Shenime të ligjeratave

Literaturë shtesë: Sturm, T., (2009), Open Channel Hydraulics, McGraw-Hill Education;

Lindell, J., Moore, W.P., Kong, H.W., (2018). Handbook of Hydraulics, McGraw-Hill Education.
Przedwojski, B. et al., (1997), River training Techniques. Fundamentals, Design and Applications. Published by A. A. Balkema, Netherlands.

Lënda: Uji dhe Konfliktet-pushteti dhe politika ne sektorin e ujit

Mësimdhënës: Dr. Linda Gusia

Statusi i lëndës: Obligative, Vlera në kredi – ECTS: 6

Përshkrimi i lëndës: Ky kurs bazohet në premisat se çështjet mjedisore janë po ashtu çështje sociale. Më konkretisht, praktikat, qëndrimet, strukturat sociale dhe institucionet tona formojnë mënyrat në të cilat ne ndërveprojmë me mjedisin, përfshirë këtu ujin. Ne do të shikojmë se si kultura formon kuptimet që ju mveshim fenomeneve të ndryshme dhe fuqinë e ideve në krahasim me kategoritë e tjera të njohurive. Ky kurs prezanton dhe integron të menduarit sociologjik dhe studimet gjinore në të kuptuarit e drejtësisë mjedisore dhe politikës së ujit.

Qëllimi i lëndës: lënda synon të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve për çështjet e ujit dhe t'u sigurojë atyre një bazë për të menduar në mënyrë kritike, për të vepruar drejt një të ardhmeje të pasigurt të diktuar nga kriza klimatike. Lënda perpiqet që përmes një kornizë dhe metodologji të shkencave sociale të ofrojë një njohje me të hollesishme të konflikteve rreth ujrave . Lënda shpjegoni rëndësinë e të kuptuarit të konteksteve sociale, politikave dhe historise të konflikteve të ujit duke analizuar po ashtu dhe rreziqeve në rritje rreth konfliktit të ujit.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Përshkruan sesi uji përveç komponentës mjedisore, ka dhe atë sociologjike, politike dhe ekonomike, që formësojnë aktivitetet e tona të përditshme. Përshkruan pabarazitë sociale dhe konfliktin që lidhen me konsumin dhe shpërndarjen e ujit. Identifikon aktorët dhe institucioneve të lidhura me sfidat bashkëkohore të ujit.

Mjetet e konkretizimit: tabela, kompjuteri, projektori, markeri.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, detyrat individuale, diskutime në grup, punim seminarik individual, prezentime ne klase.

Metodologjia e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10; Detyrat individuale të kryera në klasë 15%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 20%; Provimi final 40 %.)

Literatura bazë dhe shtesë: Escobar, Arturo. Hapatdrejtnjëkologjiejepolitikeantiesencialiste. *Current Anthropology*, 40:1 (february 1999) pp: 1-30. Cielo, Cristina, LissetCoba, & Ivette Vallejo. “Women, nature, and development in sites of Ecuador’s petroleum circuit.” *Economic Anthropology* 2016: 119-132 pp. Literaturë shtesë: UN Women. *Mainstreaming Gender in Green Climate Fund Projects*. GCF, 2017. Jha, Nitish. “Gender and decision making in Balinese agriculture.” *American Ethnologist* 31(4) 2004: 552-572. Living Planet Index.

Lënda: Hidroinformatikë / Modelimet Hidraulike

Mësimdhënës: Prof.Ass.Dr. Lavdim Osmanaj

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Ky kurs ka dy qëllime kryesore: së pari, lënda kërkon të japë një hyrje dhe sfond gjithëpërfshirës të koncepteve dhe ekuacioneve të përgjithshme për inxhinierinë hidraulike dhe rrjedhën e ujërave nëntokësore; së dyti, ofron aplikime praktike të sistemeve të modelimit si modelet HEC-RAS dhe HEC-SSP për rrjedhjen në kanal të hapur në inxhinierinë hidraulike dhe modelin MODFLOW për rrjedhën e ujërave nëntokësore. Këto modele të ndryshme mund të përdoren si mbështetje në proceset vendimmarrëse në pellgjet lumore.

Qëllimi i lëndës: Të shpjegoj llojet e ndryshme të kushteve të rrjedhjes; Të shpjegoj ligjet e ruajtjes në inxhinierinë hidraulike; Të shpjegoj modelet hidraulike për të analizuar kushtet e rrjedhës në rrjedhën me kanal të hapur; Të shpjegoj parimet dhe ekuacionet e lëvizjes së ujërave nëntokësore; Të shpjegoj se si të përdoret sistemi modelimit të ujërave nëntokësore.

Rezultatet e pritura të nxënësit: Klasifikimi i kushteve të lëvizjes së lëngjeve; -Zbatimi i ligjeve të ruajtjes për të zgjidhur problemet në inxhinierinë hidraulike; - Aplikimi i modeleve hidraulike si HEC-RAS dhe HEC-SSP për të analizuar rrjedhën në kanal të hapur; - Zbatimi i ekuacioneve të ujërave nëntokësore për të zgjidhur problemet e rrjedhës së ujërave nëntokësore; - Zbatimi i sistemit të modelimit MODFLOW për të zgjidhur problemet e rrjedhës së ujërave nëntokësore.

Mjetet e konkretizimit: tabela, kompjuteri, projektori, markeri.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, Diskutime gjatë ligjëratave, ushtrime, punë në grupe.

Metodologjia e vlerësimit: Detyra individuale të përfunduara në klasë 30%; Detyra individuale të përfunduara në shtëpi 30%; Provimi 40%.

Literatura bazë dhe shtesë: Chow, V.T., 1959, Open-channel hydraulics: New York, McGraw-Hill, 680 p. <http://heidarpour.iut.ac.ir/sites/heidarpour.iut.ac.ir/files/u32/open-chow.pdf> Kundu P, Cohen I and Dowling D, Fluid Mechanics (2015), A.W., E.R. Banta, M.C. Hill, and M.G. McDonald, MODFLOW–2000 – “The U.S. Geological Survey Modular Ground – Water Model – User Guide to Modularization Concepts and the Ground – Water Flow Process, U.S., 2000. Literatura shtesë: Harbaugh, A.W., and M.G. McDonald, - “User’s Documentation for MODFLOW–96, An update to the United States Geological Survey Modular Finite Difference Groundwater Flow Model, U.S. Geological Survey Open – File Report 96 – 485, 56 pp, 1966.

Lënda: Menaxhimi i pellgut ujëmbledhës

Mësimdhënës: Prof.Asoc.Dr. Figene Ahmedi

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Hyrje në menaxhimin e pellgut ujëmbledhës; planifikimi i përdorimit të tokës, zbutja e fatkeqësive dhe menaxhimi i pellgutujëmbledhës, kategoritë e degradimit të pellgutujëmbledhës dhe fatkeqësitë e lidhura me ujin. Menaxhimi i pellgut ujëmbledhës; zhvillimi i një sistemi menaxhimi, aranzhimet e financimit, kërkesat institucionale/ligjore, përfshirja e publikut, burimet njerëzore dhe zhvillimi i politikave. Mbledhja e të dhënave, menaxhimi i pellgut ujëmbledhës, burimet e tokës dhe vlerësimi i rrezikut natyror. Opsionet për menaxhimin e pellgut ujëmbledhës dhe reduktimin e rrezikut.

Qëllimi i lëndës: Qëllimet e lëndës janë: Komponentët kryesorë të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës, domosdoshmëria e tyre, qasjet kryesore. Rëndësia e përdorimit të tokës dhe planifikimit në menaxhimin e pellgjeve ujëmbledhëse, zbutjen e rreziqeve dhe efekteve të fatkeqësive, zhvillimin e strategjive të menaxhimit, shfrytëzimin e burimeve dhe kontributin e publikut në proces. Përdorimi i mjeteve si modelet dhe sistemet e mbështetjes së vendimeve në studimet e menaxhimit të pellgut ujëmbledhës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: Intensifikojnë njohuritë mbi menaxhimin e pellgjeve ujëmbledhës (njohuri). Vlerësojnë dhe përdorin informacionin e mbledhur nga studimet dhe aplikimet e literaturës shkencore në lidhje me menaxhimin e pellgut ujëmbledhës (aftësi). Analizojnë, sintetizojnë dhe vlerësojnë informacionin rreth parimeve dhe zbatimeve të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës, planifikimit të tokës dhe menaxhimit të burimeve ujore (aftësi). Përgatisin një prezantim dhe raport në anglisht mbi menaxhimin e pellgut ujëmbledhës (Komunikimi dhe Kompetenca Sociale).

Mjetet e konkretizimit: tabela, kompjuteri, projektori, markeri/

Metodologjia e mësimdhënies: Lënda zhvillohet prej ligjëratave të ofruara në formë skripte.

Metodologjia e vlerësimit: Vlerësimi bëhet nga 0-100 %; Vlerësimi i parë: 35%; Vlerësimi i dytë 35%; Punimi: 30%; Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare; Provimi final: 70 %.

Literatura bazë dhe shtesë: Ahmedi, F. Shenime te ofruara ne gjuhen angleze

Literatura shtesë: Watershed Management; Practice, Policies and Coordination, Robert J. Reimold (edit.), McGrawHill, 1998, USA. Watersheds; Processes, Assessment and Management, Paul A. DeBarry, John Wiley & Sons, Inc., 2004, New Jersey.

Lënda: Ndërmarrësia

Mësimdhënës: Prof.ass. Dr, Mjellma Carabregu Vokshi

Statusi i lëndës: Zgjedhore, Vlera në kredi – ECTS: 3

Përshkrimi i lëndës: Lënda ofron një kuptim ekonomik të ndërmarrësve dhe rolin që ata luajnë në zhvillimin e ekonomik ekonomik të vendit. Për më tepër, lënda ofron njohuri në lidhje me zhvillimin e ndërmarrësisë, metodat për kërkimin e aplikuar te ndërmarrësisë, stimujt për t'u bërë një ndërmarrës dhe shqyrtimi i ndërmarrësisë së grupeve të veçanta.

Qëllimi i lëndës: Lënda përbëhet nga këto objektiva: Do të analizojmë se kush bëhet një ndërmarrës dhe pse, duke shqyrtuar teoritë e ndërmarrësisë, metodat për kërkimin e aplikuar te ndërmarrësisë, stimujt për t'u bërë një ndërmarrës dhe si dhe duke shqyrtuar ndërmarrësinë e grupeve të veçanta. Do të shqyrtojmë financimin e iniciativave ndërmarrëse, përmes formave të ndryshme të financimit. Ekzaminimi i inputeve ndërmarrëse dhe performanca - që përfshinë masat e performancës, akumulimin e pasurisë, krijimin e vendeve të punës, inovacionin, kthimin në kapitalin njerëzor dhe mbijetesën ndërmarrëse. Së fundi, do të shqyrtojmë si ndikojnë politikat publike nëndërmarrësi - duke shqyrtuar politikën publike, taksat, rregullimin e tregut dhe ndikimin e tyre tek ndërmarrësit

Rezultatet e pritura të nxënimit: Me përfundimin e suksesshëm të lëndës mësimore, studentët do të jenë në gjendje të: Demonstrjnë kuptim të tipareve dhe roleve ekonomike të ndërmarrësit; Demonstrjnë aftësi për të analizuar tregjet dhe sjelljet sipërmarrëse. Kuptojë format e financimit të ndërmarrjes dhe aranzhimeve të kapitalit. Demonstrjnë kuptim të politikave publike dhe kufizimeve për ndërmarrës. Analizojë dhe paraqes një analizë të politikës ndërmarrëse.

Metodologjia e mësimdhënies: Gjatë ligjëratave do të shpërndahen materiale të ndryshme studentëve, që do të përdoren për analizë dhe diskutim. Për më tepër, studentët do të punojnë nga një projekt në grupe.

Mjetet e konkretizimit: tabela, kompjuteri, projektori, markeri

Metodologjia e vlerësimit: Testi 1 – 30% Testi 2 – 30% ;Vijueshmëria – 10%; Detyrë individuale – 30% ;Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 51%.

Literatura bazë dhe shtesë: Simon C. Parker The Economics of Entrepreneurship, 2018; Entrepreneurship: The Practice and Mindset, 2nd edition, 2020, by Heidi M. Neck, Christopher P. Neck, Emma L.Murray; John Bessant, Joseph Tidd, (2015), Literatura shtesë: Social Entrepreneurship and Innovation: International Case Studies and Practice, Ken Banks, 2016.

Sa i përket ECTS-ve, për çdo 1 ECTS llogariten 25 orë studimi, sipas Statutit të UP-së. Një shembull i llogaritjes së ngarkesës së punës së studentëve që pasqyron caktimin e 3ECTS për një lëndë, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8. Shembull i përcaktimit të ngarkesës së studentëve

Aktiviteti	Orët	Ditë / Javë	Total
Ligjërata	2	15	30
Teori / Punë laborator / Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	6	2	12
Përgatitja për kolokium			
Konsultimet me mësimdhënësin	1	2	2
Puna në terren	2	1	2
Test, punim seminarik			
Detyra shtëpie	1	8	8
Vetë-studim (bibliotekë ose shtëpi)			
Përgatitja për provimin përfundimtar			
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar)			
Projekte, prezantime etj.	1	8	6
Total			75

Pas përfundimit me sukses të këtij programi, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Demonstrjnë njohuri të gjithanshme mbi vlerësimin, zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve ujore;
2. Identifikimi i aspekteve rregullatore të menaxhimit të ujit dhe direktivës kornizë të ujit;
3. Të njohë dhe të vlerësojë ndikimet sociale, politike, ekonomike dhe mjedisore në menaxhimin e burimeve ujore;
4. Të hulumtoj dhe zbatojë njohuritë për të siguruar përgjigje ndaj problemeve mbarë botërorë të mungesës së ujit, rreziqeve nga përmbytjet dhe menaxhimit të burimeve ujore;
5. Kombinimi i një game të gjerë të metodave shkencore dhe menaxhuese për çështjet e menaxhimit të burimeve ujore;
6. Të kuptojë ekonominë e përfshirë në menaxhimin e burimeve ujore,
7. Zbatimi dhe funksionimi i zgjidhjeve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, duke pasur parasysh kufizimet teknike, sociale, mjedisore dhe institucionale.

Standardi 4.4. Të gjitha lëndët në kuadër të kurrikulës MSc MIRU kanë planprograme analitike të cilat përfshijnë informacionet bazë të lëndës (siç janë titulli i kursit, niveli, statusi, kreditë ECTS etj.), përshkrimi i kursit dhe qëllimet e tij, rezultatet e të nxënit të lëndëve, si dhe shpërndarja e klasa gjatë javëve. Planprogramet përmbajnë gjithashtu ngarkesën e studentëve në orë, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, literaturën parësore dhe shtesë dhe sigurisht politikat akademike dhe kodin e sjelljes. Planprogramet e të gjitha lëndëve shfaqen në faqen e fakultetit dhe studenti mund t'i qaset ato përmes lidhjes: (<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1.67>) Planprogramet e programit MSc në MIRU i bashkëngjiten edhe në mënyrë elektronike raporti të vetëvlerësimit. Në të njëjtën kohë, materiali i kursit u ofrohet studentëve përmes SEMS, ose në formë fizike. Vitet e fundit (për shkak të pandemisë së fundit) materiali ishte ofruar edhe përmes platformës virtuale Google Classroom.

Standardi 4.5. Mësimdhënia në programin MSc MIRU do të ofrohet në gjuhën angleze. Aftësitë gjuhësore të studentëve dhe kriteret e tjera të pranimit (përfshirë numrin e studentëve që do të regjistrohen në programin MSc MIRU) do të specifikohen në Thirrjen për studentë, me vendim të Senatit të UP-së dhe me propozimin e njësisë akademike. Kjo përcaktohet me dispozitat e Statutit të UP-së (shih nenin 106 në Statutin e UP-së) [S1]. Trajnimi gjuhësor para fillimit të programit do të mundësohet nëse ka nevojë.

Standardi 4.6. Studentët dhe mësimdhënësit krijojnë një partneritet të fortë në të cilin të dyja palët punojnë drejt objektivit të arritjes, duke arritur rezultatet e të nxënit. Siç u përmend, rezultatet e të nxënit paraqiten në planprogramin e lëndës, dhe të njëjtat shpjegohen dhe diskutohen tërësisht me studentët. Si mësimdhënës, stafi akademik i FN-së bën çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që vlerësimet e tyre ndaj studentëve të pasqyrojnë meritat e vërteta të secilit student. Marrëdhënia mësimdhënës - student në UP rregullohet me dispozita të veçanta ligjore që ekzistojnë në Kodin e Etikës së Personelit Akademik, neni 7 dhe neni 8 [T4].

Standardi 4.7. Fakulteti i Ndërtimtarisë ofron disa programe studimi, të nivelit Baçelor dhe Master dhe për këtë arsye ka shumë rezultate të te arriturave. Në këtë drejtim, programi i studimit përdor strategjitë e mësimdhënies që janë të përshtatshme për rezultatet specifike të të nxënit. Në kurrikulën e programit MIRU, të gjitha lëndët kanë planprograme analitike në të cilat specifikohen metodat e mësimdhënies për të fituar rezultatet e të nxënit. Në rastet e grupeve të ndryshme të studentëve, specifikimet e lëndës, metodat e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit janë fleksibile për atë grup studentësh. Kjo është si rezultat i përvojës së mësimdhënies dhe specifikohet edhe në dispozitat statusore si dhe në Kodin e Etikës së Personelit Akademik, neni 8-pika 4, ku thuhet se “përgjegjësia e mësimdhënies dështon nëse ka diskriminim ndaj grupeve të ndryshme të studentëve” [T4].

Departamenti i Hidroteknikës ka pasur mbështetjen e TH Köln përmes përgatitjes për procesin e akreditimit, duke dhënë komente për kurrikulën e hartuar, komente për planprogramet e hartuara, të dhëna në Raportin e Vetëvlerësimit dhe pjesëmarrje në intervistë gjatë procesit të akreditimit.

Gjithashtu TH Köln mbështet programin MSc në MIRU në leksione, që në ofrimin e leksioneve, mbështetje nga kolegët për lektorët vendas sipas nevojës, duke përfshirë shkëmbimin e materialeve mësimore dhe pedagogjinë [shih Draft-Marrëveshjen e bashkangjitur, T15].

Standardi 4.8. Statuti i UP-së, nenet 108 dhe 109 [S1] dhe Rregullorja për studimet në nivelin Master [R5] përcaktojnë politikat dhe procedurat për vlerësimin e punës akademike të studentit. Për vlerësimin e studentëve, fakulteti është përgjegjës për organizimin e provimeve. Metodat e vlerësimit të studentëve janë të specifikuar në planprogramin e çdo lënde dhe janë në përputhje me metodat për përcaktimin e suksesit akademik të përcaktuara në Statutin e UP-së. Këto metoda u komunikohen studentëve qartësisht nga profesorët, në fillim të çdo lënde. Metodat e vlerësimit që mund të aplikohen janë: Provimi, kolokiumi, punimi seminarik, praktika profesionale dhe/ose testi praktik gjatë ushtrimeve (Statuti i UP-së, nenet 108, 109, 110, 111 [S1]).

Standardi 4.9. Për verifikimin e standardit të arritjeve të studentëve në një lëndë, mekanizmat e përdorur janë të vlefshëm, të besueshëm dhe të qëndrueshëm në kohë. Ato standarde janë ekuivalente me të gjitha njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës, si dhe në lëndët e ofruara në programin MSc MIRU, siç është specifikuar në Statutin e UP-së, neni 109 [S1]). Vlerësimi i studentëve përcaktohet me nota nga 5 deri në 10. Nota 10 dhe 9 është sukses i shkëlqyer, 8 është shumë mirë, 7 është mirë, 6 është e mjaftueshme dhe 5 është e pamjaftueshme. Të gjitha pikët dorëzohen në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve (SEMS), brenda një periudhe kohore të përcaktuar.

Standardi 4.10. Në rast se studenti nuk e kalon provimin pas vlerësimit të parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet të njëjtit provim në afatin vijuese. Kjo mund të bëhet tri herë për të njëjtën lëndë. Në rast

të përsëritjes së dështimit të studentit apo pakënaqësisë së studentit me notën, atëherë studenti mund të veprojë sipas procedurave të përcaktuara në Statutin e UP-së, nenin 114 dhe nenin 115 [S1]. Në rast se rezultatet e vlerësimit të studentëve janë vazhdimisht të pakënaqshme, atëherë mësimdhënësi është përgjegjës për komunikimin student-mësimdhënës për të arritur rezultatet më të mira të të nxënit. Ky komunikim realizohet nëpërmjet konsultimeve, me kërkesë të mësimdhënësit apo të vetë studentit, për të eliminuar mangësitë dhe për të arritur rezultatet më të mira të të nxënit.

Standardi 4.11. Në kurrikulat e programit MSc në MIRU, siç u përmend, parashikohet edhe puna praktike për semestrin e katërt, vitin e dytë të studimeve. Praktika ka 10 ECTS të alokuara dhe është e detyrueshme. Praktika organizohet nga mbajtësi i kursit, i cili është mësimdhënës në FN dhe studentët e ndjekin këtë kurs në kompani, organizata dhe institucione profesionale, relevante me menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Gjatë kësaj periudhe praktike, studenti udhëhiqet dhe mentorohet nga mbikëqyrësi në kompani, organizatë ose institucion. Gjatë kësaj kohe studenti duhet të përgatisë raportin e aktivitetit të cilin pas përfundimit të praktikës studenti duhet t'ia paraqesë dhe interpretojë mbajtësit të kursit (profesor në FN). Kjo punë praktike mund të çojë në hulumtime të mëtejshme për punim të diplomës.

Standardi 4.12. Për të lehtësuar këtë Praktikë, Fakulteti i Ndërtimtarisë nënshkruan bashkëpunim me institucionet (organizatat) lokale [T3] (disa prej tyre të renditura në standardin 4.3.). Praktika do të kryhet me ndihmën e organit këshillues [T5] në kuadër të FN-së, por edhe me ftesën e dërguar me email kompanive, organizatave dhe institucioneve. Kjo praktikë ofron përfitim të ndërsjellë për akademikët dhe profesionistët e ujit. Ai do t'i ndihmojë studentët të jenë pjesë e një ekipi ekspertësh të burimeve ujore dhe do të çojë në mundësitë e bashkëpunimit dhe punësimit në të ardhmen.

Treguesi i përformancës 4.1

Fakulteti i Ndërtimtarisë përmes komisionit të studimeve bënë rishikimin e programeve studimore së paku njëherë në vit. Gjithashtu, bazohet dhe në gjetjet e realizuara nga zyra e cilësisë përmes pyetësorëve më të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë. Këto vlerësime pastaj ndihmojnë në gjenerimin e raporteve të cilat tregojnë për arritjet apo të metat e secilës lënde. Raportet u dorëzohen bartësve të programit të cilët mund të planifikojnë strategji për të tejkaluar mangësitë eventuale. Në këto raporte të zyrës së cilësisë vazhdimisht vlerësohen dhe rivlerësohen kurrikulat dhe nxjerrën rekomandimet e nevojshme për rritjen e cilësisë së programit dhe përformancës.

Treguesi i përformancës 4.4

Fakulteti i Ndërtimtarisë vazhdimisht bënë përditësimin e programeve dhe syllabuseve duke përfshirë literaturën e re si dhe hulumtimet dhe punimet shkencore të mësimdhënësve që i përshtaten subjektit të lëndës, shih syllabuset e lëndëve.

Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:

A. Përparësitë

- Një qasje më gjithëpërfshirëse dhe shumë pjesëmarrëse,
- Paraqitja e një shembulli më praktik për të kuptuar pjesën teorike – fokus në qasjen e rastit studimor,
- Kombinimi i grupit të lëndëve si: lëndë për inxhinieri të ujit, lëndë për menaxhim.
- Përgatitja e drejtuesve të rinj që janë të aftë të përdorin aftësi specifike gjithëpërfshirëse, mjete praktike, njohuri teknike dhe politika për të zgjidhur çështje komplekse të lidhura me ujin,
- Zgjerimi dhe rritja e njohurive mbi sfidat aktuale të ujit
- Përmirësimi i komunikimit ndërmjet grupeve të ndryshme të palëve të interesuara për çështjet që lidhen me ujin,
- Program studimi me fleksibilitet dhe lehtësiht i adaptueshëm ndaj kërkesave të tregut lokal, rajonal dhe global.

B. Dobësitë:

- Nuk vërehen dobësi sa i përket përmbajtjes së procesit mësimor.

C. Mundësitë:

- Mundësia për të krijuar një komunitet ekspertësh të ujit që kanë njohuri të plota për të aplikuar MIRU dhe për të forcuar kapacitetin e sfidave të ndërlydhura në sektorin e ujit,
- Të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve që kuptojnë sfidat e shumanshme në menaxhimin e burimeve ujore,
- Rritja e aftësive teknike dhe shkencore që lidh njohuritë teorike dhe praktike për sektorin e ujit
- Zhvilloni kapacitete efektive drejtuese si dhe aftësi strategjike, menaxheriale dhe teknike
- Fleksibilitet për të inkorporuar ide dhe koncepte të reja në kurrikulat që dalin nga bashkëpunimi ndërkombëtar.
- Mbështetja e kualifikimeve përkatëse të nevojshme për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkufitar ujqor,
- Mundësi të shkëlqyera karriere në bashkëpunim dhe zhvillim rajonal dhe ndërkombëtar,
- Bëhuni pjesë e një rrjeti ekselence në MIRU
- Pozicione udhëheqëse në sektorin publik dhe privat në rajon dhe më gjerë,
- Lëvizshmëria e stafit akademik dhe studentëve në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e inxhinierisë së ambientit.

D. Kërcënimet:

- Vonesë të mundshme në mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik për shkak të Covid-19 dhe mungesës së liberalizimit të vizave.

2.5 Studentët

Standardi 5.1. Pranimi i studentit në programin Master për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (MIRU) kryhet nëpërmjet provimit, pas shpalljes publike. Shpallja publike shpallet nga Universiteti i Prishtinës në koordinim me secilën njësi akademike dhe specifikon kriteret e nevojshme të pranimit. Senati i Universitetit në përputhje me dispozitat e Statutit të UP-së [S1] është përgjegjës për përcaktimin e numrit të kandidatëve që do të pranohen në vitin e parë, duke marrë parasysh numrin e propozuar nga Këshilli i Fakultetit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për programin MIRU MSc. Kriteret e pranimit zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë për të gjithë aplikantët.

Standardi 5.2. Programi MSc MIRU i dedikohet të gjithë kandidatëve që kanë diplomë Baçelor ose ndonjë diplomë të ngjashme nga universitete të tjera dhe kanë të paktën 180 kredite ECTS ekuivalente.

Standardi 5.3. Numri total i studentëve parashihet që të jetë 20 student të regjistruar për çdo vit akademik. Ky numër, mund të ndryshojë varësisht prej kërkesave të punëdhënësve dhe interesimit të studenteve në vitet e ardhshme. Ky numër i studenteve që do të regjistrohen në programin e Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore do të sigurojë një proces efektiv dhe ndërveprues të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe rritje të rezultateve të të nxënit. Sipas rregullores e cila ndër të tjera rregullon çështjen e krijimit të grupeve për studentët [R12], grupi i studentëve dallon sipas njësive akademike. Për Fakultetin e Ndërtimtarisë, grupi i studentëve për ligjërata është së paku 5 dhe maksimumi 50; Për ushtrimet teorike minimumi 5 dhe maksimumi 20 studentë dhe për ushtrimet laboratorike minimumi i grupit të studentëve është 5 dhe maksimumi 15 studentë. Ky numër studentësh në grup është i vlefshëm për lëndët e detyrueshme. Numri i grupit ndryshon për lëndët me zgjedhje. Ndërsa, për numrin e studentëve të regjistruar që është më i vogël se minimumi i mësipërm, numri i studentëve të regjistruar përcakton madhësinë e grupit (shih nenin 25, pika 3 të kësaj rregulloreje). Kjo përjashton rastin kur ligjërata zhvillohet në gjuhë të huaj, me ç'rast ligjëratat mund të fillojnë me një grup prej vetëm 7 studentësh (neni 26, R12)

Standardi 5.4. Vlerësimi i performancës së studentëve kryhet sipas politikave të përcaktuara nga FN dhe UPHP në përgjithësi. Një proces shumë efektiv për shpalljen e rezultateve të vlerësimit të performancës së studentëve mundësohet përmes sistemit të unifikuar të platformës elektronike SEMS, ku mësimdhënësit shpallin rezultatet të paktën dy javë pas provimit/vlerësimit. Në rast të performancës së dobët ose të pakënaqësisë së studentit me vlerësimin, atëherë studentët mund të refuzojnë notën dhe të ri nënshtrohen në provim. Në të dyja rastet, studentët mbështeten përmes mentorimit nga personi përgjegjës/professori. Studentet e regjistruar në programin Master në MIRU, do të kenë profesorin/mentorin e tyre përgjegjës për mirëqenien e studenteve dhe të arriturat e tyre akademike. Ky profesor/mentor do të emërohet në fillim të studimeve të nivelit Master, dhe ajo/ai do t'i udhëheqë studentet përgjatë studimeve të tyre të Masterit. Roli i këtij profesori/mentor është jo vetëm të ndihmojë studentet të arrijnë rezultatet e duhura në mësimnxënie, por edhe t'iu ndihmojë me çështje sociale, emocionale etj. kur studentet kane nevojë.

Standardi 5.5. Rezultatet e studentëve për secilën lëndë në veçanti ruhen nga profesori përgjegjës përmes SEMS, të printuara si formular aplikimi fizik, të nënshkruara nga profesori dhe të arkivuara në administratën e FN. Rezultatet e vlerësimit të studentëve arkivohen për qëllime të shërbimit ndaj studentëve, administrimit dhe menaxhimit. Është sistemi SEMS [R6] që konfirmon që studenti ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga programi i studimit. Kjo bëhet nga personeli administrativ, i cili mban evidencën e provimeve të mbartura në semestrin dhe vitin akademik dhe regjistron ecurinë e studentit të bërë nga viti në vit deri në diplomim. Në përfundim të studimeve, studenti punon në temën e diplomës që vërteton arritjet mësimore dhe zbatimin e informacionit të marrë gjatë studimeve në lidhje me fushat e menaxhimit të integruar të resurseve ujore. Studentët, pas përfundimit të të gjitha provimeve

dhe mbrojtjes së tezës së diplomës në programin Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore, do të pajisen me Diplomë Universitare me titullin "Master i Shkencave - Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore".

Standardi 5.6. Politikë e UP-së është promovimi i mundësive të barabarta për të gjithë studentët dhe sigurisht kjo politikë do të zbatohet edhe për studentët e këtij programi duke përdorur të gjithë mekanizmat që mundësojnë një trajtim fleksibël të studentëve në situata të veçanta. Sa i përket provimeve, FN shpall tre afate të rregullta të provimeve publike në përputhje me nenin 111 të Statutit të UP-së, përkatësisht: dimër (janar), pranverë (qershor) dhe vjeshtë (shtator). Gjithashtu, për studentët e UP-së, përkatësisht FN, organizohen afate shtesë të provimeve në shërbim të studentëve të rregullt dhe të diplomuar. Kjo me qëllim që nxënësit të mund të arrijnë rezultatet e pritura në kohën e duhur. Oraret për çdo afat të provimit shpallen nga drejtuesit e FN-së, fizikisht në ambientet e shpalljeve publike si dhe në faqen elektronike të FN-së (<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,21>). Mësimdhënësi dhe studentët duhet t'i përmbahen orarit të shpallur të provimeve. Studimet në MSc zgjasin dy vite, brenda të cilave studenti duhet të diplomohet. Megjithatë, fleksibiliteti i politikave të përcaktuara në nivelin e UP-së i lejon studentit të zgjasë kohëzgjatjen e periudhës së diplomimit. Gjegjësisht, është një vendim i Senatit të UP-së për vazhdimin e periudhës së diplomimit për studentët baçelor, master dhe doktoraturë.

Standardi 5.7. Rezultatet e vlerësimeve të studentit bëhen publike për studentin, të ruajtura nga profesori në SEMS. Nëpërmjet SEMS [R6], gjenerohet një raport statistikor, i cili pasqyron kalueshmërinë e studentëve. Nga ky raport statistikor mësimdhënësit reflektojnë mbi arritjen e objektivave gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies. Të dhënat statistikore për tregues të tillë si ritmet e progresit dhe përfundimit mbahen në SEMS dhe raportohen rregullisht në raportet periodike të programit. Monitorimi i ligjëratave tani bëhet përmes sistemit elektronik ku janë të regjistruara të gjitha ligjëratat dhe prania e studentëve dhe është e rregulluar me Rregulloren e punës së sistemit elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) në UP (R6).

Standardi 5.8. Puna kërkimore e studentëve do të mbikëqyret dhe asistohet nga profesorët, me theks të veçantë në autenticitetin e punës kërkimore (ese, punim diplome, etj.). Në universitet/fakultet profesorët dhe studentët kanë qasje në softuerin kundër plagjiaturës, i cili është kontrolli i plagjiaturës. Gjithashtu, rregullorja e UHP-së parasheh dënime për veprat e plagjiaturës nga studentët dhe në rastet kur punimi seminarik i studentit nuk është origjinal atëherë ai punim anulohet. Megjithatë, në rastet kur teza e magjistraturës është plagjiaturë, atëherë titulli shkencor mund të revokohet. Këto sanksione janë të përcaktuara në Statutin e UHP (S1), për procedurat dhe përgjegjësitë disiplinore për studentët e UP-së ekziston një rregullore e veçantë [R8] e nxjerrë nga UHP dhe Kodi i Etikës (T4). UHP është në proces të zhvillimit të një kodi të posaçëm të etikës për kërkimin shkencor, përmes projektit Research Cult.

Standardi 5.9. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë të përcaktuara në Statutin e UP-së (S1), Rregulloren për Studime Master (R5), Rregulloren për procedurën dhe masat disiplinore për studentët e UHP-së (R8), Rregulloren për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e parlamentit studentor (PS) dhe këshillave studentore (KS) të UHP (R10), Kodit të Etikës (T4), Rregullorja për mobilitetin akademik të studentëve (R7). Të gjitha këto rregulla janë publikuar në faqen zyrtare të UHP-së (www.uni-pr.edu). Për promovimin e këtyre të drejtave, administrata e UP-së ka shpërndarë broshura me përmbledhje të të drejtave të tyre për ankesa akademike: ankesat kundër vlerësimeve të mësimdhënësve, ankesat e vendimeve të komisionit studimor, komisionit disiplinor, dekanit, këshillit, Senatit etj. Për avancimin e këtyre të drejtave kujdesen edhe përfaqësues e studentëve. Gjithashtu, në shërbim të studentëve dhe të diplomuarve nga UP, por jo vetëm, është edhe Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) e cila synon të ofrojë mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësimit me punëdhënësin, ofrimit të këshillave akademike dhe aktivitete të tjera. Informacioni mbi aktivitetet, pjesë e të cilave mund të jenë studentët dhe të

diplomuarit, dërgohen me e-mail në QZHK [T8]. FN ka edhe faqen e e-Karrierës [T9] brenda kësaj qendre, përmes së cilës studentët mund të informohen për informacionet më të fundit rreth trajnimeve, praktikave, panairëve, këshillave dhe aktiviteteve të tjera.

Standardi 5.10. Sa i përket transferimit të studentëve, rregullohet me nenin 142 (Ndryshimi i drejtimit të studimeve) të Statutit të UHP-së [S1]. Ky Statut rregullon edhe procedurat për njohjen dhe transferimin e kredive ECTS nga institucionet tjera dhe brenda njësisve tjera akademike të UHP-së. Gjithashtu, për njohjen dhe transferimin përdoren dokumentet përkatëse (marrëveshja e shkollimit, certifikata e notave, shtesa e diplomës).

Në kuadër të programeve të bashkëpunimit shkencor dhe arsimor të Universitetit të Prishtinës me Universitetet e tjera Ndërkombëtare, Fakulteti i Ndërtimtarisë me të gjitha programet e studimit ofron bursa në çdo fushë me interes për nivelet studimore: baçelor, master apo doktoraturë. Studentëve të interesuar u janë ofruar bursa mobiliteti në Universitete Ndërkombëtare, në departamente që lidhen me fushat e Inxhinierisë së Mjedisit, si:

- Universiteti Teknik i Lindjes së Mesme, Turqi - Fakulteti i Inxhinierisë (2017, 2018).
- Universiteti i Teknologjisë Silesian - SUT, Gliwice, Poloni (2018), dhe të tjera të ofruara.
- Universiteti i Trentos, në Itali, në fushën e Inxhinierisë së Mjedisit përmes Erasmus + (Mobiliteti për studentët dhe stafin, mobilitetin e studentëve dhe stafit të arsimit të lartë)
- Në Universitetin e Gent, Belgjikë, Universitetin për Kimi dhe Teknologji në Pragë, Republikën Çeke dhe Institutin IHE Delft për edukimin në ujë në Delft, Holandë si Master Ndërkombëtar i Shkencave në Inxhinieri dhe Teknologji Mjedisore.
- Universiteti i Shkencave të Jetës në Poznan, Poloni, Fakulteti i Mjedisit dhe Inxhinierisë dhe Mbrojtjes.

Standardi 5.11. Stafit akademik është në dispozicion në kohë të mjaftueshme për këshillimin e studentëve. Çdo profesor i përfshirë në program ka një orar fiks katër (4) orësh konsultimesh javore. Këto konsultime do të sigurojnë mirëkuptim me studentët dhe aftësinë e tyre për të zbatuar mësimin. Ky orar konsultimi ndonjëherë tejkalohet në rast të mentorimit të temave të diplomës, kërkimit ose nevojës së studentit/profesorit për të arritur një rezultat të kënaqshëm vlerësimi. Në kohë pandemie (COVID-19), konsultimet ofrohen edhe virtualisht, përmes platformës GoogleMeet. Udhëzimet për zhvillimin e aktiviteteve akademike gjatë pandemisë janë përcaktuar në një vendim të nxjerrë nga Universiteti i Prishtinës [V1].

Për informacion mbi arritjet shkencore, studentët kanë qasje në bibliotekën digjitale Science Direct të shtëpisë së njohur botuese - Elsevier (shih Faqen ScienceDirect, Uebsajti i UP:(<https://www.uni-pr.edu/>). Nga dhjetori 2018, studentët kanë mundësinë të gjejnë materiale elektronike në Bibliotekën Qendrore Kombëtare përmes platformës LibApps të krijuar nga Universiteti i Prishtinës në kuadër të projektit Erasmus +, “Shërbimet e Mbështetjes së Rrjetit të Bibliotekave”. Më konkretisht, këto materiale mund të gjenden përmes linkut [Home - Biblioteka Qendrore Universitare - Platforma LNSS në LNSS Western Balkans \(libguides.com\)](#).

Profesorët përmes sistemit menaxhues-verifikues ofrojnë këshilla studentore për programin e studimit, duke i këshilluar studentët në rast të problemeve emocionale, financiare apo familjare.

(Treguesi i performancës 5.3)

Vlerësimi i studentëve në kolokiume dhe në provimin final bëhet kompakt syllabusëve të lëndëve. Fakulteti në fund të çdo afati të provimeve bënë raport përmes zyrës së cilësisë për kalueshmërinë dhe ngeçjet e studenteve në lëndë të ndryshme ku përmes këtyre krijohen grupet e studentëve për të ndihmuar studentët që kanë nevojë, gjithashtu përdoret progresi i studentit për çdo lëndë duke përfshirë (përqindjen e fituar në testin e parë dhe të dytë, përqindjen e fituar në ushtrime, punime seminarike,

hulumtime, detyra shtëpie, dhe përqindjen e provimit final. FN në bashkëpunim me Universitetin në mënyrë të vazhdueshme merr masa për trajnim të stafit në metoda më të avancuara dhe cilësore, si dhe përmes ideve që sjellin profesorët që kanë bashkëpunime me universitete ndërkombëtare.

Tabela 9 Numri i studentëve dhe të diplomuarve gjatë tre viteve të fundit në Fakultetin e Ndërtimtarisë

	Viti	BACHELOR		MASTER	
		Studentet	Të diplomuar	Studentet	Të diplomuar
KONSTRUKTIV	2019	109	72	24	14
	2020	77	59	31	20
	2021	97	66	39	15
	Viti	BACHELOR		MASTER	
		Studentet	Të diplomuar	Studentet	Të diplomuar
HIDROTEKNIKË	2019	26	42	14	3
	2020	16	14	7	8
	2021	17	31	20	9
	Viti	BACHELOR		MASTER	
		Studentet	Të diplomuar	Studentet	Të diplomuar
GJEODEZI	2019	38	63	19	1
	2020	51	34	20	2
	2021	38	20	19	5
	Viti			MASTER	
				Studentet	Të diplomuar
INFRASTRUKTURA RRUGORE	2019	0		0	2
	2020	0		0	5
	2021	0		0	1
	Viti	BACHELOR			
		Studentet	Të diplomuar		
INXHINIERIA E AMBIENTIT	2019	7	7		
	2020	25	11		
	2021	16	20		

Tabela 10. Numri i studentëve që kanë braktisur studimet për tre vitet e fundit

Niveli i studimeve	2017/18	2018/19	2019/20	2020/21
Niveli Bsc	23	15	19	7
Niveli Master	4	2	0	0
Niveli PhD				

Analiza SWOT për Studentët:

A. Përparësitë:

- Procedurat transparente dhe të publikuara për pranimin e studentëve të rinj.
- Një numër i konsiderueshëm studentësh në nivelin baçelor, potencial për të vazhduar në nivelin master.
- Grupe të vogla në leksione dhe ushtrime/praktika që sigurojnë efikasitet më të lartë.
- Përfshirja e studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në UPHP.
- Mbështetje administrative gjatë studimeve.

B. Dobësitë:

- Mungesa e këshillimit profesional për studentët me probleme emocionale (psikolog).
- Mungesa e mjekut brenda kampusit universitar,
- Mungesa e bursave për studime master.

C. Mundësitë:

- Programet e lëvizshmërisë ERASMUS për studentët.
- Pjesëmarrje aktive në ligjërata dhe pjesë praktike në trajnime të organizuara nga institucionet mbështetëse arsimore.
- Zhvillimi i njohurive dhe aftësive për kërkime të pavarura.

D. Kërcënimet:

- Mbështetje e pamjaftueshme për shkencën dhe kërkimin në vend.
- Lëvizshmëria e studentëve në universitete të tjera për shkak të procedurave të zgjatura të vizave,

2.6 Hulumtimi

Standardi 6.1. Universiteti i Prishtinës, në kuadër të Planit Strategjik [S2] ka të iniciuar edhe nxitjen për hulumtime kërkimore shkencore/artistike. Në fakt, Universiteti i Prishtinës së fundi ka aprovuar Rregulloren për përkrahje financiare për hulumtime. Kjo rregullore parasheh që të paktën 1% e buxhetit vjetor të UP-së t'i dedikohet drejtpërdrejtë avancimit të komponentit kërkimor e shkencor në UP (Tabela në vijim, pika 1). Megjithatë, FN-ja ka avancuar me hulumtime shkencore të përkrahura përmes granteve-programeve dhe projekteve ndërkombëtare. Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN) ka arritur që përmes projektit shkencor “InWaterSense” (Intelligent Wireless Sensor Networks for Monitoring Surface Water Quality), të financuar nga Unioni Evropian (EU) (shih Uebfaqin: <https://inwatersense.uni-pr.edu/>) të realizojë bashkëpunim midis hulumtuesve në Kosovë nga fusha të ndryshme, si: Hidroteknika, Inxhinieria Kompjuterike, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe nga Universitetet partnere të EU-së, të përfshira në projekt, si: Universiteti Teknik i Vjenës, Instituti Tyndall dhe Universiteti Linnaeus. Projekti “InWaterSense” ka ofruar mundësi publikimi të punimeve shkencore të përbashkëta midis partnerëve të përfshirë në projekt.

FN është pjesë e një tjetër projekti të quajtur “GEOBIZ” i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të ERASMUS+ KA2 - Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë; me qëllim që të vazhdojë ngritja e cilësisë së kurrikulave përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe biznesit publik dhe privat.

Takimi "GEOBIZ Progres Takimi në Prishtinë" u mbajt në Fakultetin e Ndërtimtarisë UP më 11-12 Nëntor 2021, me një audiencë shumë profesionale prej 15 Universitetesh Ndërkombëtare, me staf akademik nga IAL i BE-së, Ballkani Perëndimor, Moldavia etj. .

Në këtë takim, në projektin GEOBIZ, u prezantuan dhe u diskutuan kërkesat e se ardhmes, të zhvillimeve teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës siç janë radhitur më poshtë: modernizimi dhe zhvillimi i një kurrikule të re për gjeoinformatikë/gjeodezi, i bazuar në modelet e BE-së; koordinimi me zhvillimin teknologjik për Arsimimin akademik për institucionet dhe bizneset; adresimi dhe zbatimi i praktikave të mira në gjeoinformatikë/gjeoinformacion me partnerët e biznesit privat dhe publik; mësimdhënie dhe mësim nxënie aktive me ligjërata interaktive, ushtrime laboratorike, dhe punime terreni me student; vlerësimi i metodave të përziera për zbatim efektive e të mësuarit për t'i përgatitur studentët tanë-ekspertet e ardhshëm si kontribuues të shkëlqyer-në fushat e gjeomatikës/gjeoinformacionit/gjeodezisë; me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit Akademi – Biznes me sektorin privat dhe publik janë nënshkruar 6 Memorandume të Mirëkuptimit (MiM) ndërmjet të Bizneseve dhe UP, si dhe 4 MiM ndërmjet UBT dhe bizneseve.

Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet UP-FN dhe të UBT me Biznesin ishin me profilet: 6 Kompani gjeodezike, 1 Arkitekturë, 1 Ndërtimtari, 1 Konsulencë dhe GIS, 3 Agjenci Publike-Qeveritare.

Projekti “Përmirësimi i Kulturës Kërkimore në Arsimin e Lartë në Kosovë (ResearchCult)” është një projekt Erasmus + i financuar nga Komisioni Evropian, dhe është i Koordinuar nga IBC-M. Projekti filloi në nëntor 2019 dhe përfundon në nëntor 2022. <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,97>

Për programin MSc në “Menaxhimi i integruar i burimeve ujore” – MIRU, si program i ofruar për të gjithë studentët e interesuar për studime të lidhura me ujin, UP tashmë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zbatim me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), përmes Programi i Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore-Kosovë, i cili është edhe financues i programit Programi MIRU ka caktuar buxhetin prej 150'000 euro për zbatimin e programit MSC në MIRU. Ky buxhet i dedikohet përmirësimit të infrastrukturës për mësimin dhe përmirësimin e mësimin elektronik. Për më tepër, programi MIRU ka nënshkruar një marrëveshje tjetër me TH Köln, me një 49'300 euro të dedikuar për mbështetjen e MSc në MIRU përmes procesit të akreditimit, ligjërimit dhe praktikës dhe

tezës së diplomës (shih shtojcën). Programi synon të krijojë kapacitete njerëzore që do të shërbejnë si profesionistë në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore në nivel kombëtar. Gjithashtu, investimi nga SDC do të ofrohet për laboratorët e Hidroteknikës dhe inxhinierisë së ambientit, për pajisje dhe për mbështetje të kërkimit shkencor.

Standardi 6.2. Mësimdhënësit e përfshirë në programin e studimit MSc në MIRU janë të përzgjedhur përmes politikave të hartuara nga Universiteti i Prishtinës. Kjo do të thotë se, mësimdhënësit e përfshirë, përpos kritereve të tjera të kërkuara, plotësojnë edhe kriterin e aktivitetit hulumtues, shkencor dhe profesional i cili është në pajtueshmëri me dispozitat mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, që janë të përcaktuara në Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës [R2].

Standardi 6.3. Sigurisht se politikat e definuara për avancime të mësimdhënësve bazohen në hulumtime me recension ndërkombëtar dhe të indeksuara në databazat si: Science Citation Index Expanded, Social Sciences Citation Index dhe Arts & Humanities Citation Index, përmes platformave Web of science dhe Scopus (Elsevier). Hulumtimet dallojnë nga fusha në fushë, dhe si të tilla ato shfrytëzojnë ose të dhëna të fituara në laboratorë përkatëse (të FN-ës apo të vet modeluara si modele fizike), ose të dhëna të kërkuara nga institucionet përkatëse.

Standardi 6.4. Stafit akademik zgjeron interesin e kërkimit në atë të studimit. Për shembull, mësimdhënësi fusha e interesit të të cilit është trajtimi i ujit, konservim i burimeve ujore, ka kryer kërkime me fokus në të njëjtat fusha.

Standardi 6.5. Stafit akademik i FN-ës hulumtimet i publikon në: revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare të cilat plotësojnë kushtet si në paragrafë të definuar në Rregulloren për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik të UP-ës; në kapituj të librave vendor dhe ndërkombëtar; në kongrese, konferenca, simpoziume, seminare dhe workshope në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Standardi 6.6. Stafit dhe studentët e MIRU do të kryejnë kërkime që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin praktik ose që lidhen ngushtë me nevojat e tregut dhe interesin social. Kërkimet në lidhje me të dhënat lokale (ekzistuese ose aktuale) do të monitorohen në laboratorët e FN-së, veçanërisht në laboratorin e ri që po ndërtohet posaçërisht për programin MIRU, ose në laboratorët e institucioneve me të cilat FN-ja ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë rast, ato të dhëna vlerësohen për siguri dhe kontrole të rezultateve nëse kanë pasur gabime gjatë analizave.. Kjo vërtetësi arrihet edhe nga përvoja e mësimdhënësve në punën e zhvilluar profesionale praktike. Kur hulumtimet kanë të bëjnë me krahasueshmëri apo rishikim (review) të literaturës në lidhje me një problematikë të veçantë, atëherë ato vërtetohen përmes botimeve kërkimore shkencore dhe aplikative.

Standardi 6.7. Stafit akademik në FN, me qëllim të ngritjes së cilësisë akademike, ka si detyrim që të publikojë numër të caktuar të punimeve hulumtuese, dhe atë së paku 1 punim në vit, për tri vite. Përpjekjet vazhdojnë për më shumë publikime cilësore. Duhet theksuar se kriza e njohur pandemike, si kudo, ka ndikuar edhe në kërkimin e stafit akademik në FN.

Standardi 6.8. Emri i Universitetit të Prishtinës, gjegjësisht i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Departamenti në veçanti, specifikohen në hulumtimet e publikuara të stafit akademik të FN-ës. Edhe e drejta për mbështetje financiare nga UP-ja (Rregullore për financimin e veprimtarisë kërkimore shkencore, artistike dhe sportive në UP) i takon artikujve që bartin adresën e Universitetit të Prishtinës (fletëpalosjeve - broshurave).

Standardi 6.9. Me qëllim të ngritjes së performancës në mësimnxënie, mësimdhënësi në vazhdimësi integron jo vetëm përvojën praktike profesionale në ligjërata, por në kuadër të njësisë apo fushës së lëndës që ligjërohet i informon studentët për informata të punimeve-hulumtimeve (si raste studimore) të zhvilluara e të publikuara në revista apo konferenca. Hulumtimet e mësimdhënësve, i mundësojnë

programit në veçanti dhe fakultetit në përgjithësi sjelljen e po asaj eksperience hulumtimi në klasë si burim i problemeve të botës reale dhe çështjeve të kohës (bashkëkohore).

Standardi 6.10. Është Senati i UP-ës të cilit i takojnë përgjegjësitë në lidhje me zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të UP-ës dhe shfrytëzimin komercial të saj. Dhe sipas të drejtave dhe përgjegjësiave të personelit (dispozitë e Statutit të UP-ës): “personeli akademik ka lirinë për të publikuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe krijuese, që kushtëzohet me rregulloret e këtij Statuti që ka të bëjë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale për dobi të Universitetit” [S1]. Nëse e drejta e autorit dhe e etikës në publikime shkencore shkelet, apo keqpërdoren fondet e besuara publike për përfitime personale ose në interes të personave të tjerë, atëherë këto çështje janë të rregulluara me Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP-ës [R8].

Standardi 6.11. Programi MSc në MIRU përfundon me punimin e tezës së diplomës e cila është punë individuale kërkimore. Punimi I diplomës mund të organizohet edhe nga një grup studentësh për kërkime në një fushë specifike. Një pjesë e hulumtimit është planifikuar të kryhet në bashkëpunim me kompaninë përkatëse me subjektin e temës. Kontakti bashkëpunues ndërmjet studentit dhe kompanisë arrihet me ndihmën e trupit këshillues në kuadër të FN-së por edhe përmes bashkëpunimeve të arritura në kuadër të punës praktike.

Treguesi i performancës 6.4

Hulumtimi shkencor është politikë e universitetit në mënyrë që të promovohet dhe përkrahet sa më shumë puna kërkimore-shkencore e stafit akademik. Një pasqyrë me e saktë e të gjitha hulumtimeve është bashkangjitur në fund të këtij raporti.

Analiza SWOT për hulumtim:

A. Përparsitë:

- Progresi i punimeve të publikuara të publikuara në revista të indeksuara në databaza të platformave të besueshme.
- Bashkëpunimi i FN-ës me institucione vendore dhe ndërkombëtare.
- Qasja në revista shkencore përmes librarisë digjitale Science Direct të ofruara nga UP-ja.
- Mundësia e shfrytëzimit të laboratorëve për hulumtime shkencore.
- Njohuritë e mira të gjuhëve të huaja nga stafi akademik dhe studentët është përparësi për bashkëpunim ndërkombëtar.

B. Dobësitë:

- Përvoja jo e mjaftueshme e bashkëpunimit ndërkombëtarë.
- Nxitja për publikime nga politikat e UP-ës, dhe buxhet i pamjaftueshëm nga UP-ja për hulumtime.

C. Mundësitë:

- Bashkëpunimet ndërkombëtare në projektet e ofruara nga Bashkësia Evropiane, veçanërisht për Ballkanin.
- Krijimi i mundësive për publikime përmes projekteve hulumtuese me perëndimin.
- Përfshirja e studentëve të riinjë dhe shkencëtarëve në projekte kërkimore dhe të mobiliteteve.

D. Kërcënimet:

- Zhvillimi i mundshëm i kërkimit përmes vetëfinancimit, ose përmes projekteve kërkimore që do të aplikohen.
- Veprimtaritë e stafit akademik në kërkim.
- Qasje në të dhëna në fushat përkatëse të burimeve ujore, nga institucionet vendore, për kërkime.

2.7 Infrastruktura dhe Burimet

Standardi 7.1 Lokacioni i "Kampusit Teknik" gjendet në pjesën jugore të qytetit të Prishtinës, afër tri lagjeve të banimit të qytetit të Prishtinës - "Ulpiana", "Bregu i Diellit" dhe "Mati 1" dhe nga ana jugore kufizohet me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Hapësira përfshin një lokacion të papërfunduar për nga zhvillimi urban edhe pse i gjithë rrethina tashmë është ndërtuar në tërësi. Sipërfaqja e lokacionit është rreth 87.000 m² ose 8.70 hektarë. Fakulteti i Ndërtimtarisë është një nga njësitë akademike në kuadër të Universitetit të Prishtinës që ndan një hapësirë të përbashkët me dy njësi të tjera akademike: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. Të tre njësitë akademike funksionojnë në një hapësirë të përbashkët të identifikuar si "Fakulteti Teknik". Fakulteti Teknik zotëron godinën kryesore dhe godinën e laboratorit. Tri njësitë akademike (FN, FIEK dhe FIM) të UP-së e ndajnë hapësirën e objektit kryesor proporcionalisht. Sipërfaqja e përgjithshme që i përket Fakultetit të Ndërtimtarisë është rreth 8600 m², duke përfshirë hapësirat në godinën kryesore dhe ato në godinën e laboratorit. Sipërfaqja e objektit kryesor, prej përafërsisht 5,156 m², është e zënë nga hapësira të përbashkëta komunikimi (korridoret, shkallët, tualetet, biblioteka etj.), amfiteatrot, klasat, zyrat e mësimdhënësve (kabinetet), zyrat e administratës, zyra IT, zyrat e menaxhimit dhe ambiente të tjera ndihmëse.

Hapësira e godinës së laboratorëve të ndërtimit që ndodhet shumë pranë godinës kryesore të Fakultetit të Ndërtimtarisë zë një sipërfaqe prej 3369 m² [A40]. Laboratori i gjeomekanikës, materialeve ndërtimore, asfaltit, i hidroteknikës dhe inxhinierisë mjedisore janë laboratorë për nevoja mësimore për të cilat janë bërë investime kapitale. Laboratori i hidroteknikës dhe inxhinierisë së mjedisit ndodhet brenda godinës së laboratorit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe ka një sipërfaqe prej 165 m² [A41]. Laboratori është i pajisur me një numër të konsiderueshëm pajisjesh, të cilat shërbejnë për eksperimente laboratorike me student. Gjithashtu ky laborator pritet të pajiset me një numër të konsiderueshëm pajisjesh. Salla e informatikës ndodhet pranë laboratorit dhe ka një sipërfaqe prej 50 m², do të ketë 20 kompjuterë, të cilët do të përdoren për punën e studentëve me programe softuerike dhe për përpunimin dhe analizën e të dhënave të cilat maten me pajisje laboratorike. Natyrisht, përkundër investimeve të bëra dhe që bëhen vazhdimisht, pjesë të objektit të dedikuar për laboratorët nuk kanë arritur të riparohen dhe do të ketë nevojë në të ardhmen të bëhen riparime të mëtejshme lidhur me ambientet e objektit. Hapësirat në godinën kryesore të Fakultetit Teknik, të cilat i përkasin Fakultetit të Ndërtimtarisë nga ndarja proporcionale me dy fakultetet e tjera (FN dhe FIM) janë:

Niveli nr. 300, ku numërohen klasat, zyrat e administratës së FN ku zhvillohet aktiviteti për shërbimin e studentëve, zyra e IT, korridoret, shkallët, tualetet etj [A35];

Niveli nr. 400, me hapësirat e përbashkëta të fakulteteve - korridore të mëdha, nyje sanitare, depo, etj. Në këtë nivel ndodhet pjesa më e madhe e administratës së FN-së, shërbimeve studentore, sekretarisë, zyrave drejtuese dhe amfiteatrove (415 dhe pjesërisht 408). Në këtë nivel ndodhet hyrja kryesore e ndërtesës [A36];

Niveli nr.500 të godinës me klasa, zyra mësimdhënësish, hapësira të përbashkëta komunikimi-korridore, tualete etj. Në këtë nivel të godinës ndodhet edhe biblioteka e fakulteteve [A38];

Niveli nr. 700, përfshin zyrat e mësimdhënësve dhe ambientet e përbashkëta. Çdo mësimdhënës me kohë të plotë në FN zotëron zyrën e tij/saj me të gjitha ambientet e brendshme të nevojshme (tavolinë, pajisjet e nevojshme të punës, kompjuter, printer, telefon) [A38]. Çdo zyrë ka edhe ujë të instaluar. Çdo klasë është e pajisur me projektor dhe mjete konkretizimi në shërbim të mësimdhënies.

Standardi 7.2. Planifikimi buxhetor për Fakultetin e Ndërtimtarisë, në kuadër të të cilit zhvillohet programi MSc i MIRU, përfshin edhe planin financiar që mbulon shpenzimet për stafin e punësuar në FN-së (staf akademik, administratë, bashkëpunëtorë) dhe shpenzimet në kategori të tjera ekonomike.

Standardi 7.3. Të gjitha hapësirat në shërbim të FN-së janë pronë e UP-së, Fakulteti i Ndërtimtarisë nuk shfrytëzon hapësira me qira. Kampusi i Fakultetit Teknik përdoret nga tre fakultete: Fakulteti i Ndërtimtarisë, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, 1/3 e hapësirës totale i takon çdo fakulteti. Hapësirat që nuk mund të ndahen proporcionalisht në pronësi shfrytëzohen me rotacion proporcionalisht në aspektin kohor.

Si objektet laboratorike ashtu edhe pajisjet laboratorike janë pronë e Universitetit të Prishtinës. Vit pas viti UP-ja investon pjesërisht në riparimin dhe funksionalizimin e hapësirave të objektit. Serverët dhe programet kompjuterike në pronësi të FN-së gjithashtu kanë një licencë për t'u përdorur. Në FN ekzistojnë: serveri i bazës së të dhënave (që rezulton nga granti i projektit "InWaterSense") dhe serveri i departamentit të gjeodezisë. Disa nga softuerët në pronësi të FN janë: softueri GIS, softueri për përpunimin e imazheve satelitore (Erdas Imagine) dhe softveri i përpunimit dhe analizës së të dhënave satelitore (TTC).

Standardi 7.4. Fakulteti i Ndërtimtarisë me programet e tij posedon sipërfaqe të konsiderueshme të sallave mësimore, laboratorëve, të cilët kanë kapacitet të mjaftueshëm për vende për student. Duke parë numrin e studentëve aktivë brenda FN-së (numri i përgjithshëm i studentëve në të gjitha programet e studimit) rreth 1231 në raport me sipërfaqen totale të godinës kryesore që i përket FN-së është 5,156 m²/1,231, atëherë sipërfaqja e ndërtesa për një student është 4.18 m², që është një tregues i mirë i performancës.

Standardi 7.5. Në bibliotekën e Fakultetit të Ndërtimtarisë ka një numër të mjaftueshëm vendesh si dhe një numër të konsiderueshëm librash dhe revistash në shqip dhe anglisht, por mungojnë tekstet e reja profesionale. Salla e leximit ka 180 vende. Megjithëse ky numër vendesh plotëson veçanërisht nevojat e programit të MIRU, në përgjithësi është një numër i mangët për të plotësuar nevojat e të gjitha programeve të FN-së. Kjo do të thotë se është më se i nevojshëm zgjerimi/rritja e kapaciteteve të bibliotekës për nevojat e përgjithshme të të gjitha programeve të studimit në FN.

Standardi 7.6. Gjendja teknike dhe kushtet e ofruara nga kampusi teknik (duke llogaritur kohën e përdorimit të objektit nga fillimi i përdorimit 1982 e deri më sot - 40 vjet) mesatarisht plotësojnë nevojat e punës së njësisive tona akademike. FN së bashku me dy fakultete të tjera teknike (FIEK dhe FIM) përpiqen vazhdimisht të përshtatin infrastrukturën dhe mjediset për studentët me nevoja të veçanta. Në tre katet e objektit mund të arrihet me ashensor modern. Kati përdhese dhe hyrja kryesore e objektit janë të aksesueshme për të gjitha mjetet e përdorura nga personat me nevoja të veçanta.

Në 5 vitet e fundit janë investuar në përmirësimin e kushteve dhe ambienteve të punës. Vlen të përmendet përmirësimi i ngrohjes, funksionimi i rrjetit të ngrohjes i cili ka kontribuar dukshëm në përmirësimin e kushteve për mësim të rregullt nëpër klasa. Në vitin 2018 nga Investimet e Bankës Botërore, programi i eficiencës së energjisë, u investua në fasadën termike dhe dritaret e godinës. Vit pas viti UP-ja investon pjesërisht në riparimin dhe funksionalizimin e hapësirave të objektit. Në vitin 2021 është rinovuar pjesa e laboratorit të hidroteknikës, inxhinierisë së mjedisit si dhe laboratorë të tjerë.

Tabela 11 Infrastruktura e Fakultetit, zonat e ndërtesave

	DESTINIMI I HAPËSIRËS	SASIA	SIPËRFAQJA (m ²)
1	KLASAT	21	1,450.00 m ²
2	LABORATORËT	5	1,780.00 m ²
3	SALLAT	2	508.00 m ²
4'	SHOQËRIMI I HAPËSIRËS SË LABORATORIT (laboratori, klasa*, magazina)	6*	1,589.00 m ²
4	KABINETËT	26	379.00 m ²
5	ADMINISTRATA	8	182.00 m ²
6	KABINETËT	3	240.00 m ²
7	Korridoret + Tualetet + Hapësirat ndihmëse		2,397.00 m ²
SIPËRFAQJA TOTALE PËR DEPARTAMENTËT (NDËRTESA E FAKULTETIT DHE LABORTORET)			8,525.00 m²

Tabela 12 Infrastruktura e Fakultetit të Ndërtimtarisë, pajisjet e konkretizimit, Laboratorët

	PAJISJET	SASIA
1	PROJEKTOR	24
2	PAJISJET E KONKRETIZIMIT	54
3	PAJISJET LABORATORIKE (I-materialet ndërtimore)	150
4	PAJISJET LABORATORIKE (II-asfalt)	32
5	PAJISJET LABORATORIKE (Hidroteknikë)	20
6	PAJISJET LABORATORIKE (Msc Gjeodezi)	40
7	PAJISJET LABORATORIKE (Efikasitetit të energjisë)	20
8	PAJISJET LABORATORIKE (III-Gjeomekanikë)	70

Tabela 13 Infrastruktura e Fakultetit të Ndërtimtarisë, Librat e evidencave.

	LIBRAT	SASIA
1	LIBRA TË REGJISTRUARA	>150
2	LIBRA ELEKTRONIKE	100

Shënim: Që nga viti 1961 Fakulteti i Ndërtimtarisë organizon studime për nivele të ndryshme dhe në çdo brez studentësh janë të ruajtura shënimet në librat tonë. Në të dhënat tona ka më shumë se 150 libra regjistruar të arkivuar. Të gjithë librat amzë këtë vit (2021/2022) kanë filluar të skanohen dhe ruhen si dokumente elektronike.

Table 14 Infrastruktura e Fakultetit të Ndërtimtarisë

	INFRASTRUKTURA	SASIA
1	INTERNET (WIFI)	Në të gjithë hapësirën
2	NUMRI I PC-ve të STAFIT AKADEMIK	50
3	NUMRI I PC-ve të STUDENËVE	95
4	NUMRI I PC-ve të ADMINISTRATËS	20
5	PRINTERAT	50
6	TELEFONA	6
7	MAKINAT PËR FOTOKOPIJE	5

Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:

A. Përparësitë:

- Hapësirë e mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor,
- Hapësirë e mjaftueshme për ngritjen e laboratorëve të rinj.

B. Dobësitë:

- Mungesa e teksteve shkencore në bibliotekë,
- Mungesa e hapësirës për mësim të pavarur nga studentët,
- Mungesa e stafit – laborantëve në laboratorë.

C. Mundësitë:

- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për kërkimin dhe mësimdhënien,
- Rritja e qasjeve nga studentët në platformat digjitale – e-biblioteka,
- Rritja e mundësisë së përdorimit të laboratorëve të institucioneve të tjera për zhvillimin e pjesëve praktike të lëndëve të caktuara dhe për kërkime,
- Rritja e numrit të teksteve në bibliotekë.

D. Kërcënimet:

- Procedurat e punësimit të stafit të ri marrin shumë kohë dhe mund të dëmtojnë procesin e përmirësimit të kushteve të punës për stafin akademik dhe studentët.

3. LISTA E REFERENCAVE



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
 “HASAN PRISHTINA”
 UNIVERSITY OF PRISTINA
 FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë
 Tel: +381-38-548 644 URL: <http://www.fn.uni-pr.edu> Mail: fn@uni-pr.edu

Dekani

Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci

Ref. nr. _____

Prishtinë _____ 2023

Për nevojat e hartimit të një raporti të brendshëm të vetëvlerësimit të akreditimit të programit të studimit Master Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore, në vijim janë referencat ne bazë të cilave Fakulteti si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës e mbështet aktivitetin e tij.

LISTË E REFERENCAVE - RAPORTI RVV

Tabela 15 Lista e referencave - Raporti RVV

A1	Monografia UP
A2	Marrëveshje mes Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Fakultetit të Arkitekturës
A3	Përshkrimi i Punës së Dekanit
A4	Vendim - Koordinatori i zhvillimit akademik Enes Krasniqi
A5	Vendim - Komisioni për studime ne FN
A6	Udhëzues për temën e diplomës Master
A7	Vendim për vazhdimin e afatit të diplmimit BSc MSc dhe PhD
A8	Deklaratë mbi parandalimin e nepotizmit në UP
A9	Vendim - Caktimi i mbikqyrësit të asistentëve të autorizuar për ligjerata
A10	Vendim - Emërimi i ekspertëve për lëndën e gjykatës
A11	Vendim - Emërimi i komisionit për Ekuivalentim dhe Barazvlerë të FN
A12	Miratimi i rregullorës - Plotësim Ndryshimi i rregullorës nr.163 15.1.2015 - Trupa Këshilldhënëse e njësive akademike UP
A13	CV Template e Stafit Akademik
A14	Kontrata e punës Template
A15	Kontrata për angazhim me honorar Template
A16	Kontrata për angazhim me mbinormë Template
A17	Rregullore per sigurimin e cilesise dhe vleresimit UP
A18	Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimi i rezultateve të tyre ne UP
A19	Zgjatje e periudhës së akreditimit për programet e Studimit të UP - FN dhe FA
A20	Vendimi i Menaxherit të Kontrates dhe vendimi i Komisionit te Pranimit
A21	Njoftim për Kontratë - Furnizim me pajisje laboratorike per FIEK dhe te tjera
A22	Njoftim për Kontratë - Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve laboratorike për FNA-në
A23	Dosja e Tenderit- Shqip_ Furnizim me paisje Laboratorike për FIEK dhe FNA
A24	Dosja e Tenderit- Shqip_ Furnizimi dhe instalimi i paisjeve Laboratorike për FNA-së
A25	Kontrata dhe Oferta Financiare-Lot-2
A26	Kërkesa - Furnizim me paisje Laboratorike për FNA - Ritender
A27	Lista e Stafit Akademik_Hidroteknikë
A28	Lista e Stafit Akademik_Konstruktiv
A29	Planifikimi i prokurimit paraprak - buxheti per vitin 2021
A30	Kerkese rektoratit lidhur me buxhetin e vitit 2021, 22 nga FN, FIM, FIEK
A31	Kërkesat dhe Formularet
A31.1	Fleteregjistrim
A31.2	Kërkesat për student

A31.3	Formulari F1B Kërkesë për caktimin e mentorit BSc
A31.4	Formulari F2B_Raporti për aprovimin, formimin e komisionit dhe mbrojtjen e punimit të diplomës BSc
A31.5	Kërkesë për tërheqjen e punimit të diplomes dhe vendimi për mbrojtje BSc
A31.6	Formulari F1 Kerkese për vlerësimin e projekt propozimit të temës së diplomës MSc
A31.7	Formulari F1 Raporti i vlerësimit të Projekt Propozimit MSc
A31.8	Formulari F2 Kërkesë për Formimin e Komisionit për vlerësimin e temës së Diplomes MSc
A31.9	Formulari F3 Raporti i vlerësimit të temës së diplomës MSc
A31.10	Formulari F4 Formulari për mbrojtjen e temës së diplomës MSc
A31.11	Form F1 Model - Project Propozimi
A31.12	Form F1.1 Model – Raporti i vlerësimit të Projekt Propozimit MSc
A31.13	Form F3 Model – Raporti i vlerësimit të doreshkrimit të temës së diplomes MSc
A31.14	Form F3.1 Model – Shkrese për raportin e vlerësimit të doreshkrimit të temës së diplomes MSc
A31.15	Form F4 Model – Formulari për mbrojtjen e temës së diplomes MSc
A32	Pyetësoret
	Pyetësor për personelin akademik Shqip
	Pyetësor për personelin akademik English
	Pyetësori për vlerësimin e lëndës Shqip
	Pyetësori për vlerësimin e lëndës English
	Pyetësori për studentet e nivelit Bachelor Shqip
	Pyetësori për studentet e nivelit Bachelor English
	Pyetësor për personelin administrativ dhe mbështetës të universitetit Shqip
	Pyetësor për personelin administrativ dhe mbështetës të universitetit English
A33	Template, Certifikatë e trajnimit të stafit akademik
A34	Buxheti i planifikuar 2021,2022,2023
A35	Planimetria e objektit të fakultetit-Kati 3
A36	Planimetria e objektit të fakultetit-Kati 4
A37	Planimetria e objektit të fakultetit-Kati 5
A38	Planimetria e objektit të fakultetit-Kati 7
A39	Suterreni-Labororet dhe Salla Mesimi
A40	Perdhesa-Labororet dhe Salla Mesimi
A41	Labororet dhe Salla Mësimi -Kati 1
A42	Marrëveshja mësimore Mobiliteti i studentëve për studime
A43	Lista e publikimeve shkencore – Stafi akademik IWRM
A44	Raporti vjetor i Fakultetit 2021
TABELA 4	
Statuti dhe Plane Strategjike	
S1	Statuti i UP
S2	Plani strategjik i UP
S3	Strategjia e FN
Korniza	
K1	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
K2	Korniza e Zonës Evropiane për Kualifikim të Arsimit të Lartë.
Rregulloret	
R1	Rregullore për procedurat e përgatitjes së ri-akreditimit në UP
R2	Rregullore për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP
R3	Rregullore e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP
R4	Rregullore për financimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore, artistike dhe sportive në UP
R5	Rregullore për studimet– Master
R6	Rregullore e punës së sistemit elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) në UP
R7	Rregullore për mobilitetet akademik të studentëve
R8	Rregullore për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP

R9	Rregullore për procedurën dhe masat disiplinore për studentët e UP
R10	Rregullore për procedurën zgjedhore, themelimin dhe punën e parlamentit studentor (PS) dhe këshillave të studentëve (KS) të UP
R11	Rregullore mbi strukturën dhe parimet e punës të qendrës për përsosmëri në mësimdhënie në UP
R12	Rregullore për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në UP
R13	Rregullore e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të cilësisë në UP Nr. 4/132 Dt. 30/12/2016
R14	Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 2-543, datë 22.10.2021, për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompensimet tjera në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"
Vendimet	
V1	Vendim i Senatit të UP-së, për zyrtarizimin e të gjitha udhëzimeve për zhvillimin e aktiviteteve akademike gjatë pandemisë COVID-19
V2	Bartësit e Programit MSc – MIRU
V3	Koordinatori i Programit MSc - MIRU
V4	Përfundimi i RVV-së – vendimi për procedurat e mëtutjeshme në Zyrën Akadematike për Zhvillim
Udhëzime	
U1	Udhëzim Administrativ nga MASHTI për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë
U2	Udhëzues për shqyrtimin dhe rishikimin e Syllabusit
U3	Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimin e rezultateve të tyre
Tjera	
T1	Sigurimi i cilësisë në UP
T2	Bashkëpunim ndërkombëtar
T3	Marrëveshje bashkëpunimi në FN-a
T4	Kodi i Etikës i stafit akademik - 1/751 dt. 2013
T5	Trupi këshillëdhënës (TK) i FN-ës
T6	Komuniteti Alumni
T7	Këshilli studentor
T8	Qendra për Zhvillim të Karrierës
T9	e-Karriera
T10	Infrastruktura për kërkime shkencore në UP
T11	Thirrje për shprehje interesi për prezantimin e një Programi Master në MIRU
T12	Aplikimi për programin Master – MIRU
T13	Letër Marrëveshje MIRU/UP
T14	Prezantimi publik i programit MIRU
T15	LETËR MARRËVESHJE ndërmjet Programit të Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë dhe Technische Hochschule Köln/Instituti për Teknologjinë dhe Menaxhimin e Resurseve në Tropikët dhe Nën-tropikët
T16	Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Technische Hochschule Koln, Fakultetit të Zhvillimit Hapësinor dhe Sistemeve të Infrastrukturës dhe Universitetit të Prishtinës
T17	Memorandum mirëkuptimi në mes-Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit dhe Mekanik, Universiteti i Shkencave të Jetës në Poznan, Poloni, 22.03.2022
T18	Erasmus+, Mobilitet për studentët dhe stafin, mobiliteti i studentëve dhe stafit të arsimit të lartë. Marrëveshja ndër-institucionale 2020-23, ndërmjet institucioneve të programit dhe vendeve partnere, Università degli Studi di Trento/Italia dhe Universitetit të Prishtinës. Nënshkruar në datën 02 Mars 2021.
T19	Erasmus+, Mobiliteti për studentët dhe stafin, mobiliteti i studentëve dhe stafit të arsimit të lartë. Marrëveshja ndër-institucionale 2022-24, ndërmjet institucioneve të programit dhe vendeve partnere, Universitetit të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës, Vjenë dhe Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë.

BARTËSIT E PROGRAMIT MIRU:

Bartës të programit MSc MIRU, sipas vendimit të Këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë janë:

1. Prof.Asoc. Dr. Laura Kusari
2. Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj

Tabela 16 Të dhënat e publikimeve për bartësit e programit MIRU

Prof. Dr. Laura Kusari	Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj
<p><i>Flow Rate Determination as a Function of Rainfall for the Ungauged Suhareka River</i></p> <p>Laura Kusari, Lavdim Osmanaj, Hana Shehu, Samir Bungu JOURNAL OF ECOLOGICAL 2021 J. Ecol. Eng. 2022; 23(4):110–121 SCOPUS http://www.jeeng.net/pdf-14635572843?filename=Flow%20Rate%20Determination.pdf</p>	<p><i>Flow Rate Determination as a Function of Rainfall for the Ungauged Suhareka River</i></p> <p>Laura Kusari, Lavdim Osmanaj, Hana Shehu, Samir Bungu JOURNAL OF ECOLOGICAL 2021 J. Ecol. Eng. 2022; 23(4):110–121 SCOPUS http://www.jeeng.net/pdf-146355-72843?filename=Flow%20Rate%20Determination.pdf</p>
<p><i>Waste Disposal Impacts on Surface Water Quality</i></p> <p>Laura Kusari Waste Technology (WasTech) - An International Journal Doaj https://ejournal.undip.ac.id/index.php/wastech/author/submission/17371</p>	<p><i>Determination of Groundwater Protection Zones of the Pozharan Wellfield Using Hydrogeological Modflow Model</i></p> <p>Lavdim Osmanaj, Argjend Hajra, Afrim Berisha. JOURNAL OF ECOLOGICAL 2021 SCOPUS http://www.jeeng.net/Author-Lavdim-Osmanaj/161617</p>
<p><i>Solid Waste Management for Surface Water Quality Protection</i></p> <p>Laura Kusari International Journal of Environmental Quality Web of Science https://eqa.unibo.it/article/view/7886</p>	<p><i>The Journey of Establishing Groundwater Source Protection Zones in Kosovo on the Example of Lipjan/Lipljan Municipality</i></p> <p>Lavdim Osmanaj, Argjend Hajra, Afrim Berisha, Thomas de Beyer Ecological Engineering & Environmental Technology SCOPUS http://www.ecoet.com/Author-Lavdim-Osmanaj/161617</p>
<p><i>Development of Water Quality Matrix through Surrogate Modeling</i></p> <p>Laura Kusari International Journal of Environmental Quality Web of science https://eqa.unibo.it/article/view/7735</p>	<p><i>Determination of Methane Explosion Level in the Velekince Municipal Solid Waste Landfill</i></p> <p>Afrim Berisha, Lavdim Osmanaj, Ecological Engineering & Environmental Technology SCOPUS http://www.ecoet.com/Determination-of-Methane-Explosion-Level-in-the-Velekince-Municipal-Solid-Waste-Landfill,139407,0,2.html</p>
<p><i>Regression Model as a Tool to Predict Concentrations of Total Suspended Solids in Rivers</i></p> <p>Laura Kusari</p>	<p><i>Kosovo Scenario for Mitigation of Greenhouse Gas Emissions from Municipal Waste Management</i></p> <p>Afrim Berisha, Lavdim Osmanaj,</p>

<p><i>International Journal of Environmental Quality</i> <i>Web of science</i> https://eqa.unibo.it/article/view/6865</p>	<p>EVERGREEN Joint Journal of Novel Carbon Resource Sciences & Green Asia Strategy, Vol. 08, Issue 03, pp00-00, September 2021 SCOPUS http://www.tj.kyushu- u.ac.jp/evergreen/contents/EG2021- 8_3_content/pdf/509-516.pdf</p>
--	---